REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

# RAPORTI I MONITORIMIT
## PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2021

# STRATEGJIA PËR EDUKIMIN LIGJOR TË PUBLIKUT 2019-2023

www.drejtesia.gov.al

**TABELA E PËRMBAJTJES**

**I. Informacion përmbledhës mbi Strategjinë për edukimin ligjor të publikut (SELP)**

1.1 Metodologjia e Monitorimit

**II. Progresi i Strategjisë për edukimin ligjor të publikut (SELP)**

2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës

2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integrimit evropian

2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit

2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

**III.** Progresi i lidhur me qëllimet politike, objektivat specifike dhe masat

3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

3.2 Vlerësimi i sfidave, boshlleqeve dhe joefikasitetit

3.3 Konkluzione dhe rekomandime

**IV. Risqet /risku dhe hapat për të adresuar**

4.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit/indikatorët

4.2 Hapat e radhës

**Aneks 1. Raporti vjetor, janar- dhjetor 2020, i monitorimit për Planin e Veprimit 2020-2023**

**LISTA E SHKURTIMEVE**

AIDA - Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

AMA - Autoriteti i Mediave Audiovizive

AMShC –Agjencia e Menaxhimit të Shoqërisë Civile

BE – Bashkimi Evropian

ELP – Edukimi ligjor i publikut

GENL- Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë

IZHA - Instituti për Zhvillimin e Arsimit

KLGJ –Këshilli i Lartë Gjyqësor

Komisioni i Posaçëm - Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

Kuvendi - Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

LGBT - përfshin të gjithë personat me orientim të ndryshëm seksual

MFP - Menaxhim i financave publike

MD - Ministria e Drejtësisë

MSA - Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit

NJQV - Njësi e Qeverisjes Vendore

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

OSHC – Organizatat e Shoqërisë Civile

OGP -Parimet e qeverisjes se hapur

OSBE – Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë

PBA – Programi Buxhetor Afatmesëm

PV - Plan Veprimi

RTSH – Radio Televizioni Shqiptar

Rrjet - Rrjeti Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut

SND - Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë

SELP - Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut

SKZHI - Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Integrim

SPAK - Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

**INSTITUCIONET PJESË E RRJETIT**

1. Kuvendi i Shqipërisë
2. Avokati i Popullit,
3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
4. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,
5. Gjykata Kushtetuese
6. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)
7. Prokuroria
8. Prokuroria Posaçme
9. Banka e Shqipërisë
10. Këshilli i Ministrave
11. Ministria e Drejtësisë
12. Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme
13. Ministria përgjegjëse për arsimin,
14. Ministria përgjegjëse për punët e brendshme
15. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale
16. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën
17. Ministria përgjegjëse për fushën e tregtisë
18. Komiteti për Pakicat Kombëtare
19. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
20. Qendra e Botimeve Zyrtare
21. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
22. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit
23. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
24. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
25. Avokati i Tatimpaguesve
26. ADISA (Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara)
27. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
28. Instituti për Zhvillimin e Arsimit (IZHA)
29. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
30. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
31. Agjencia Kombëtare e Mjedisit,
32. Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)
33. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)
34. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit,
35. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)
36. Organet e qeverisjes vendore
37. Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
38. Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë
39. Institucionet e Arsimit të Lartë.
40. Organizatat e shoqërisë civile

## I. INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI STRATEGJINË PËR EDUKIMIN LIGJOR TË PUBLIKUT (SELP) 2019-2023 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2020-2023

Strategjia për edukimin ligjor të publikut (SELP) është dokumenti i parë strategjik i miratuar në Shqipëri me fokus të veçantë edukimin ligjor të qytetarëve. Kjo Strategji është miratuar me Vendimin nr. 47/2019 të Kuvendit të Shqipërisë.

Ky dokument është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës hartimi dhe konsultimi. Njohuritë mbi ligjin dhe edukimi ligjor i qytetarëve luajnë një rol thelbësor në çdo shoqëri demokratike, ku sjellja, veprimet dhe marrëdhëniet mes tyre disiplinohen nga norma e rregulla ligjore. Këto norma e rregulla janë ndonjëherë komplekse apo u nënshtrohen ndryshimeve të vazhdueshme.

Aksesi i publikut në njohuritë mbi ligjin, është themelor për garantimin e një sistemi drejtësie efektiv. Kështu, informimi dhe dhënia e njohurive për ligjin, mbi të drejtat, institucionet ligjzbatuese, përgjegjësitë etj. nuk janë të lidhura vetëm me arsimimin juridik, por janë përbërësit e kulturës dhe nevojës qytetare për qasjen ndaj shtetit të së drejtës.

Përpos raportit të qytetarëve me institucionet e administratës publike, niveli i njohurive juridike luan rol kyç në sjelljen e vetë qytetarëve në sektorë të ndryshëm të jetës, si në marrëdhëniet e tyre familjare, të punës, ato juridiko-civile, ashtu dhe në veprimet e vendimet e tyre në mbrojtje të shëndetit, sigurisë, mjedisit etj. Njohja e legjislacionit që rregullon marrëdhëniet ku qytetarët janë të përfshirë, i nxit ata të respektojnë ligjin, i bën të shmangin veprimet e jashtëligjshme dhe të reduktojnë konfliktet.

Reforma në sistemin e drejtësisë, e konceptuar mbi 7 shtylla bazë, që së bashku përbëjnë të plotë ndërtesën e sistemit të drejtësisë në vend, parashikon, si një nga shtyllat e saj, “Edukimin ligjor dhe arsimin juridik”.

Hartimi i SELP është mbështetur jo vetëm në gjetjet e Analizës së Sistemit të Drejtësisë, por edhe në objektivat e Strategjisë së Reformës në Sistemin e Drejtësisë, që pasoi këtë analizë, dhe ka përcaktuar si objektiv kryesor për ELP rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për rëndësinë e zbatimit të ligjit. Për realizimin e këtij objektivi parashikohet të merren disa masa konkrete, të cilat janë mbajtur në konsideratë dhe janë shtjelluar në këtë strategji.

SELP bazohet në vlerësimin mbi gjendjen aktuale të ELP në Shqipëri dhe hartimi i saj është udhëhequr nga këto parime:
*a) respektim i ligjshmërisë në të gjitha fushat e jetës;*
*b) qeverisje e hapur, që garanton transparencë dhe llogaridhënie në vendimmarrje, politikbërje dhe ligjbërje;*
*c) koordinim dhe bashkëveprim institucional në funksion të edukimit ligjor të publikut;*
*ç) akses i barabartë i individëve në edukimin ligjor;*
*d) profesionalizmi në ofrimin e edukimit ligjor;*
*dh) edukim ligjor i vazhdueshëm i shoqërisë, duke ofruar njohuri dhe dije në përputhje me nevojat e gjithësecilit dhe komuniteteve në nevojë.*

## I.1 Procesi i hartimit të Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut

Kuvendi, me vendimin nr. 96/2014 vendosi ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. Komisioni i Posaçëm ka pasur, ndër të tjera, për objekt të veprimtarisë së tij edhe "Hartimin e një dokumenti strategjik për objektivat e reformës në sistemin e drejtësisë, bazuar në analizën e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë". Për realizimin e detyrave të sipërpërmendura, pranë Komisionit të Posaçëm u ngrit Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), i mbështetur nga një sekretariat teknik. Në përfundim të Analizës së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri dhe mbështetur mbi gjetjet e saj, u hartua nga GENL, me asistencën e sekretariatit teknik, Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë dhe Plani i Veprimit të saj.

Komisioni i Posaçëm, me vendimin nr. 14, datë 30.7.2015, "Për miratimin e Dokumentit "Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri", miratoi Dokumentin "Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri" dhe me vendimin nr. 15, datë 30.7.2015 "Për miratimin në parim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri", miratoi në parim dokumentin e Strategjisë së Reformës në Sistemin e Drejtësisë, si dhe Planin e Veprimit për zhvillimin e kësaj strategjie.

Në Strategjinë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë parashikohet "Edukimi ligjor dhe arsimi juridik", si një nga 7 shtyllat bazë të reformës në sistemin e drejtësisë. Në datën 16 dhjetor 2016 u prezantua në Komisionin e Posaçëm paketa prej 27 projektligjesh, hartuar nga GENL së bashku më ekspertët ndërkombëtarë të EURALIUS, OPDAT dhe OSBE. Pjesë e paketës së akteve të reformës në drejtësi është edhe Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut në Republikën e Shqipërisë.

Hartimi i SELP lindi si ide e nëngrupit të punës të ekspertëve të nivelit të lartë të reformës në drejtësi, përgjegjës për hartimin e projektligjeve lidhur me arsimin juridik. Gjatë diskutimeve të këtij nëngrupi pune u gjykua e nevojshme që arsimi juridik të trajtohej përtej konceptit formal dhe përveç institucioneve arsimore, të përfshihen edhe organet shtetërore dhe shoqëria civile, me qëllim zgjerimin dhe shtrirjen e edukimit ligjor ndaj shtresave të ndryshme të shoqërisë.

Një kontribut të rëndësishëm në kuadër të hartimit të SELP kanë dhënë ekspertët e nivelit të lartë të këtij nëngrupi pune. Gjithashtu, gjatë procesit të hartimit të SELP, ekspertët e nivelit të lartë janë mbështetur nga stafi teknik i nëngrupit të punës, si dhe nga grupi i punës i ngritur nga koalicioni i shoqërisë civile "Drejtësi për të gjithë", të mbështetur nga organizata "Save the children" me fondet e Bashkimit Europian dhe nga OSBE.

## I.2 Metodologjia për hartimin e Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut

Metodologjia e përdorur mundëson që përmbajtja e dokumentit të jetë rezultat i një procesi gjithëpërfshirës, transparent, profesional, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kuadrin politik e ligjor të brendshëm.

### I.2.1 Gjithëpërfshirja

Procesi i hartimit dhe i përmirësimit të vazhdueshëm të përmbajtjes së SELP është karakterizuar nga gjithëpërfshirja e institucioneve publike e të pavarura, akademikëve, ekspertëve, organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe partnerëve ndërkombëtare që kanë përgjegjësi/njohuri apo veprojnë në fushën e ELP.

Gjithëpërfshirja e aktorëve të sipërpërmendur konstatohet në të gjitha fazat e hartimit të SELP. Në GENL, të ngritur pranë Komisionit të Posaçëm dhe përgjegjës për hartimin e SELP, përfaqësoheshin institucionet më të rëndësishme të sistemit të drejtësisë. Gjithashtu, në funksion të një gjithëpërfshirjeje sa më të gjerë u krijua Rrjeti i Konsultimit Publik të Profesionistëve për reformën në drejtësi pranë Komisionit të Posaçëm, i përbërë nga rreth 1900 persona, përfaqësues të OSHC-ve, gjykatave dhe prokurorive të të tria niveleve, avokatë, profesorë të fakulteteve të drejtësisë, Shkollës së Magjistraturës dhe ekspertë të angazhuar në projekte kërkimore në fushën e drejtësisë. Duke marrë në konsideratë objektin e SELP, nëngrupi i punës bashkëpunoi ngushtë me OSHC-të me eksperiencë në fushën e ELP.

I.2.2 Transparenca dhe konsultimi publik

Projekti i parë i SELP iu nënshtrua një procesi konsultimi transparent dhe gjithëpërfshirës. Procesi i konsultimit përfshiu aktorë dhe përfaqësues nga institucione publike e të pavarura, akademikë, ekspertë, organizata të shoqërisë civile (OSHC) dhe partnerë ndërkombëtarë, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në ELP. Ky proces u zhvillua nëpërmjet takimeve konsultuese apo kërkesës për të paraqitur kontribut me shkrim. Sugjerimet e dërguara u reflektuan në projektin e dytë të kësaj Stategjie. Një kontribut të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të përmbajtjes së projektit të dytë të SELP ka dhënë Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e institucionit lider në kuadër të sigurimit të zbatimit të SELP nëpërmjet hartimit dhe monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit që u hartua pas miratimit të kësaj strategjie, si dhe grupi i punës i ngritur nga koalicioni i shoqërisë civile "Drejtësi për të gjithë". Gjithashtu, një kontribut të vazhdueshëm ka dhënë edhe Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri, për aspekte metodologjike të hartimit të SELP. Projekti i dytë i SELP iu nënshtrua një procesi tjetër konsultimi publik, nëpërmjet shpërndarjes për mendim të këtij projekti në institucione publike e të pavarura, akademikë, ekspertë, OSHC dhe partnerë ndërkombëtarë, si dhe organizimit të takimeve konsultuese në 4 rajone të vendit (Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Korcë), me qëllim diskutimin e këtij dokumeti strategjik me institucionet publike, bashkitë dhe OSHC-të në nivel lokal.

Sugjerimet e dërguara dhe të mbledhura nga procesi i dytë i konsultimit publik u reflektuan në projektin përfundimtar të kësaj stategjie.

### II.2.1 Edukimi Ligjor i Publikut në kuadër të dokumenteve strategjike ekzistuese.

Vitet e fundit janë miratuar një numër i konsiderueshëm strategjish, si dhe dokumentesh të tjera të rëndësishme që orientojnë politikat e zhvillimit në bazë të sektorëve të ndryshëm. Disa prej tyre parashikojnë në mënyrë thelbësorë përfshirjen e qytetarit, si dhe metodologji ose strategji komunikimi me ose për publikun. Disa prej këtyre strategjive janë si më poshtë:

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Integrim (SKZHI) 2015-2020** ka në themel të vizionit të saj *"konsolidimin e qeverisjes së mirë, demokracisë dhe shtetit ligjor"*, konsolidimi dhe forcimi i të cilave do të realizohen nëpërmjet disa objektivave të përcaktuar. Në shtyllën 3 të SKZHI-së përcaktohen drejtimet kryesore të investimit në kapitalin njerëzor e kohezionin social: burimi më i rëndësishëm i Shqipërisë janë njerëzit, populli i saj dhe, bashkë me të, shoqëria dhe kultura e saj. Në SKZHI theksohet objektivi i Qeverisë për ofrimin e shërbimeve publike novative me në qendër qytetarin, dhe një nga shtyllat kryesore ***"...zgjerimi i kanaleve të informacionit për qytetarët dhe monitorimi i performancës për ofrimin e shërbimeve, me synim përmirësimin e vazhdueshëm".***[1]

[1] Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2015-2020, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 348, datë 11.05.2016.

Po këtu, në kuadër të objektivit strategjik për rritjen e transparencës dhe forcimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, synohet përmirësimi i mundësive të publikut për t'u njohur me normat dhe informacionin ligjor, duke rritur botimet e gazetave zyrtare, kodeve dhe përmbledhjeve të legjislaconit etj.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2016-2020: në kuadër të objektivit strategjik lidhur me "përmirësimin e funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj vartëse", parashikohet si masë treguese e realizimit të këtij objektivi edhe përmirësimi i sistemit të njoftimit publik dhe konsultimit të legjislacionit.

Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2018-2021[2]: Ndër objektivat strategjikë të parashikuar në këtë strategji është edhe "Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi", i cili parashikohet të arrihet përmes zbatimit të disa objektivave specifikë ku, ndër të tjera, parashikohet edhe organizimi i fushatave sensibilizuese për aksesin e të miturve në drejtësi dhe të shërbimeve që ofron sistemi për ta.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020[3] ka vlerësuar si një domosdoshmëri edukimin ligjor të fëmijëve që në fazat e para të jetës, ndër të tjera duke përmirësuar kurrikulat për arsimimin të tyre.

Rezoluta e Kuvendit, datë 7.5.2015[4], "Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave që i përkasin komunitetit LGBT" e pasuar me Miratimin e Planit te Veprimit për Personat LGBTI, ka parashikuar një sërë objektivash për mobilizimin e aktorëve kryesorë për edukimin ligjor të personave LGBTI.

Rezoluta e Kuvendit, datë 4.12.2017, "Për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj", inkurajohet Qeveria që të parashikojë fondet për një fushatë të gjerë ndërgjegjësimi mbi pasojat e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe për informimin e publikut për mekanizmat e referimit në nivel vendor dhe rritjen e kapaciteteve të tyre.

Rezoluta e Kuvendit, datë 28.3.2019, "Për vlerësimin e punës së grupit të deputetëve "Miqtë e fëmijëve" për vitin 2018 dhe për planin e veprimit për vitin 2019".

Në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020 [5]parashikohet si një ndër politikat kryesore nxitja e kulturës së sipërmarrjes dhe edukimit për sipërmarrjen.

Dokumenti i politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri[6], fokusohet në shërbimet me natyrë administrative nga institucionet e administratës shtetërore.

Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020 [7]ka parashikuar se do të merren masa për të përmirësuar më tej aksesueshmërinë dhe transparencën dhe se Qeveria do të vërë në

[2] Miratuar me VKM nr 541, datë 19.09.2018.
[3] Miratuar me VKM nr. 372, datë 26.04.2017.
[4] Miratuar me VKM nr. 390, datë 25.5.2016.
[5] Miratuar me VKM, Nr.635, datë 01.10.2014.
[6] Miratuar me VKM, nr. 384, datë 25.05.2016.
[7] Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike, miratuar me VKM, nr. 908, dt. 17.12.2014.

dispozicion të dhëna mbi financat dhe operacionet e saj nëpërmjet një “portali transparence” të hapur për publikun.

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020 [8]parashikon informimin dhe edukimin e publikut përgjatë kohës së zbatimit të politikave.

Në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2016-2020[9] parashikohet gjerësisht përgjatë objektivave strategjikë përfshirja dhe ndërgjegjësimi i popullatës lidhur me çështjet e shëndetit, pjesëmarrjes në vendimmarrje etj.

Në Strategjinë Sektoriale të Rendit Publik 2014-2020[10] konsiderohet e rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të filozofisë dhe të praktikës së policimit në komunitet, konsolidimi i partneritetit me komunitetin, si dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve administrative që ofrohen për qytetarin dhe biznesin.

Strategjia Ndërsektoriale për Administratën Publike 2015-2020[11] ka përcaktuar në qëllimet e politikave çështje të informimit të ELP.

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020[12] në një prej qëllimeve strategjike “Qeverisja e hapur, transparenca, llogaridhënia, e-qeverisja në nivelin vendor”, përcakton se qeverisja vendore do të kthehet nga një qeverisje e mbyllur dhe jotransparente në një qeverisje të hapur me orientim nga qytetarët. Shqipëria është bërë pjesë e vendeve që janë angazhuar të zbatojnë parimet e qeverisjes së hapur (OGP). Parimet e qeverisjes së hapur, transparencës dhe llogaridhënies janë parime të detyruara për t’u aplikuar nga njësitë e qeverisjes vendore.

Strategjia Ndërsektoriale për Antikorrupsionin 2015-2023[13], në mënyrë të qartë, parashikon si objektiv më vete qasjen ndërgjegjësuese, ku përfshin “ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit”.

Strategjia për Mbrojtjen Sociale 2015-2020[14], në pjesën e zhvillimit të shërbimeve të kujdesit social, parashikon ndërgjegjësimin dhe edukimin publik për parandalimin e problemeve sociale dhe adresimin pranë shërbimeve sociale, nëpërmjet fushatave të komunikimit

Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm[15] ka thelbësisht objektiva, të cilët synojnë ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për çështjet e ekstremizmit të dhunshëm dhe parandalimin e përfshirjes së grupeve të caktuara të publikut në një fenomen të tillë.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020[16], kërkon marrjen e masave, me qëllim informimin e publikut nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese si për të drejtat e grave, ashtu dhe për luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

DRAFT

[8] Miratuar me VKM-në nr. 709, datë 29.10.2014.
[9] Miratuar me VKM, Nr.439, Dt. 17.05.2017.
[10]Miratuar me VKM, Nr.702, Dt. 26.08.2015.
[11] Miratuar me VKM, Nr.319, Dt. 15.04.2015.
[12] Miratuar me VKM, Nr.691, Dt. 29.07.2015.
[13] Miratuar me VKM, Nr.516, datë 01.07.2020.
[14] Miratuar me VKM, Nr.1071, Dt. 23.12.2015.
[15] Miratuar me VKM, Nr.930, Dt. 18.112015.
[16]Miratuar me VKM, Nr.733, datë 20.10 2016.

Plani i veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, "Mbi gruan, paqen dhe sigurinë", 2018–2020[17], në masat që synohen të realizohen, parashikohet edhe "adresimi me aktivitete të përbashkëta për rritjen e ndërgjegjësimit të rolit të gruas në ruajtjen e paqes dhe adresimin e situatave postkonflikt: debate publike, fushata, tryeza të rrumbullakëta dhe forma të tjera të informimit publik".

Plani kombëtar i veprimit për personat me aftësi të kufizuara, 2016-2020[18], një prej qëllimeve strategjike të tij është edhe sigurimi i aksesit të barabartë në shërbime dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara.

Edukimi ligjor i publikut parashikohet në një sërë aktesh ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Këto ligje kanë sanksionuar detyrime për institucionet kushtetuese, por jo vetëm, për të kontribuar në përmirësimin e njohurive të qytetarëve mbi aspekte specifike të legjislacionit.

Autoritetet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe të programeve shtetërore duhet të realizojnë veprimtari për edukimin, trajnimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve.

Kuadri ligjor ekzistues parashikon forma të ndryshme të ofrimit të ELP, duke përfshirë si informimin në bazë të legjislacionit për të drejtën e informimit, ashtu edhe ndërmarrjen e iniciativave konkrete për ta bërë më të prekshëm informacionin ligjor te qytetarët, përmes fushatave ndërgjegjësuese dhe parandaluese, përfshirë dhe pjesmarrjen e publikut në hartimin dhe diskutimin e projektligjeve.

Shumë institucione, në kuadër të trasparencës dhe së drejtës së informimit, kanë publikuar, në faqet e tyre elektronike, legjislacionin që qëndron në bazë të veprimtarive që zhvillon institucioni përkatës.

Zbatimi i SELP do të realizohet nëpërmjet Planit të Veprimit 2020-2023, i cili është miratuar me Vendimin nr. 878, datë 11.11.2020 të Këshillit të Ministrave, në përputhje me çfarë parashikohet në këtë Strategji dhe sipas parashikimeve në kreut VI të kësaj Strategjie "Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese". Ky kre paraqet procedurat që zbatohen për garantimin e zbatimit të SELP, duke përcaktuar institucionet zbatuese të SELP dhe PV, institucionet monitoruese të zbatimit të SELP dhe PV, raportimin periodik, metodologjinë e raportimit dhe analizën vlerësuese.

## 1.1 Metodologjia e monitorimit

Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 166, dt. 5.10.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë," në Ministrinë e Drejtësisë është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive.

Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Ky raport mbulon periudhën nga *1 janar 2021 deri në 31 dhjetor 2021* dhe është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga të gjitha institucionet e përfshira në Planin e Veprimit 2020-2023 në zbatim të SELP. Çdo institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo politike dhe aktiviteti, buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe

[17]Miratuar me VKM, nr. 524, Dt. 11.09.2018.
[18] Miratuar me VKM, Nr.483, datë 29.06 2016.

vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Qëllimi është që të kemi informacion mbi arritjet e progresit dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë.

Monitorimi i Strategjisë ka konsistuar në dy faza kryesore:

1. Raportimi i institucioneve mes pikave të kontaktit dhe anëtarëve të rrjetit, mbi zbatimin e masave për të cilat janë përgjegjëse; dhe
2. Raportimi nga Ministria e Drejtësisë mbi zbatimin e PV-së në tërësinë e tij.

Secili institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo qëllimi politike, objektivi specifik dhe masash të realizuar (mbi bazë aktivitetesh të kryera), buxhetin e parashikuar për vitin raportues, buxhetin e alokuar për periudhën e raportimit, problemet e hasura, hapat e mëtejshme dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, procesi i monitorimit është kryer në nivel objektivash strategjik/specifik dhe masa/aktivitete të parashikuara.

Vlerësimi i progresit të zbatimit të SELP për këtë periudhë raportimi, është kryer nga Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, përmes analizës së të dhënave të përcjella nga institucionet raportuese, duke iu përmbajtur metodës së analizës së parashikuar në Vendimin nr.290, datë 11.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për krijimin e Bazës të të Dhënave Shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)*" dhe Urdhrit nr.157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, "*Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar*".

Analiza e të dhënave është bërë në përputhje me aktet e sipërcituara dhe strukturës orientuese për monitorimin e strategjive dhe planeve të veprimit.

<u>Së pari</u>, me qëllim dhënien e një rezultati jo vetëm sasior por edhe cilësor, të nivelit të zbatimit të masave (realizimi i produkteve) është kryer vlerësimi i aktiviteteve përkundrejt masës.

<u>Së dyti</u>, është analizuar realizimi i objektivave specifikë përmes përllogaritjes së realizimit të masave (realizimi i produkteve).

<u>Së treti</u>, është analizuar realizimi i objektivave strategjikë përmes përllogaritjes së realizimit të objektivave specifike.

Një vlerësim më i përgjithshëm përmbledhës është kryer gjithashtu për realizimin e strategjisë në tërësi për këtë periudhë raportimi.

Ecuria e progresit në periudhën që monitorohet, klasifikohet në këto kategori:

- *E zbatuar:* Institucionet kanë raportuar statusin "E zbatuar" për ato masa/aktivitete të cilat janë përmbushur.
- *Pjesërisht e zbatuar/Në proces:* Institucionet kanë raportuar statusin "Pjesërisht e zbatuar/ Në proces" për ato masa/aktivitete, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.
- *E pazbatuar/ pa raportuar*: Janë raportuar ato masa/aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese, si dhe gjithashtu ato masa/aktivitete për të cilat nuk është dhënë raportim nga institucionet përgjegjëse.

Verifikimi i të dhënave të raportuara është kryer pjesërisht on-line për ato masa të cilat pikat e kontaktit kishin kryer raportimin, si dhe nëpërmjet telefonatave të kryera, për të siguruar saktësinë

e tyre. Gjithashtu, gjatë hartimit të Raportit, janë marrë në konsideratë dy elementë të rëndësishëm të propozuar dhe miratuar nga anëtarët e Rrjetit në takimin e sipërcituar:

1. Raportimi për zbatimin e masës/aktivitetit nga institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e saj, duke vlerësuar dhe mirëpritur dhe kontributet e institucioneve të tjera bashkëvepruese;
2. Në Raportin e rradhës lidhur me Pasaportën e Indikatorëve, kërkohet raportim vetëm nga institucionet e përfshira me masa/aktivitete në Planin e Veprimit

*Trajtimi statistikor është kryer nëpërmjet kodifikimit të përgjigjeve bazuar në raportimet e mbledhura, si dhe duke e llogaritur në mesateren e ponderuar*.

### 1.2 Konsultimi publik

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit Ministria e Drejtësisë e dërgoi dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe e publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtesia.gov.al, në menu prioritete/strategjia ndërsektoriale/strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut.

*Pas hartimit të draft raportit*, Ministria e Drejtësisë në mbështetje të procesit të monitorimit dërgon dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese, shoqërisë civile, si dhe publikon draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit para se të miratohet nga Komiteti Drejtues Sektorial. Një tryezë konsultimi me prezencë të të gjithë përfaqësuesve të institucioneve raportuese zhvillohet gjithashtu për të diskutuar mbi metodologjinë e monitorimit, vlerësimin dhe analizën e informacionit të marrë, problematikat dhe sfidat.

Raporti i miratuar i monitorimit është publikuar në faqen e internetit të https://www.drejtesia.gov.al/strategjia/ Strategjia për edukimin ligjor të publikut, së bashku me një relacion konsultimi për procesin e ndjekur nga inicimi deri në finalizimin/miratimin e tij.

## II. PROGRESI I STRATEGJISË PËR EDUKIMIN LIGJOR TË PUBLIKUT

Strategjia për edukimin ligjor të publikut (SELP) përcakton vizionin, objektivat strategjikë dhe specifikë të edukimit ligjor të publikut (ELP) përgjatë periudhës 2019-2023. Njohuritë mbi ligjin dhe edukimi ligjor i qytetarëve luajnë një rol thelbësor në çdo shoqëri demokratike, ku sjellja, veprimet dhe marrëdhëniet mes tyre disiplinohen nga norma e rregulla ligjore. Aksesi i publikut në njohuritë mbi ligjin, është themelor për garantimin e një sistemi drejtësie efektiv. Kështu, informimi dhe dhënia e njohurive për ligjin, janë përbërësit e kulturës dhe nevojës qytetare për qasjen ndaj shtetit të së drejtës. Për të monitoruar ecurinë e Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, është hartuar raporti i monitorimit, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2020– 2023, i cili mbulon periudhën *1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021*.

DRAFT

## 2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës

Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP) ka si vizion të sajin: ***Investimi në kapitalin njerëzor dhe kohezionin social.***

Strategjia ka identifikuar **4 objektiva strategjikë të ELP për vitet 2019-2023** për arritjen e të cilave duhet të përmbushë objektivat specifikë që duhen arritur deri më 2023, vizionin e saj dhe konkretizimin e tyre, që do të bëhet nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit.

***Objektivi strategjik nr. 1:*** ka për qëllim "Përmirësimin e organizimit dhe funksionimit institucional në ofrimin e ELP".

Ky objektiv strategjik parashikohet të arrihet nëpërmjet realizmit të objektivave specifikë të mëposhtëm:

- *Përmirësimi i legjislacionit, me qëllim parashikimin e parimeve e formave të ELP dhe përfshirjen e ELP në përgjegjësitë e institucioneve;*
- *Rritja e vazhdueshme e burimeve financiare nga buxheti i shtetit dhe donatorët për ofrimin e ELP;*
- *Sigurimi i burimeve njerëzore të nevojshme për të mundësuar ndërhyrjen me efektivitet në ofrimin e ELP.*

***Objektivi strategjik nr. 2:*** ka për qëllim "Garantimin dhe forcimin e bashkëpunimit efektiv ndërinstitucional në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për realizimin e ELP".

Ky objektiv strategjik parashikohet të arrihet nëpërmjet realizmit të objektivave specifikë të mëposhtëm:

- *Institucionalizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, me qëllim koordinimin dhe bashkërendimin e iniciativave të ELP;*
- *Zhvillimi i mekanizmave të bashkëpunimit e komunikimit me publikun e median;*
- *Konkretizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional nëpërmjet realizimit të iniciativave të përbashkëta të ELP.*

***Objektivi strategjik nr. 3:*** ka për qëllim "Ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës".

Ky objektiv strategjik parashikohet të arrihet nëpërmjet realizmit të objektivave specifikë të mëposhtëm:

- *Zhvillimi i kuadrit metodologjik të ofrimit të ELP nga institucionet publike, të pavarura, medias dhe shoqërisë civile;*
- *Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve publike dhe të pavarura, medias dhe shoqërisë civile në ofrimin e ELP;*
- *Inkurajimi për përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit metodologjik dhe kapaciteteve të institucioneve të pavarura, medias dhe shoqërisë civile në ofrimin e ELP.*

***Objektivi strategjik nr. 4:*** ka për qëllim "Sigurimin e performancës efektive dhe efiçente të institucioneve publike dhe të pavarura, medias dhe shoqërisë civile".

Ky objektiv strategjik parashikohet të arrihet nëpërmjet realizmit të objektivave specifikë të mëposhtëm:

- *Rritja e aksesit të publikut në informacionin ligjor dhe pasurimi i vazhdueshëm i njohurive juridike të tyre në përputhje me nevojat specifike;*
- *Informimi dhe ndërgjegjësimi i gjerë i publikut nëpërmjet fushatave mediatike në një fushë ligjore të caktuar apo në trajtimin ligjor të një fenomeni specifik;*
- *Rritja e kapaciteteve të individëve në ushtrimin e të drejtave të tyre, në aftësinë për të kuptuar dhe marrë vendimet e duhura;*
- *Garantimi i informacionit ligjor në kohë reale dhe sa më pranë komunitetit;*
- *Nxitja e aktivizimit të publikut përmes informimit mbi përgjegjësitë e institucioneve dhe mënyrat e pjesëmarrjes në vendimmarrje;*
- *Rritja e pjesëmarrjes dhe rolit të studentëve të drejtësisë dhe profesionistëve të së drejtës në ELP;*
- *Përmirësimi i programit të edukimit ligjor në lëndët bazë të arsimit parauniversitar.*

Për të matur realizimin objektivave strategjik janë caktuar **16 tregues performance,** nga të cilët **3** për *objektivin strategjik nr. 1*, **3** për *objektivin strategjik nr. 2*, **3** për *objektivin strategjik nr. 3* dhe **7** për objektivin strategjik nr.4.

Zbatimi i SELP realizohet përmes Planit të Veprimit 2020 – 2023 i cili përbëhet nga **28 masa të detajuara në 79 aktivitete/nisma-iniciativa konkrete/output,** 35 Institucione përgjegjëse në rol udhëheqës dhe bashkëpunues: Qëndrore, vendore & të pavarura (Ministria e Drejtësisë), Ministritë e linjës, Njësitë e Qeverisjes Vendore & çdo institucion i përcaktuar në PV si përgjegjës për zbatimin e tij. Risi - përfshirja proaktive e OSHC-ve që do të asistojnë të gjitha institucionet publike në kryerjen e veprimtarive dhe iniciativave, si një mekanizëm garantimi për realizimin e masave.

## Statusi i zbatimit sipas Objektivave Strategjikë

| Objektivat | Të zbatuara | Pjesërisht të zbatuara/në proces | Të pazbatuara | Të paraportuara |
|---|---|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të Objektivit Strategjik 1** | 0 | 1 | 0 | 0 |
| **Statusi i zbatimit të Objektivit Strategjik 2** | 0 | 1 | 0 | 0 |
| **Statusi i zbatimit të Objektivit Strategjik 3** | 0 | 0 | 1 | 0 |
| **Statusi i zbatimit të Objektivit Strategjik 4** | 0 | 1 | 0 | 0 |
| **TOTALI** | **0** | **3** | **1** | **0** |

Për periudhën janar-dhjetor 2021, për katër Objektivat Strategjikë **rezultojnë 3 *pjesërisht të zbatuara/në proces, si dhe 1 Objektiv Strategjik i pazbatuar*,** të raportuara këto nga institucionet përgjegjëse.

Rezulton se nga totali prej 28 masash e 79 aktivitetesh të parashikuara në planin e veprimit për periudhën *janar - dhjetor 2021*, statusi aktual i tyre për të 4 Objektivat Strategjikë të Strategjisë, është raportuar si më poshtë:

- 9 masa e 39 aktivitete të zbatuara;
- 10 masa e 4 aktivitete pjesërisht të zbatuara;
- 3 masa e 6 aktivitete të pazbatuara.;
- 2 masa e 4 aktivitete jashtë periudhës së raportimit;
- 4 masa e 26 aktivitete të paraportuara.

| Statusi i zbatimit të aktiviteteve dhe masave për vitin 2021 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të aktiviteteve dhe masave për vitin 2021** | **Masa** | **Aktivitete** |
| Të zbatuara | 9 | 39 |
| Pjesërisht të zbatuara | 10 | 4 |
| Të pazbatuara | 3 | 6 |
| Jashtë periudhës së raportimit | 2 | 4 |
| Të paraportuara | 4 | 26 |
| **Totali** | **28** | **79** |




Përsa më sipër, nga **28 masa e 79 aktivitete të Strategjisë** për periudhën janar-dhjetor 2021, konkretisht 5 masa/8 aktivitete i përkasin Objektivit Strategjik 1, 7 masa/13 aktivitete i përkasin Objektivit Strategjik 2, 4 masa/10 aktivitete i përkasin Objektivit Strategjik 3, si dhe 12 masa/48 aktivitete i përkasin Objektivit Strategjik 4.

Nga analiza e bërë për kontributet e dërguara nga institucionet përgjegjëse, rezulton:

Për **9 masa e 39 aktivitete të zbatuara** për janar-dhjetor 2021, konkretisht 0 masa/1 aktivitet i përket Objektivit Strategjik 1, 3 masa/8 aktivitete i përkasin Objektivit Strategjik 2, 0 masa/3 aktivitete i përkasin Objektivit Strategjik 3, si dhe 6 masa/27 aktivitete i përkasin Objektivit Strategjik 4.

Nga **10 masa e 4 aktivitete pjesërisht të zbatuara** për janar-dhjetor 2021, konkretisht 1masë/1 aktivitet i përket Objektivit Strategjik 1, 3 masa/1 aktivitet i përkasin Objektivit Strategjik 2, 3 masa/0 aktivitete i përkasin Objektivit Strategjik 3, si dhe 3 masa/2 aktivitete i përkasin Objektivit Strategjik 4.

Nga **10 masa e 4 aktivitete të pazbatuara** për janar-dhjetor 2021, konkretisht 3 masa/3 aktivitete i përket Objektivit Strategjik 1, 0 masa/2 aktivitete i përkasin Objektivit Strategjik 2, 0 masa/0 aktivitete i përkasin Objektivit Strategjik 3, si dhe 0 masa/1 aktivitet i përkasin Objektivit Strategjik 4.

Nga **2 masa e 4 aktivitete jashtë periudhës së raportimit** (një masë fillon zbatimin në vitin 2022 dhe 1 masë ka përfunduar në vitin 2020) për janar-dhjetor 2021, konkretisht 1 masë/1 aktivitet i përkasin Objektivit Strategjik 2, si dhe 1 masë/3 aktivitete i përkasin Objektivit Strategjik 4.

Nga **4 masa e 26 aktivitete të paraportuara nga institucionet** për janar-dhjetor 2021, konkretisht 1 masë/3 aktivitete i përket Objektivit Strategjik 1, 0 masa/1 aktivitet i përkasin Objektivit Strategjik 2, 1 masë/3 aktivitete i përkasin Objektivit Strategjik 3, si dhe 2 masa/15 aktivitete i përkasin Objektivit Strategjik 4.

Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP), përbëhet nga 4 Objektiva Strategjikë, për arritjen e të cilave duhet të përmbushë 16 objektivat specifikë.

## 2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integrimit evropian

Aderimi në familjen e Bashkimit Evropian ka qenë një nga pikësynimet më të mëdha të shtetit shqiptar prej gati 3 dekadash tashmë dhe çdo reformë madhore e ndërmarrë ka pasur gjithnjë në fokus përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian.

SELP përputhet plotësisht me dokumentet strategjike në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar, konkretisht me Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit BE–Shqipëri, nënshkruar më 12 qershor 2006 dhe që ka hyrë në fuqi më 1 prill 2009.

Anëtarësimi në Bashkimin Europian është prioritet i Republikës së Shqipërisë. Në kuadër të procesit të anëtarësimit janë nënshkruar dokumente që parashikojnë detyrimet që merr përsipër vendi ynë. Në MSA përcaktohet angazhimi i Republikës së Shqipërisë në forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Në aktet politike dhe strategjike është konkretizuar arritja e këtij synimi. Strategjia "Për edukimin ligjor të publikut" është pjesë e paketës ligjore që synon forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Shqipëria, në respektim të neneve 121 dhe 122 të Kushtetutës ka ratifikuar dhe ka bërë pjesë të legjislacionit të saj të brendshëm aktet ndërkombëtare të sipërpërmendura. Në zbatim të së drejtës ndërkombëtare dhe të së drejtës së brendshme, garancitë dhe detyrat që u lihen institucioneve shtetërore nga këto marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara duhet të zbatohen me rigorozitet.

Përpos këtyre konventave, në kuadër të anëtarësimit të vendit në Bashkimin Europian, nënshkrimi dhe hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) detyron vendin tonë, respektivisht në kuadër të nenit 100 të MSA-së, të rrisë nivelin e përgjithshëm të edukimit të qytetarëve, si dhe të garantojë aksesin në edukim për të gjithë individët pa diskriminim në racë, gjini, besim ose përkatësi fetare. Gjithashtu, në paragrafin e fundit të këtij neni parashikohet se palët duhet të kenë në konsideratë të posaçme njohjen e publikut me *acquis* të BE-së.

Në Raportin e Progresit të vitit 2018 Komisioni Europian ka konstatuar se është shënuar progres në zbatimin e reformës në drejtësi, por Shqipëria duhet të vazhdojë të ndjekë një qasje sektoriale të reformës në drejtësi për të siguruar mekanizma të përshtatshëm të qeverisjes, monitorimit dhe raportimit .

E drejta për edukim është një e drejtë themelore e njeriut, e cila garantohet në terma të përgjithshëm nga një sërë aktesh ndërkombëtare. Ndër këto akte vlen të përmendim Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, Konventën e UNESCO-s Kundër Diskriminimit në Edukim, Konventën e OKB-së kundër Eliminimit të të Gjitha Formave të Diskriminit Racor , Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Konventën e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje dhe Deklaratën e OKB-së mbi Parimet Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit. Në nivel rajonal, e drejta për edukim garantohet nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, konkretisht nga neni 2 i Protokollit 1 të Konventës dhe Vendimi Kuadër i BE-së mbi Statusin e Viktimave në Gjykimin Penal.

E drejta për edukim është pjesë e rëndësishme e angazhimeve të marra nga shtetet anëtare të OSBE-së, ashtu si edhe nga Republika e Shqipërisë. Gjithashtu, në kuadër të nevojës në rritje që qytetarët të njihen dhe zotërojnë konceptet ligjore bazë, Këshilli i Europës miratoi në vitin 2010 Kartën për Edukimin e mbi Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut.

Gjithashtu Strategjia është në përputhje me kërkesat dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për sa i përket përmbushjes së 5 prioriteteve lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

### 2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit

Në Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, si dhe në Planin e Veprimit 2020-2023, janë parashikuar në total 4 objektiva strategjikë.

Për periudhën janar-dhjetor 2021, për katër Objektivat Strategjikë **rezultojnë 3 *pjesërisht të zbatuara/në proces, si dhe 1 Objektiv Strategjik i pazbatuar,*** të raportuara këto nga institucionet përgjegjëse.

**Statusi i zbatimit sipas Objektivave Strategjikë**

| Objektivat | Të zbatuara | Pjesërisht të zbatuara/në proces | Të pazbatuara | Të paraportuara |
|---|---|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të Objektivit Strategjik 1** | 0 | 1 | 0 | 0 |
| **Statusi i zbatimit të Objektivit Strategjik 2** | 0 | 1 | 0 | 0 |
| **Statusi i zbatimit të Objektivit Strategjik 3** | 0 | 0 | 1 | 0 |
| **Statusi i zbatimit të Objektivit Strategjik 4** | 0 | 1 | 0 | 0 |
| **TOTALI** | **0** | **3** | **1** | **0** |




Për periudhat në vijim të zbatimit të Planit të Veprimit kërkohet që të vijohet me ecurinë e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara për realizimin e tyre në kohë dhe me produktet e planifikuara. Me qëllim përmirësimin e zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2020 - 2023, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të monitorimit janë:

- Mungesa e raportimit me cilësi sipas formatit IPSIS, nga institucionet e përfshira në Planin e Veprimit.
- Gjithëpërfshirja e aktorëve të cilët ofrojnë kontribut në fushën e edukimit ligjor dhe grupeve të interesit gjatë fazave të raportimit, konsultimit dhe monitorimit.
- Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse, nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstitucional.
- Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të përcaktuara.
- Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit pranë Drejtorive të Financës, të institucioneve përkatëse, përpara momentit të raportimit pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse/OSHC-ve të përfshira në Planin e Veprimit lidhur me rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV, si dhe mbi rëndësinë e procesit të raportimit.
- Plotësimi i hendekut të evidentuar midis Pasapotës së Indikatorëve dhe Planit të Veprimit, pasi ka institucione/subjekte që nuk janë përgjegjës në Plan Veprimi, por rezultojnë përgjegjës në Pasaportën e indikatorëve.

## 2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

Sipas Strategjisë, financimi i Planit të Veprimit realizohet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e partnerëve ndërkombëtarë.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të masave/aktiviteteve të Planit të Veprimit 2020 - 2023, institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi buxhetin e planifikuar për vitin raportues dhe buxhetin e përdorur në bazë të aktivitetit të kryer. Nga analiza për masat/aktivitetet e raportuara për vitin 2021, buxheti i përdorur rezulton se:

- ***Financimi për periudhën janar-dhjetor të vitit 2020 nga buxheti i shtetit, është në shumën 1,368,227 lekë.***
- ***Financimi për periudhën janar-dhjetor të vitit 2020 nga donatorët, është në shumën 17,580,806 lekë.***

Shumë aktivitete të kryera gjatë kësaj periudhe raportimi, janë në "kosto administrative", një pjesë të kostuara nga vetë institucionet, si dhe për shkak të zhvillimit të tyre on-line në kushtet e pandemisë, të mundësuara këto dhe të mbuluara nga kapacitetet njerëzore dhe financiare të institucioneve zbatuese, duke mos paraqitur kosto shtesë për institucionet zbatuese, në përputhje me parashikimin e bërë në Planin e Veprimit.

*Shumë aktivitete të kryera nga institucionet pjesë përbërëse e Planit të Veprimit, nuk kanë raportuar mbi buxhetin e planifikuar për vitin raportues dhe buxhetin e përdorur.*

# III. PROGRESI I LIDHUR ME OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE MASAT

Në këtë kapitull do të pasqyrohet progresi i arritur në drejtim të objektivave strategjikë, objektivave specifikë dhe masave/aktivitete të Planit të Veprimit 2020-2023[19], për periudhën e monitorimit *1 janar – 31 dhjetor 2021*.

Qëllimet e objektivave strategjikë dhe objektivave specifikë, bëhen të realizueshëm nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara në funksion të zbatimit të masave, të parashikuara për zbatim nga institucionet përgjegjëse dhe bashkëpunëtore të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

Plani i Veprimit 2020-2023 përbëhet nga **28 masa të detajuara në 79 aktivitete,** përkatësisht 5 masa/8 aktivitete për objektivin strategjik 1, 7 masa/13 aktivitete për objektivin strategjik 2, 4 masa/10 aktivitete për objektivin strategjik 3, si dhe 12 masa/48 aktivitete për objektivin strategjik 4.
Aktivitetet janë nisma dhe procese pune të kryera me qëllim arritjen e rezultateve konkrete në përmbushje të objektivave specifike të strategjisë dhe planit të veprimit në zbatim të saj.
Plani i Veprimit 2020-2023, **ka të parashikuar për zbatim përgjatë *vitit 2021*, 26 masa e 75 aktivitete,** nga ku, 1 masë/8 aktivitete prej tyre i përkasin objektivit strategjik 1, 6 masa/11 aktivitete i përkasin objektivit strategjik 2, 4 masa/8 aktivitete i përkasin objektivit strategjik 3, si dhe 9 masa/39 aktivitete i përkasin objektivit strategjik 4.

---

[19]Plani i Veprimit dhe progresi për secilin objektiv është përfshirë në aneksin e këtij raporti.

Progresi i arritur *në vitin 2021*, në kuadër të përmbushjes së aktiviteteve të parashikuara në objektivin strategjik 1, në zbatim të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut, është si më poshtë:

## Statusi aktual i aktiviteteve të Objektivit Strategjik.1

| **Statusi aktual i aktiviteteve të Objektivit Strategjik.1** | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të aktiviteteve të Objektivit Strategjik.1** | **Numri i aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 1 | 13% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 1 | 12.5% |
| Të pazbatuara | 3 | 37.5% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 0 | 0% |
| Të paraportuara | 3 | 38% |
| **Totali** | **8** | **100%** |






***Rezulton se nga 8 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 1, 1 është e zbatuar, 1 është pjesërisht i zbatuar/ në proces zbatimi, 3 janë të pazbatuara, si dhe 3 aktivitete janë të paraporuara nga institucionet përgjegjëse.***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 13% të zbatuara, 12.5% pjesërisht i zbatuar/ në proces zbatimi, 37.5% të pazbatuara, si dhe 38% të paraportuara, nga institucionet përgjegjëse.

*Informacioni i mëposhtëm për periudhën janar - dhjetor 2021.*

- **Ministria e Drejtësisë (MD)**

Bazuar në urdhërin e Ministrit të Drejtësisë, Nr. 315, datë 14.06.2021, "Për ngritjen e grupit të punës, për kryerjen e studimit mbi nevojat për përmirësim të kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e drejtësisë" në bashkëpunim dhe me asistencën e huaj (OSBE), sektori i Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë së bashku dhe me drejtoritë e tjera të përfshira në këtë proces filloi nga puna për hartimin e raportit.

Raporti është hartuar mbi bazën e analizës së kontributeve të dërguara nga anëtarët e grupit të punës të aparatit qendror, të cilat kanë në fokus kuadrin e përgjithshëm ligjor dhe institucional të Ministrisë së Drejtësisë, i cili shërben për të evidentuar nëse në të përcaktohen qartë e në mënyrë të plotë përgjegjësitë e institucionit për të ofruar edukimin ligjor të publikut në përputhje me parimet e ofrimit të tij, duke marrë parasysh edhe mënyrën e ofrimit të këtij edukimi ligjor. Raporti përfundimtar ka si qëllim të kryejë një vlerësim të legjislacionit dhe kuadrit institucional të edukimit ligjor të publikut si dhe si dhe nxjerrjen e rekomandimeve për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional në fushën edukimit ligjor të publikut.

*Aktualisht, raporti i vlerësimit paraprak të kuadrit ligjor dhe institucional të Ministrisë së Drejtësisë, në përmbushje të kompetencave të saj për një edukim ligjor më të mirë të publikut është i konluduar dhe është dërguar për miratim tek eprorët.*

MTM me Urdher nr.19 datë 20.01.2021 ngriti grupin institucional te punes për përmirësime ligjore. MTM ka legjislacion te dedikuar per edukimin dhe trajnimin si dhe terheqjen e publikut

ne vendimmarrje, vecanwrish nw fushwn e mjedisit. Ndaj grupi i punes do jete permanent per te pasur ne vemendje vijimin e edukimit ligjor te\publikut ne aktet e reja.

- **Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile (AMShC)**

AMShC- ja u organizua në përfshirjen e Edukimit Ligjor të Publikut, në Strategjitë e Thirrjes së radhës që përkon me Thirrjen Nr. 13. Si të tillë, në takimet konsultative me përfaqësues të shoqërisë civile, AMShC mori përsipër trajtimin e kësaj teme dhe vendosi t'a përfshijë në programet për financime me grant- sipas zbatimit të pikës konkrete të Strategjisë.
Me shfaqen e pandemisë globale COVID- 19, për vitin 2020, AMShC- së, nga ana e qeverisë, i'u reduktuan fondet e granteve me një vlerë të konsideruar duke bërë të mundur, si rrjedhojë, edhe kanalizimin e fondeve të mbetura, në funksion të sensibilizimit, ndërgjegjësimit dhe përballimit pandemik, ndaj në këto kushte, me tërë përfshirjen e Bordit Mbikqyrës- si organi më i lartë administrativ,
AMShC publikoi si prioritet të saj fokusin për SELP mirëpo, nga subjektet aplikant pretendentë për financim, nuk pati interesim apo projekte në fushën e SELP.
Për vitin raportues, aplikantet nga shoqëria civile, me gjithë ftesën e AMShC- së për këtë prioritet dhe ofrimin e asistencës financiare për këtë fushë strategjike, nuk shprehën interes duke rezultuar me zero përqind financimi i këtij prioriteti. Në mbi 70 projekte të shpallura fituese nga mbi 160 aplikime, asnjë fokus me SELP. AMShC garanton se publikimi I këtij prioriteti dhe fokusi rreth tij, do të jenë permanente në publikimet e Thirrjeve të saj duke nxitur dhe stimuluar ojf- të të aplikojnë në këtë prioritet.

- **Qendra ALTRI**

Përgjatë periudhës Janar - Dhjetor 2021, ka zbatuar projektin "Shërbime sociale të përmirësuara – komunitete të qendrueshme" dhe ka zhvilluar aktivitetet e poshtë shënuara në kuadër të edukimit ligjor të publikut të ndara sipas objektivave të parashikuar në Planin e Veprimit 2020-2023:

- ✓ Forume online mbi ofrimin e ndihmës juridike parësore;
- ✓ Postera informues me informacion të përgjithshme për shërbimet që përfitojnë qytetarët;
- ✓ Video ndërgjegjësuese.

- **Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të Edukimit Ligjor për punëkërkuesit e papunë (të rinjtë, azilkërkues, PAK, NE, Rom/Egjiptian, Viktima të trafikimit/dhunës, LGBTI, personat me liri të kufizuar, emigrantët e kthyer)
Portali AKPA www. puna.gov.al Brandimet, Infot. Punësimi i denjë, protokolli, udhëzuesi. Politikat dhe legjislacioni për vullnetarizmin. Politikat dhe legjislacioni për programet e nxitjes së punësimit në portalin e AKPA dhe në broshura. Politikat dhe legjislacioni për Marrëdhëniet e Punës. Fushatë ndërgjegjësimi nëpërmjet broshurave dhe fletëpalosjeve për migracionin në Gjermani.

- **Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)**

Agjencia Kombëtare e Shoqerisë së I nformacionit, në bazë të VKM 673, datë 22.11.2017 të ndryshuar "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqerisë së Informacionit si organ përgjegjës ndër te tjera dhe për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike:

Nga 1 Janari i vitit 2020, ka filluar një proces i ri për shërbimet publike, atë të ofrimit të aplikimeve për shërbime publike për qytetarët dhe bizneset vetëm online përmes **portalit e-Albania**. Qytetarët dhe bizneset aplikojnë vetëm përmes platformës e-Albania dhe janë punonjësit e administratës publike ata që mbledhin të gjitha dokumentet shtetërore të shërbimeve. Të gjitha të dhënat dhe dokumentet shtetërore tani përdoren dhe ripërdoren, duke i çliruar qytetarët nga barra e grumbullimit të tyre fizikisht në letër në sportelet e shtetit.

Gjithashtu, të gjitha dokumentet shtetërore që më parë ishin kërkuar të mblidheshin nga qytetarët nuk u kërkohen më atyre. Është punonjësi ai që siguron këto dokumente në emër të qytetarit, ose duke shkarkuar versionin e tyre të vulosur elektronikisht nga platforma e-Albania ose duke i kërkuar ato tek institucioni ofrues i këtyre dokumenteve përmes një sistemi elektronik të dedikuar që AKSHI ka ndërtuar vetëm për këtë qëllim.

AKSHI ka vijuar punën për shtimin e shërbimeve elektronike dhe përmirësimin e shërbimeve ekzistuese në portalin unik qeveritar e-Albania, ndërkohë është rritur edhe numri i sistemeve të lidhura me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit. Në portalin e-Albania ofrohen në total 1212 shërbime elektronike deri në fund të vitit 2021.

Risia tjetër që ofron portali e-Albania është **moduli i administratës publike** dhe Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik. Tashmë, nuk është më barrë e qytetarit të paraqitet nga një zyrë në tjetrën për të mbledhur të gjitha dokumentet e nevojshme në plotësimin e dosjes së aplikimit për një shërbim publik. Sot, është punonjësi i administratës publike ai qe ka detyrën e mbledhjes se dokumenteve shoqeruese dhe bashkelidhjes se tyre ne dosjen e aplikimit te qytetarit. Të gjitha këto dokumente ofrohen në modulin për nëpunësit e administratës publike që merren me procedurat e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve me qëllim përmirësimin e disponueshmerinë, cilesisë dhe transparencës së shërbimeve publike si dhe të reduktojnë kohën e zbatimit të procedurave dhe kostot e administratës publike.

Në regjistrin e bazës së të dhënave shtetërore janë të regjistruara të gjitha db shtetërore me të dhënat e tyre primare dhe sekondare si dhe specifikimet teknike përkatëse.

**Promovimi i aksesit të publikut në shërbimet online**

Në web faqen zyrtare të AKSHIT https://akshi.gov.al/ përmes rubrikës “Lajme”, publiku njoftohet për të gjitha shërbimet e reja të cilat shtohen në e-albania.

Është krijuaj dhe app e-albania i cili është lehtësisht i instalueshëm si për sistemet “android “dhe për “apple” në funksion të publikut për të patur tashmë zyrat e shtetit vetëm një klikim larg.

## Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.1

| Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.1 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit Strategjik.1** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 0 | 0% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 1 | 20% |
| Të pazbatuara | 3 | 60% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 0 | 0% |
| Të paraportuara | 1 | 20% |
| **Totali** | **5** | **100%** |






***Rezulton se nga 5 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 1, 1 është pjesërisht e zbatuar/ në proces zbatimi, 3 masa janë të pazbatuara, si dhe 1 masë është e paraportuar nga institucionet përgjegjëse.***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 20% pjesërisht i zbatuar/ në proces zbatimi, 60% e pazbatuar, si dhe 20% paraportuar, nga institucionet përgjegjëse.

DRAFT

## Statusi aktual i aktiviteteve të Objektivit Strategjik.2

| Statusi aktual i aktiviteteve të Objektivit Strategjik.2 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të aktiviteteve të Objektivit Strategjik.2** | **Numri i aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 8 | 61.5% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 1 | 7.7% |
| Të pazbatuara | 2 | 15.4% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 1 | 7.7% |
| Të paraportuara | 1 | 7.7% |
| **Totali** | **13** | **100%** |







***Rezulton se nga 13 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 2, 8 janë të zbatuara, 1 pjesërisht e zbatuar/ në proces zbatimi, 2 aktivitete të pa zbatuara, 1 aktivitet i paraportuar, si dhe 1 aktivitet është përfunduar në vitin 2020 nga institucionet përgjegjëse***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 61.5% të realizuara, 7.7% pjesërisht i zbatuar/ në proces zbatimi, 15.4% të paraportuara, 7.7% jashtë periudhë së raportimit (përfunduar në vitin 2020), si dhe 7.7% të pa raportuar nga institucionet përgjegjëse.

*Informacioni i mëposhtëm për periudhën janar - dhjetor 2021.*

- **Kuvendi i Shqipërisë**

Rezultati i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen e Kuvendit janë politika dhe legjislacion më i përgjegjshëm në përputhje me nevojat e qytetarëve. Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm në këtë pjesëmarrje, pasi ato shërbejnë si një urë lidhëse mes Kuvendit dhe

qytetarëve. Pjesëmarrja e publikut është veçanërisht e rëndësishme kur flitet për grupet vulnerabël, zëri i të cilëve shpesh neglizhohet të dëgjohet nga vendimmarrësit.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit është një element i rëndësishëm i asaj që sot ka filluar të quhet "demokracia pjesëmarrëse". Kjo formë demokracie nuk zëvendëson demokracinë përfaqësuese, por e plotëson atë dhe e bën funksionale. Në këtë kuptim, pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes së Kuvendit krijon kushtet e nevojshme për qytetarët që të marrin pjesë aktive në jetën politike gjatë gjithë legjislaturës dhe jo vetëm në momentin kur i kërkohet të zgjedhin atë; i krijon mundësinë qytetarëve që të avokojnë për interesat e tyre të ligjshme dhe kështu të kontribuojnë për krijimin e një demokracie të qëndrueshme; detyron institucionin të jetë më transparent dhe afron deputetët më shumë me zgjedhësit; kontribuon në përmirësimin e legjislacionit dhe lehtëson implementimin e tij.

✓ Monitorimi i SELP kryhet nga Rrjeti Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut, që është ngritur nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e Kuvendit, dhe që ka në përbërjen e tij përfaqësues të institucioneve më të rëndësishme në nivel qendror dhe vendor, përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile, nga organet e sistemit të drejtësisë si dhe përfaqësues nga fakultetet e drejtësisë. Organet e Rrjetit janë Komisioni Drejtues dhe Bordi Këshillimor.

Për vitin 2021 Kuvendi ka zhvilluar 1 takim të Rrjetit, 1 mbledhje të Komisionit Drejtues dhe një mbledhje të Bordit Këshillimor. Kuvendi ka caktuar një person përgjegjës, nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, për komunikimin e Rrjetit me median dhe publikun.

✓ Në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit është bërë funksional linku i Strategjisë[20], në të cilin janë publikuar gjithë aktet e miratuara deri tani nga Kuvendi, Rrjeti dhe Komisioni Drejtues, konkretisht:

*1.Vendimi i Kuvendit për miratimin e SELP*
*2.VKM nr.878, datë 11.11.202 "Miratimin e planit të veprimit 2020–2023, në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019–2023"*
*3.Rregullorja e Rrjetit*
*4.Vendimet e Komisionit Drejtues*
*5. Procesverbalet e mbledhjeve të Rrjetit dhe të Komisionit Drejtues*

✓ Në vazhdim të detyrave të përcaktuara në Planin e Veprimit, është bërë përditësimi i të dhënave në linkun e krijuar.

Gjithashtu, për komunikimin me anëtarët e Rrjetit është krijuar dhe adresa zyrtare e e-mailit Rrjeti.Selp@parlament.al .

Kuvendi i Shqipërisë, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Strategji për konstituimin e Rrjetit Kombëtar dhe për funksionimin e tij, ka siguruar kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe financiare për funksionimin e Rrjetit.

❖ **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka hedhur në faqen e saj Draft Ligjin për ndryshimin e ligjit nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i cili është kthyer nga Komisioni parlamentar për një studim më të thelluar. Edukimi ligjor i grupeve të interesit për heqjen e qeseve

[20] https://www.parlament.al/Strukture?kategori=2006&strukture=2061

plastike ishte parashikuar pas miratimit të Ligjit, ndaj ky proces do të mundësohet pasi ligji të miratohet.

- **Ministria e Drejtësisë (MD)**

Ministria e Drejtësisë ka publikuar në faqen zyrtare të saj të gjitha aktet nënligjore dhe dokumentat e hartuara në zbatim të drejtësisë penale për të mitur, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me Bashkitë në kuadër të ofrimit të një drejtësie miqësore për të miturit.

✓ Ministria e Drejtësisë udhëheq dhe ndjek hartimin dhe implementimin e dokumenteve strategjike në fushën e antikorrupsionit, bashkërendon punën për hartimin e tyre dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nën-ligjore për paradalimin dhe luftën kundër korrupsionit si dhe luan një rol të rëndësishëm në edukimin ligjor kundër korrupsionit.

✓ Në përmbushje dhe zbatim të SELP, MD/KKK incion edhe aktivitete, takime dhe organizime të ndryshme me qëllim forcimin e njohurive të të qytetarëve dhe publikut të gjerë kundër korrupsionit, rritjen e ndërgjegjëzimit për përdorimin e mekanizmave antikorrupsion dhe evidentimin e nismave dhe veprimtarive në luftën kundër korrupsionit.

- **Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (DNJF)**

Duke qenë tërësisht të vetëdijshëm se rritja e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin e saj përveçse një detyrimi ligjor (neni 8 i ligjit 111/2017), është një nga komponentët me thelbësorë të funksionimit të sistemit të ndihmës juridike dhe forcimit të aksesit të qytetarëve në drejtësi, DNJF i ka kushtuar një vemëndje të shtuar informimit mbi sistemin e ndihmës juridike falas duke u ndalur në hartimin dhe publikimin e materialeve të vizibilititetit si dhe publikimit të postimeve/videove ndërgjegjësuese në rrjetet sociale të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Në total, përgjatë vitit 2021, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka zhvilluar/ka marrë pjesë në rreth 125 takime/aktivitete ndërgjegjegjësuese.

Përgjatë funksionimit të saj, DNJF i ka zhvilluar në këtë kuadër disa aktivitete që kanë në fokus ndërgjegjësimin dhe edukimin ligjor të publikut jo vetëm duke u përqëndruar tek sistemi i ndihmës juridike falas por duke u ndalur edhe në informimin ligjor të publikut përmes faqes zyrtare të dedikuar të drejtorisë, rrjeteve sociale dhe videove informuese.

Zhvillimi i takimeve/aktiviteteve të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura

1. Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese “street law” nga Ndihmës Juridike Parësore Pogradec, në bashkëpunim me shoqatën “Unë Gruaja”, Janar 2021;
2. Takimi i rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Durrës, me temë “Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve” me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në Durrës dhe organizatën jofitimprurëse të autorizuar “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”, Janar 2021;
3. Takimi i rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Shkodër me temë “Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve” me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në Shkodër dhe organizatën jofitimprurëse të autorizuar “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”, Janar 2021;
4. Pjesëmarrja në aktivitetin “Ne mundemi-thuaji jo diskriminimit”, nga Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec në bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Shkurt 2021;

5. Pjesëmarrje në në aktivitetin e organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), "Së bashku në zbatim të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar", Shkurt 2021.
6. Takimi i rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Durrës, me temë "Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve" me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në Durrës dhe organizatën jofitimprurëse të autorizuar "Qendra për Nisma Ligjore Qytetare" dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Mars 2021;
7. Takimi i rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Shkodër me temë "Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve" me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në Shkodër; dorganizatën jofitimprurëse të autorizuar "Qendra për Nisma Ligjore Qytetare" dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Mars 2021.
Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese/ edukimit ligjor të publikut

- ✓ Realizuar intervista televizive nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastër në televizionin lokal Televizioni RTSH Gjirokastër, Janar 2021;
- ✓ Bashkëpunimi me organizatën jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, QSHPLI MKEZH përmes zhvillimit të një aktiviteti ndërgjegjësues pranë Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër me përfaqësues nga grupe vulnerabël, persona të cilët i përkisnin kategorive të veçanta, përfaqësues nga Bashkia Gjirokastër dhe përfaqësues nga Shtëpia e të Moshuarve, Janar 2021; bashkëpunim me UNDP me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në të cilat jepet informacion mbi sistemin e ri të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, kushtet e përfitimit, ofruesit e shërbimit dhe informacione të tjera të nevojshme për informimin ligjor të publikut, Shkurt 2021;
- ✓ Afishimi i posterave dhe shpërndarja e fletëpalosjeve/manualeve të dedikuara për qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore Gjirokastër, me qëllim informimin e qytetarëve dhe orientimin e tyre për përfitimin e shërbimeve pranë kësaj qendre, Janar-Mars 2021;
- ✓ Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Lezhës, Vlorës, Fierit dhe Dibrës, Mars 2021;

(Gjatë muajit mars 2021, ekipi i DNJF organizoi disa fushata ndërgjegjësimi gjatë të cilave u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike).
Fushata ndërgjegjësimi në qytetet e Lushnjës, Tiranës, Durrësit, Fierit, Vlorës, Shkodrës, Lezhës, Dibrës, Pogradecit, Elbasanit.

Promovimi i shërbimit ligjor për qytetarët në qytete të ndryshme te vendit përmes fushatave të ndërgjegjësimit, shpërndarjes së fletëpalosjeve në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi shërbimin juridik falas.

- ✓ Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.

Bazuar në nenin 3 dhe 8 të ligjit 111/2017, "Klinikë ligjore" është njësia përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë, pas lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.
Aktualisht DNJF ka lidhur marrëveshje me 10 Institucione të Arsimit të Lartë dhe konkretisht:
1.Marrëveshje Bashkëpunimi me "Universitetin Marin Barleti";

DRAFT

2.Marrëveshje Bashkepunimi me Fakultetin e Drejtësisë;
3.Marrëveshje Bashkepunimi me Kolegjin Universitar “Bedër”;
4.Marrëveshje Bashkepunimi me Kolegjin Universitar “Wisdom”';
5.Marrëveshje Bashkepunimi me “Universitetin Europian të Tiranës”;
6.Marrëveshje Bashkepunimi me Universitetin “Aleksandër Moisiu Durrës”;
7.Marrëveshje Bashkepunimi me Universitetin “Ismail Qemali Vlorë”;
8.Marrëveshje Bashkepunimi me Kolegjin Universitar “Qiriazi”;
9.Marrëveshje Bashkepunimi me Fondacionin OSFA (Klinika e Ligjit Shkodër);
10. Marrëveshje Bashkëpunimi me “Universitetin Marin Barleti”.
Marrëveshja më e fundit e Bashkëpunimit është lidhur më datë 21.01.2021, mes Ministrit të Drejtësisë dhe përfaqësuesit të Universitetit Marin Barleti, pasuar edhe me një aktivitet promovues të Klinikës.

Përgjatë kësaj periudhe, DNJF ka patur një kontakt të vazhdueshëm me studentët e angazhuar në Klinikat e Ligjit në kuadër të zhvillimit të takimeve/trajnimeve si dhe angazhimit të studentëve në praktika 3 mujore pune pranë DNJF dhe Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, të parashtruara konkretisht si vijon:
-Aktiviteti “Garantimi i ndihmës juridike parësore nëpërmjet ofrimit të këtij shërbimi nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve”, me pjesëmarrjen e Ministrit të Drejtësisë; studentëve dhe përfaqësuesve të Klinikave të Ligjit. (Janar 2021)
Më datë 26.01.2021, u zhvillua takimi i përbashkët me të gjithë përfaqësuesit e Klinikave të Ligjit dhe studentët e angazhuar pranë këtyre Klinikave.
Ky takim u hap me fjalën e Ministrit të Drejtësisë e cila u shpreh mbi rëndësinë e Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve si ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore, të cilat shërbejnë për informimin e qytetarëve për legjislacionin shqiptar, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar, por edhe çështje të cilat lidhen me ndërmjetësimin, këshillimin, përpilimin e akteve, përfaqësimin pranë organeve të administratës shtetërore si dhe shërbime të tjera. Takimi vijoi me ndërveprimin ndëraktiv të përfaqësuesve të Klinikave të Ligjit si dhe studentët të cilët shfaqën një interes të lartë sa i përket zhvillimit të trajnimeve dhe angazhimit në praktikat e punës me qëllim përfitimin e njohurive më praktike mbi sistemin e ndihmës juridike parësore. Stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas zhvilloi trajnimin me temë “Aksesi në drejtësi dhe risitë e ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, mbajtur me studentët e angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve me të cilat Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur marrevëshje bashkëpunimi.
Në këtë takim online u trajtuan temat: “Instrumentët ndërkombëtarë që garantojnë aksesin në drejtësi të qytetarëve ndërmjet ofrimit të ndihmës juridike falas; Sistemi i ndihmës juridike parësore; Sistemi i ndihmës juridike dytësore; Arritjet e sistemit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe sfidat për të ardhmes si dhe parashtrimi i rasteve praktike nga punonjësit i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë”.
Në fund të këtij aktiviteti sudentët u pajisën me një vërtetim pjesëmarrjeje si dhe ju bë me dije mundësia për aplikim në kuadër të praktikave 3 mujore të punës (Prill-Qershor 2021) pranë DNJF si dhe qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Në funksion të përmbushjes së kësaj mase të parashikuar, DNJF ka zhvilluar disa aktivitete të përbashkëta me OSHC-të, OJF-të e autorizuara për të ofruar ndihmën juridike parësore si dhe Klinikat e Ligjit me të cilat kemi lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi, konkretiosht:

Zhvillimi i takimeve/aktiviteteve të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura.

- **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)**

Ka disa vite tashmë që Qeveria Shqiptare nga 25 nëntori- 10 dhjetor të çdo viti i bashkohet fushatës ndërkombëtare të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës ndaj gruas.
Në të gjithë botën kjo fushatë përdoret si një strategji e organizuar si nga individë ashtu dhe grupe me qëllim që t'iu jepet fund të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, apo për të propozuar rrugë të reja qoftë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për të luftuar këtë dukuri me pasoja mjaft negative për të gjithë shoqërinë. Më datën 25 nëntor u lancua hapja e fushatës së 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, nën sloganin "Dëgjo Beso Mbështet", "Botaportokalli", "OrangetheWorld". Lidhur me masat e parashikuara në Strategjinë e Edukimit Ligjor të Publikut MSHMS në kuadër të punës që bën me nëpunësit gjinorë dhe koordinatorët vendorë kundër dhunës në familje, informon dhe trajnon ata lidhur me kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar, i bën pjesë të konsultimeve gjatë rishikimit të akteve ligjore dhe nënligjore, dhe i trajnon me çdo ndryshim ligjor në fushën e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje.

- **Qendra TLAS**

Jane organizuar takime ndërgjegjësuese në komunitet vulnerable në Tiranë, Korçë, Dibër, Lezhë, Durrës, Lushnje.

- **Qendra Altri**

Gjatë periudhës Janar- Prill 2021, në përmbushje të kontratës me World Vision ka realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- ✓ Ofrimi i ndihmës juridike në njësitë administrative të Kurbinit, Lezhës dhe Kukësit;
- ✓ Intervistat në median lokale;
- ✓ Forume të hapura me qytetarë lidhur me prezantimin e rezultateve të projektit mbi ndihmës juridike parësorë; problematikat e konstatuara si dhe rekomandimet për hapat që mund të ndërmerren në vijim për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve në nivel vendor;
- ✓ Video informuese dhe ndërgjegjësuese mbi realizimin e projektit.

Qendra ALTRI me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë , gjatë periudhës Janar –Qershor 2021 ka realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- ✓ Ofrimi i ndihmës juridike parësore për ndërmjetësimin pranë Qendrave të ndihmës juridike parësore Tiranë, Shkodër, qytetarë, Pogradec dhe Durrës.
- ✓ Zhvillimi i procesit të ndërmjetësimit falas për grupet në nevojë Tiranë, Shkodër, Pogradec dhe Durrës;
- ✓ Qytetarë në median sociale;
- ✓ Qytetarë që kanë marrë ndihmën juridike falas për ndërmjetësimin.

- **Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë (DHASH)**

Në zbatim të masave të Planit të Veprimit të SELP, në të cilat Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë është përcaktuar si institucion përgjegjës, më poshtë një informacion i përmbledhur:

- ✓ Sa i takon masës 2.3.4.c të PV, është përgatitur në bashkëpunim me UNDP një Modul Trajnimi specifik për avokatët e listës së ndihmës juridike të garantuar nga shteti, në kuptim të Ligjit të Ndihmës juridike, si dhe është zhvilluar trajnimi përkatës online në datat 15-16 Prill 2021 dhe 21-22 Prill 2021, me pjesëmarrjen e avokatëve të listës së ndihmës juridike dhe përfaqësues të Drejtorisë së Ndihmës Juridike;

- ✓ DHASH në kuadër të Projektit Ndërkombëtar LACHILD, mbi "Përmirsimin e Ndihmës Juridike për Fëmijët në Konflikt me Ligjin", ka organizuar me avokatët që ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti, dhe avokatët e specializuar për ofrimin e ndihmës juridike për të miturit, një trajnim 1 ditor lidhur me problematikat dhe sfidat e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike tek të miturit, si dhe praktikat me të mira europiane, të identifikuara nga projekti LACHILD. Ky trajnim online është organizuar më datë 28 Tetor 2021 me pjesëmarrjen e 84 avokatëve të listës së ndihmës juridike.

## Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.2

| Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.2 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit Strategjik.2** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 3 | 43% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 3 | 43% |
| Të pazbatuara | 0 | 0% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 1 | 14% |
| Të paraportuara | 0 | 0% |
| **Totali** | **7** | **100%** |






***Rezulton se nga 7 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 2, 3 janë të zbatuara, 3 janë pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi, si dhe 1 masë është jashtë periudhës së raportimit, nga institucionet përgjegjëse.***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 43% të realizuara, 43% pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi si dhe 14% jshtë periudhës së raportimit nga institucionet përgjegjëse.

## Statusi aktual i aktiviteteve të Objektivit Strategjik.3

| Statusi aktual i aktiviteteve të Objektivit Strategjik.3 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të aktiviteteve të Objektivit Strategjik.3** | **Numri i aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 3 | 30% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 0 | 0% |
| Të pazbatuara | 0 | 0% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 0 | 0% |
| Të paraportuara | 7 | 70% |
| **Totali** | **10** | **100%** |







***Rezulton se nga 10 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 3, 3 janë të zbatuara, si dhe 7 aktivitete pa raportuar nga institucionet përgjegjëse***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 30% të realizuara, si dhe 70% të pa raportuar nga institucionet përgjegjëse.

*Informacioni i mëposhtëm për periudhën janar - dhjetor 2021.*

❖ **Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA)**

ASPA në Dhjetor të vitit 2020 zhvilloi procesin e vlerësimit të nevojave për trajnim për periudhën 2021-2022 për pushtetin qendror, vendor dhe të pavarur. Ky proces vlerësimi mblodhi nevojat për trajnim në nivel punonjësi, si dhe në nivel njësie organizative (sektor, drejtori) për çështje të lidhura me këto kategori kryesore:

- ✓ Cikli bazë i punës në administratë publike;
- ✓ Teknologjia;
- ✓ Menaxhimi i organizatës;

- ✓ Integrimi Evropian;
- ✓ Çështje ligjore;
- ✓ Grup çështjesh të tjera horizontale;
- ✓ Programi hyrës në administratën publike;
- ✓ Zbatimin e detyrave funksionale në nivel punonjësi si dhe funksioneve në nivel njësie organizative (sektor, drejtori);
- ✓ Kompetencat e veta dhe të deleguara (për pushtetin vendor).

Në përfundim të këtij procesi ASPA hartoi raportin e përgjithshëm të vlerësimit të nevojave dhe raportet individuale të çdo institucioni, duke i përcjellë këto të fundit pranë insitucioneve përkatëse për të njohur raportin, për të marrë komentet dhe për të vijuar punën për dakordësimin e kalnedarit specifik të trajnimeve. Në kuader të këtij procesi konsultimi ASPA zhvilloi edhe takime konsultuese me institucionet. ASPA në përfundim të çdo trajnimi i kërkon pjesëmarrësve të përcjellin nevojat e tyre për trajnim per zhvillim profesional dhe personal.

ASPA gjithashtu vlerëson nevojat periodikisht, ku në përfundim të çdo trajnimi i kërkon pjesëmarrësve të përcjellin nevojat e tyre për trajnim.

ASPA zhvillon periodikisht analizën e nevojave për trajnim. Ky proces pasqyron nevojat e mbledhura nga pyetësori i ANT, korniza strategjike, detyrimet ligjore dhe dokumente të tjera specifike. ASPA e zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnim peridoikisht: një herë në dy vite zhvillon procesin e VNT, çdo vit përditëson këto kërkesa, mbledh nevojat e pjesëmarrësve në përfundim të çdo trajnimi, zhvillon kërkesat specifike që vijnë nga institucionet.

Aktiviteti trajnues është aktivitet vazhdues, si rrjedhojë ky detyrim strategjik është realizuar për atë që parashikon, por vijohet me trajnime. Në total për fushën e barazisë gjinore në periudhën Janar- Dhjetor 2021, në të duke përfshire edhe bashkëpunimet me projektet janë trajnuar 1386 pjesëmarrës.

Në këto trajnime kanë marrë pjesë nëpunësit gjinorë, koordinatorët vendorë të dhunës në familje, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, specialistët e PAK, punonjësit nga drejtoritë për çështje sociale, punonjësit e ndihmës ekonomike, kujdesit social, të financës/buxhetit, strehimit social dhe nëpunës të tjërë të interesuar për këto trajnime. ASPA ka zhvilluar kursin online me çertifikim "Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në nivel lokal” i cili u organizua në bashkëpunim me projektin “Financim transformativ i barazisë gjinore për një qeverisje transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor" (2020-2024), financuar nga Qeveria e Suedisë - SIDA dhe i zbatuar nga UN Women. Në këtë trajnim morën pjesë 33 pjesëmarrës.

ASPA në bashkëpunim me Centro Informazione e Educazione allo Sviluppo Onlus (CIES) po bashkëpunojnë në kuadër të projektit “Gra dhe burra të lirë nga dhuna në Shqipëri. Mbështetje e politikave vendore për mundësi të barabarta”, me mbështetjen financiare të Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS).

Në vijim të zhvillimit të këtyre trajnimeve, që nga muaji mars 2021 është zhvilluar cikli i Workshopeve. Workshopi i I-rë “Parashikimi i të ardhurave dhe workshopi i II-të “Aktorët, konteksti dhe praktikat e mira” dhe workshopi i tretë “Ushtrime praktike mbi asistencën teknike për buxhetimin me qasje gjinore”. Gjithsej janë zhvilluar 30 workshope në bashkitë Cërrik, Devoll, Himarë, Korçë, Lushnjë, Rrogozhinë Selenicë, Kamëz, Prrenjas dhe Pustec dhe kanë marrë pjesë 345 pjesëmarrës.

ASPA ka zhvilluar 3 workshope me temë "Bashkërendimi i punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në familje" të cilët u mundësuan në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me mbështetjen e UNDP Albania, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve te Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj grave ne

Shqipëri", me financim të Qeverisë Suedeze, së bashku me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike ". Këto workshope u zhvilluan për Qarqet Dibër, Kukës, Lezhë, Shkodër, Berat, Durrës, Korçë, Gjirokastër, Elbasan, Tiranë, dhe Vlorë dhe morën pjesë 50 pjesëmarrës.
ASPA ka zhvilluar 1workshop me temë: "Zbatimi i VKM-së nr.666 për reduktimin e braktisjes shkollore – mundësitë dhe sfidat", i cili u mundësuan në bashkëpunim në me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori), në kuadër të nismës "Çdo fëmijë në shkollë", me fonde të UNICEF (Fondi i Kombeve të Bashkuara per Fëmijët). Në fokus të ketij workshopi ishin bursat për kategorinë e nxënësve braktisës të shkollës, që nuk kanë mundësi financiare për të ndjekur arsimin bazë. Pjesemarrës ishin përfaqësuesit e insitucioneve përgjegjëse për zbatimin e VKM-së nr 666, në Bashkitë Kamëz, Berat, Durrës, Dibër, Korçë, Tiranë. Në këte workshop morën pjesë 11 pjesëmarrës.
Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ka zhvilluar kursin online me çertifikim "Ndihma juridike parësore e garantuar nga shteti" i cili është organizuar në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD) dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas në Ministrinë e Drejtësisë, si pjesë e Projektit "Shtrirja e shërbimit të ndihmës juridike për gratë dhe burrat në Shqipëri" zbatuar nga PNUD në partneritet me Ministrine e Drejtesisë dhe me financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).
Pjesëmarrës në trajnim ishin punonjësit me trajnim të posacëm të 10 qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore të Shkodrës, Lezhës, Peshkopisë, Tiranës, Lushnjes, Durrësit, Vlorës, Fierit, Pogradecit dhe Gjirokastrës, si dhe punonjësit në nivel qendror dhe staf i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Në këte kurs trajnimi online morën pjesë 23 pjesëmarrës dhe u çertifikuan 16 pjesëmarrës.
Gjate vitit 2021 ASPA ka zhvilluar 12 webinare në fushën e edukimit ligjor specifikisht për ndihmën juridike parësore të garantuar nga shteti; dhunën në familje dhe rolin e autoriteteve përgjegjëse; barazinë gjinore dhe mosdiskriminimi; të drejtat pronësore të grave; njohjen e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriu dhe; Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut; statistikat gjinore dhe indikatorët e ndjeshëm gjinorë; shërbimin e ndërmjetësimit si mjet alternativ i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve; mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta e informimit në kuadër të ndihmës juridike parësore. Në këto webinare kanë marrë pjesë 537 pjesëmarrës, nga të cilët 241 nga pushteti qëndror, 78 nga pushteti vendor dhe 218 nga institucionet e pavarura.

## Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.3

| **Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.3** | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit Strategjik.3** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 0 | 0% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 3 | 75% |
| Të pazbatuara | 0 | 0% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 0 | 0% |
| Të paraportuara | 1 | 25% |
| **Totali** | **4** | **100%** |







***Rezulton se nga 4 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 3, 3 janë pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi, si dhe 1 masë është e paraportuar nga institucionet përgjegjëse.***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 75% pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi, si dhe 25% e paraportuar nga institucionet përgjegjëse.

## Statusi aktual i aktiviteteve të Objektivit Strategjik.4

| Statusi aktual i aktiviteteve të Objektivit Strategjik.4 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të aktiviteteve të Objektivit Strategjik.4** | **Numri i aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 27 | 56% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 2 | 4% |
| Të pazbatuara | 1 | 2% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 3 | 7% |
| Të paraportuara | 15 | 31% |
| **Totali** | **48** | **100%** |






***Rezulton se nga 48 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 4, 27 janë të zbatuara, 2 pjesërisht e zbatuar/ në proces zbatimi, 3 aktivitete janë parashikuar në vitet në vijim, 1 aktivitet i pazbatuar, si dhe 15 aktivitete të pa raportuara nga institucionet përgjegjëse***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 56% të realizuara, 4% pjesërisht i zbatuar/ në proces zbatimi, 7% jashtë periudhë së raportimit (në vitet në vijim), 2% të pa zbatuara, si dhe 31% të pa raportuar nga institucionet përgjegjëse.

*Informacioni i mëposhtëm për periudhën janar - dhjetor 2021.*

❖ **Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (DNJF)**

Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve është një nga parimet më thelemore të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Formë e mbrojtjes së këtij interesi është edhe aksesi në drejtësi për të gjithë fëmijët në konflikt me ligjin duke garantuar një shërbim ligjor falas dhe cilësor. Nga ky këndvështrim, ishte e nevojshme të bëheshin ndryshime ligjore në legjislacionin e procedurës penale dhe gjithashtu në ligjin "Për ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti".

Ligji 111/2017, "Për Ndihmën Juridike të garantuar nga Shteti", në referim të nenit 11 të tij, tashmë i ka cilësuar të miturit si subjekte të posaçëm të cilët, pavarësisht nga të ardhurat e tyre janë përfitues të drejtëpërdrejtë të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.Konkretisht, fëmijët që jetojnë në institucione të kujdesit shoqëror; fëmijët në kujdestari, të cilët kërkojnë të fillojnë një proces pa pëlqimin e përfaqësuesit të tyre ligjor ose kundër përfaqësuesit të tyre ligjor; viktimat mitur dhe të miturit në kundërshtim me ligjin, në çdo fazë të procedurës penale (për të cilën nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme), mund të përfitojnë që nga këshillimi ligjor (ndihma juridike parësore) deri në përfaqësimin e çështjeve në gjykatë (ndihmë juridike sekondare).

Gjithashtu, duke ritheksuar edhe njëherë mbrojtjen e interesave më të lartë të fëmijëve, është detyrim ligjor që juristët/avokatët qëofrojnë shërbimin e ndihmës jurike falas, të jenë të specializuar në sistemin e Drejtësisë për të mitur përmes ndjekjes së trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme të organizuara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas/Departamenti i Administratës Publike/ Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Pavarësisht lehtësirave që ka sjellë ky ligj në kuadër të përfitimit të shërbimit ligjor falas, vihet re se nga të miturit apo familjarët e tyre, nuk ka kërkesa për përftim të ndihmës ligjore falas. Kjo mund të jetë si shkak i mungesës së informacionit mbi këtë shërbim. Në këto kushte, nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas është planifikuar zhvillimi i një sërë aktivitetesh ndërgjegjësuese duke u ndalur veçanërisht tek kategoritë e veçanta të ligjit.

✓ Pjesë e këtyre aktiviteteve ishte dhe Aktivtiteti “Aksesi në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin” i cili u zhvillua me qëllim ndërgjegjësimin e të miturve pranë Qendrës së Re-Integrimit të të Miturve Kavajë. Ky aktivitet u zhvillua në 3 seksione ku përfaqësuesit e ndihmës juridike falas patën mundësinë të bashkëbisedonin me të miturit e kësaj qendre duke i shpjeguar në mënyrë të thjeshtëzuar se si ata apo prindërit e tyre mund të përfitonin nga shërbimet ligjore falas. Të miturit gjatë takimit informues u shfaqën mjaft të interesuar

për t'u informuar mbi mënyrën e përfitimit të këtij shërbimi. Shumica prej tyre i shprehën problematikat ligjore më të cilat përballen familjarët e tyre të cilat lidheshin më së tepërmi me "detyrimin për ushqim" si dhe me kërkesat për "revokimin e avokatëve të caktuar kryesisht". Me qëllim zgjidhjen e këtyre problematikave dhe përfitimin e shërbimit nga këta të mitur, përfaqësuesit e DNJF shkëmbyen kontaktet me Punonjësit Socialë të Qendrës së Re-Integrimit të të Miturve Kavajë të cilët ishin mëse të gatshëm për bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas në trajtimin e këtyre rasteve.

- ✓ Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, si një nga aktorët mbështetës për projektin "Ligji është jetë – Mbrojeni jetën tuaj!" mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Shoqata "Unë, Gruaja" për Vullnetarët e Ligjit, me temë: "Rritja e kapaciteteve për grupet mbështetëse në lidhje me informacionin ligjor për publikun dhe qasjen e tij në drejtësi".
- ✓ Më datë 5 Mars DNJF me zhvilloi një tryezë të përbashkët me përfaqësues nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Elbasan, Bashkia Elbasan, Drejtoria e Policisë Vendore dhe përfaqesues të Organizatave Jofitimprurëse. Qellimi i kesaj tryeze konsistonte në rendesine dhe efikasitetin që duhet te ketë sistemi i Ndihmës Juridike Paresore dhe fokusin për te rritur urat e bashkëpunimit nderinstitucional në mënyrë të tillë që çdo qytetari t'i garantohet akses në Drejteësi. Tryeza rezultoi mjaft frytdhënëse në kuadër të lidhjes së urave të bashkëpunimit me aktorët ndër institucionalë. Fushata ndërgjegjësimi në qytetet e lushnjes, Tiranës, Durrësit, Fierit, Vlorës, Shkodrës, Lezhës, Dibrës, Pogradecit, Elbasanit.

Promovimi i shërbimit ligjor për qytetarët në qytete të ndryshme te vendit përmes fushatave të ndërgjegjësimit, shpërndarjes së fletëpalosjeve në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi shërbimin juridik falas.

- ✓ Gjithashtu, duke ritheksuar edhe njëherë mbrojtjen e interesave më të lartë të fëmijëve, është detyrim ligjor që juristët/avokatët që ofrojnë shërbimin e ndihmës jurike falas, të jenë të specializuar në sistemin e Drejtësisë për të mitur përmes ndjekjes së trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme të organizuara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas/Departamenti i Administratës Publike/ Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

DNJF në kuadër të ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 8 shkronja "d" dhe "e" të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", ka vijuar me hartimin dhe publikimin e një manuali të thjeshtëzuar mbi kriteret dhe procedurën e përfitimit nga shërbimet e ndihmës juridike falas.

Është finalizuar faqja zyrtare e DNJF dhe është vendosur në dispozicion të publikut. Aktualisht DNJF është duke e përditësuar faqen në mënyrë aktive përmes publikimit të raportimeve të ndryshme në kuadër të transparencës si dhe manualeve në ndihmë të qytetarëve për përfitimin e shërbimit.

- ✓ *Aktivitet me fokus kategoritë Rome dhe Egjiptiane*

Më datë 21 Maj, në Ditën Ndërkombëtare të Diversitetit Kulturor u zhvillua aktiviteti në të cilin morën pjesë aktorë të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti si dhe organizata të shoqërisë civile. Fokusi kryesor i këtij aktiviteti ishte diskutimi mbi respektimin e të drejtave të njeriut, promovimi i dialogut ndërkulturor, lufta kundër racizmit dhe veprimtaria në mbrojtje të pakicave kombëtare. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në cilësinë e institucionit publik që bën të mundur ofrimin dhe garantimin e shërbimeve ligjore falas kundrejt të gjithë qytetarëve në nevojë dhe kategorive të veçanta, i ka kushtuar një vëmendje të shtuar ofrimit të shërbimit ligjor falas për kategoritë më vulnerabël të shoqërisë siç janë komunitetet Rome dhe Egjiptiane.

DRAFT

Zhvillimi i takimeve/aktiviteteve të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura

1. Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese "street law" nga Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec, në bashkëpunim me shoqatën "Unë Gruaja", Janar 2021;

2. Takimi i rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Durrës, me temë "Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve" me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në Durrës dhe organizatën jofitimprurëse të autorizuar "Qendra për Nisma Ligjore Qytetare", Janar 2021;

3. Takimi i rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Shkodër me temë "Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve" me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në Shkodër dhe organizatën jofitimprurëse të autorizuar "Qendra për Nisma Ligjore Qytetare", Janar 2021;

4. Pjesëmarrja në aktivitetin "Ne mundemi-thuaji jo diskriminimit", nga Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec në bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Shkurt 2021;

5. Pjesëmarrje në në aktivitetin e organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), "Së bashku në zbatim të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar", Shkurt 2021.

6. Takimi i rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Durrës, me temë "Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve" me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në Durrës dhe organizatën jofitimprurëse të autorizuar "Qendra për Nisma Ligjore Qytetare" dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Mars 2021;

7. Takimi i rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Shkodër me temë "Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve" me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në Shkodër; dorganizatën jofitimprurëse të autorizuar "Qendra për Nisma Ligjore Qytetare" dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Mars 2021.

- ✓ *__Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese/ edukimit ligjor të publikut__*

1. Realizuar intervista televizive nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastër në televizionin lokal Televizioni RTSH Gjirokastër, Janar 2021;
2 .Bashkëpunimi me organizatën jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, QSHPLI MKEZH përmes zhvillimit të një aktiviteti ndërgjegjësues pranë Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër me përfaqësues nga grupe vulnerabël, persona të cilët i përkisnin kategorive të veçanta, përfaqësues nga Bashkia Gjirokastër dhe përfaqësues nga Shtëpia e të Moshuarve, Janar 2021;
3. Realizuar spoti informues në bashkëpunim me UNDP me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në të cilat jepet informacion mbi sistemin e ri të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, kushtet e përfitimit, ofruesit e shërbimit dhe informacione të tjera të nevojshme për informimin ligjor të publikut, Shkurt 2021;
4. Afishimi i posterave dhe shpërndarja e fletëpalosjeve/manualeve të dedikuara për qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore Gjirokastër, me qëllim informimin e qytetarëve dhe orientimin e tyre për përfitimin e shërbimeve pranë kësaj qendre, Janar-Mars 2021;
5. Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Lezhës, Vlorës, Fierit dhe Dibrës, Mars 2021;
Ekipi i DNJF organizoi disa fushata ndërgjegjësimi gjatë të cilave u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike). Zhvilluar 125

DRAFT

takime/aktivitete ndërgjegjësuese të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura;
Përgjatë vitit 2021, nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas janë zhvilluar 5 intervista televizive në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike,
Aktivitet ndërgjegjësues/ sesioni informues mbi sistemin e ndihmës juridike falas për gratë e dënuara në IEVP: "Ali Demi" (shtyrë për shkak të pandemisë);
Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ofrimit të ndihmës juridike për të miturit në Gjimanze (shtyrë për shkak të pandemisë). Sa i përket spoteve televizive, i jemi drejtuar për mbështetje Ambasadave dhe Organizatave Ndërkombëtare. (Objektiv për vitin 2022).

- **Kuvendi i Shqipërisë**

Kuvendi në kuadër të transparencës së veprimtarisë parlamentare kryen transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave parlamentare, mbledhjeve të komisioneve dhe çdo aktiviteti tjetër parlamentar.
Në situatën e shkaktuar nga pandemia COVID 19, Kuvendi zgjeroi metodat e komunikimit me publikun përmes rrjeteve sociale, faqes së FB të Kuvendit, transmetimit livestream dhe botimeve informative periodike (Në kuadër të funksionit ligjvënës që ushtron Kuvendi dhe me qëllim respektimin e parimit të transparencës në faqen zyrtare të Kuvendit është aktivizuar platforma "Konsultimi i Projektligjeve" që ofron mundësinë e konsultimit online të projektligjeve. Gjatë vitit 2021. Kuvendi ka ndërmarr disa iniciativa në drejtim të edukimit qytetar si:

- ✓ Prezantimi turit virtual;
- ✓ Dyer të hapura për fëmijët;
- ✓ Publikimi i buletineve periodike për veprimtarinë e Kuvendit;

Prezantimi dy lojrave për fëmijët:

- ✓ "Këndvështrimi im" dhe "Kuvendi në pëllëmbë të dorës".

Në fillim të Legjislaturës së re, janë zhvilluar sesione trajnimi lidhur me informimin e tyre për procesin legjislativ.
Në faqen zyrtare të Kuvendit është aktivizuar platforma "Konsultimi i Projektligjeve" që ofron mundësinë e konsultimit online të projektligjeve. Komisionet parlamentare gjatë shqyrtimit të projektligjeve ftojnë grupet e interesit për të sjellë opinionet dhe rekomadimet e tyre

- **Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)**

Në kanalin RTSH Kuvend realizohen transmetimet live të të gjithë seancave plenare dhe të mbledhjeve të komisioneve parlamentare.
Në kanalin RTSH 24, RTSH 1, por edhe në kanale të tjera pjesë e platformës të RTSH-së, në varësi të aktualitetit dhe ndryshimeve të reja ligjore realizohen dhe transmetohen intervista, kronika të përfshira në edicionet e lajmeve ose në emisione politike me specialist të fushës të ftuar në studio ku diskutohen projektligje, ligje etj.
Në kanalin RTSH 1, në emisione të ndryshme si "Mirëmëngjes Shqipëri", "Kohë moderne" "Target", "Autor" etj, trajtohen edhe çeshtje me tematika të ndryshme ligjore me specialist të fushës. Në emisionin "Auditor Arsim" trajtohen problematikat ligjore që lidhen me ligjin për arsimin me ekspert të fushës.
Në kanalin RTSH 2 realizohen dhe transmetohen emisione që prekin legjislacionin në fuqi si:

- ✓ Emisioni i mëngjesit "Ora 7", trajtohen edhe çështje ligjore të ndryshme me ekspert të fushës të ftuar në studio.

- ✓ "Perspektivë", të rinjtë diskutojnë me ekspertë të fushave të caktuara mbi ndërtimin dhe funksionimin e institucioneve dhe praktikave në fushën e legjislacionit.
- ✓ "Ne" emision i cili i dedikohet çështjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me ekspert të fushës të ftuar në studio.
- ✓ "Individi dhe shoqëria" emision i cili i dedikohet edhe përmbushjes se objektivave sociale të Kushtetutës.
- ✓ "Fletore Zyrtare" emision i dedikuar njohjes së publikut me legjislacionin, aktet nënligjore dhe proçeduarat teknike për të drejtat e tyre në fushën e sigurimit social (marrëdhëniet e punës, sigurimi shoqëror, shëndetësor, social shtetëror).

Në Radio Tirana realizohen dhe transmetohen këto programe:

- ✓ "Këshillime juridike" në Radio Tirana 1-emision i përjavshëm, i cili ofron këshillimin e ekspertit për shqetësimet e qytetarëve.
- ✓ "Fletorja zyrtare në Radio Tirana" Talk show. Një studio e hapur për telefonuesit që me ekspertin e sigurimeve shoqërore në studio i jepen përgjigje pikëpyetjeve rreth problematikave duke orientuar dëgjuesit për përdorimin e Sistemit Digjital të qasjes së qytetarit drejt Administratës Publike.
- ✓ "Unë dhe e drejta ligjore", sjell në studio përballë qytetarit ekspertin ligjor që trajton jo vetëm problematikat rreth çështjeve të pronësisë, por edhe të çdo fushe tjetër ligjore.
- ✓ "Të rinjtë dhe e drejta ligjore" trajtohen çështje mbi këshillimin dhe informimin, mbrojtje nga diskriminimi për shkak të ngjyrës, moshës, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, statusit social – ekonomik, mbrojtje dhe këshillim ligjor falas.

- ❖ **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Të gjitha materialet ndërgjegjësuese me karakter informues në lidhje me fushën e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit"), janë të publikuar në faqen zyrtare, në adresat: https://www.idp.al/broshura-e-drejta-per-informim/; https://www.idp.al/broshura-mbrojtja-e-te-dhenave-personale/

- ✓ E drejta për informim:

Lidhur me këtë aktivitet, Zyra e Komisionerit, për periudhën Janar – Dhjetor 2021 ka hartuar dhe publikuar 12 (dymbëdhjetë) Newsletters. "E drejta për informim", e cila është një përmbledhje mujore, me karakter informues, mbi mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit. Newsletters-at mund të konsultohen në linkun: https://www.idp.al/newsletter/
Zyra e Komisionerit bashkëpunoi me organizatën Roma Veritas Albania, nëkuadër të projektit të saj "Edukimi ligjor i studentëve rom, mediatorëve komunitar dhe të shëndetit për të lehtësuar aksesin në drejtësi për komunitetin e tyre", duke nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre. Ky bashkëpunim u fokusua në zhvillimin e trajnimit me studentë dhe pjesëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, për njohjen me të drejtat kushtetuese të aksesit në informacionin me karakterpublik dhe atë të mbrojtjes së privatësisë e të dhënave personale. Në këtë aktivitet të pranishmit u njohën me legjislacionin në të dy fushat e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit, me funksionet dhe rolin e institucionit dhe me raste praktike të adresuar apo ku përfshihen pjesëtarë të këtij komuniteti.

- ✓ Mbrojtja e të dhënave personale:

28 janari, Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale përkoi këtë vit me 40-vjetorin e miratimit të Konventës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave

personale”, e njohur si Konventa 108 e Këshillit të Evropës. Me këtë rast, Zyra e Komisionerit përgatiti një video ndërgjegjësuese, e cila është e publikuar në faqen e saj në internet dhe në kanalin zyrtar në platformën YouTube/Komisioneri KDIMDP. Po ashtu, në kuadër të këtij përvjetori, Këshilli i Evropës përgatiti një video mesazh, me pjesëmarrjen e personaliteteve të komunitetit të profesionistëve të privatësisë. Pjesë e tij u bë edhe Komisioneri shqiptar. Ky video mesazh është i publikuar në platformën Video.
Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2021, Zyra e Komisionerit ka realizuar ciklin e videove ndërgjegjësuese “Guidë për mësuesit e shkollave 9–vjeçare mbi mbrojtjen e të dhënave personale të nxënësve”. Cikli prej 9 videosh bazohet në botimin “Kuadri i aftësimit të mësuesve të shkollave 9-vjeçare mbi mbrojtjen e të dhënave personale të nxënësve”. Ky dokument është miratuar nga Konferenca e 38-të Ndërkombëtare e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC), aktualisht e emërtuar Asambleja Globale e Privatësisë (GPA). Në epokën digjitale, mësuesit kanë një rol kyç për zgjerimin e njohurive që u japin fëmijëve dhe të rinjve për të nxitur përdorimin e përgjegjshëm dhe etik të teknologjive të reja në mbrojtje të të dhënave të tyre personale. Cikli i videove gjendet në kanalin zyrtar në YouTube të Zyrës së Komisionerit, link https://www.youtube.com/watch?v=FGOFEzE52MA

Zyra e Komisionerit publikoi numrin 11 (korrik 2021) dhe 12 (dhjetor2021) të Revistës “Informim Dhe Privatësi”, me përmbledhjen e veprimtarisë institucionale, respektivisht 6-mujori I dhe II të vitit 2021, të cilën e gjeni në linkun në vijim https://www.idp.al/wp-content/uploads/2021/08/revista.pdf

Zyra e Komisionerit, për shkak të situatës të krijuar nga pandemia COVID-19, hartoi “Udhëzuesin për përpunimin e të dhënave personale gjatë telepunës në kuadër të masave kundër COVID-19”. Punëdhënësit me qëllim vazhdimin e aktivitetit të tyre kanë parë si alternativë përdorimin e “telepunës”, si një mënyrë efikase në situata të tilla. Gjatë “telepunës”, meqenëse ka një devijim të mundshëm nga proceset standarde të aktivitetit, potencialisht, ekziston mundësi më e lartë për keqpërdorim të qëllimshëm apo aksidental të të dhënave personale. Në lidhjen më poshtë është publikuar udhëzuesi:https://www.idp.al/ëp-content/uploads/2021/03/Udh%C3%ABzues_p%C3%ABr_p%C3%ABrpunimin_e_t%C3%AB-dh%C3%ABnave_personale_gjat%C3%AB-telepun%C3%ABs_n%C3%AB_kuad%C3%ABr_t%C3%AB_masave_kund%C3%ABr_COVID-19_final.pdf

Zyra e Komisionerit në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën einformimit”, me Urdhrat nr. 187 dhe nr. 188, datë 18.12.2020, miratoi modelet e reja të Programit të Transparencës dhe Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Mbi zbatueshmërinë e këtyre urdhrave, Zyra e Komisionerit gjatë muajit Prill 2021, ka organizuar takime me koordinatorë për të drejtën e informimit të institucioneve qendrore e të varësisë dhe atyre të pavarura, për t’i asistuar për publikimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve sipas formës dhe përmbajtjes së modeleve të rishikuara.

Gjithashtu, në gjysmën e dytë të 2021, Zyra e Komisionerit ka vijuar me zhvillimin e takimeve ndërgjegjësuese me kryetarë të bashkive, sekretarët e përgjithshëm të ministrive, si edhe me institucione të tjera lidhur me vënien në zbatim të Programit të Transparencës së Rishikuar, si dhe regjistrit të kërkesave dhepërgjigjeve të rishikuar, sipas modelit të miratuar nga Zyra e Komisionerit.

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2021, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) zhvilluan një cikël prej 9 trajnimesh online me temë "Balanca midis të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtës për informim". Pjesë e takimeve ishin më shumë se 180 nëpunës civilë të kategorive të ndryshme, me fokus pjesëmarrjen e koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe personat e ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave personale nga Autoritete Publike qendrore e të varësisë, atyre të pavarura dhe njësive të vetëqeverisjes vendore. Organizimi i ciklit të trajnimeve u inicua duke marrë shkas nga raste praktike dhe vështirësitë që shfaqnin institucionet publike në trajtimin në balancë këtyre dy të drejtave kushtetuese. Në to u referuan parashikimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe atij për të drejtën e informimit, si mund të bëhet balanca në rastin e trajtimit të kërkesave për informacion nga Autoritetet Publike. Po ashtu, u diskutua si bëhet dallimi mes informacionit publik që duhet të vendoset në dispozicion dhe cilat janë të dhënat personale, publikimi i të cilave do të cenonte jetën private të individëve. Trajnimet orientuan përfaqësuesit e Autoriteteve Publike mbi mënyrën e administrimit të të dhënave personale të funksionarëve publike dhe për kategoritë e tyre që mund të publikohen apo transparencën për procedurat e partneritetit publik privat. Në këto trajtime u sollën shembuj nga vendimmarrja e autoritetit dhe ajo ndërkombëtare në këtë drejtim.

Zyra e Komisionerit gjatë periudhës prill – maj 2021, në bashkëpunim me Qendrën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) organizuan 2 trajnime me tematikë "E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale në raport me çështjet e P/CVE – standardi bazë ligjor dhe rastet e kufizimeve të tyre". Në këtë aktivitet ishin të pranishëm stafi i Qendrës dhe pjesëtarë të rrjetit të bashkëpunëtorëve të saj nga ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ajo e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucione zbatuese të Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Në takim u trajtua ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ai nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", roli dhe funksionet monitoruese e mbikëqyrëse të Zyrës së Komisionerit, balanca mes këtyre dy të drejtave apo kur ato kufizohen në raport me objektin e veprimtarisë së CVE, si dhe për raste praktike nga të dy këto fusha.

Njohja me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut janë në fokus edhe të trajnimeve të ardhshme të Zyrës së Komisionerit dhe CVE për rrjetin e bashkëpunëtorëve të saj. Në Maj të vitit 2021, Zyra e Komisionerit, ishte pjesë e trajnimit për Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH). Aktiviteti u organizua nga Zyra në Shqipëri e Programit të Asistencës Ndërkombëtare për Trajnimin në Hetimin Penal (International Criminal Investigative Training Assistance Program – ICITAP), në bashkëpunim dhe koordinim me Prezencën e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Pjesëmarrësit u njohën me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale në vendin tonë. Gjithashtu u diskutua edhe për funksionet dhe rolin monitorues e mbikëqyrës të Zyrës së Komisionerit, si dhe për raste nga praktika ku ndërthuret kuadri rregullator i kësaj fushe me atë që normon objektin e veprimtarisë së BKH. Njëkohësisht, të pranishmit u trajnuan edhe për çështje që kanë të bëjnë me korrupsionin, integrimin gjinor dhe me përvojën e punës së prokurorive speciale publike nga rajoni i Ballkanit Perëndimor.

Me rastin e 28 Shtatorit, Ditës së të Drejtës për Informim, Zyra e Komisionerit zhvilloi një aktivitet online hibrid me përfaqësues të sektorit të shëndetësisë, institucione të cilat kanë përballuar peshën kryesore në këtë periudhë të pazakontë, me të cilat është bashkëpunuar ngushtësisht për të garantuar transparencën e veprimtarisë së tyre dhe zbatimin e të drejtës për informim. Në këtë takim u trajtuan zbatimi i legjislacionit për të drejtën e informimit gjatë periudhës së pandemisë nga Autoritetet Publike në sektorin e shëndetësisë. Rëndësi ju kushtua transparencës proaktive nga këto autoritete nëpërmjet Programeve të Transparencës si instrumenti më i rëndësishëm për

transmetimin e informacionit në publik në grupet e interesit, si edhe trajtimi i kërkesave për informacion në afat dhe në përmbajtje, si dhe fuqizimi i rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit. Në takim morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Shëndetit Publik, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore dhe përfaqësues e koordinatorë të së drejtës për informim nga institucione të këtij sistemi nga i gjithë vendi.

Zyra e Komisionerit në zbatim të komponentit 3 të Projektit të Binjakëzimit "Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me acquis e BE" ka zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:

- ✓ webinar-i I dhe II u zhvillua në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare tëAdministratës Publike (ASPA) me mbi 60 përfaqësues të institucioneve qendrore dhe të pavarura;
- ✓ webinar-i III u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesëve të organizatave të ndryshme të shoqërisë civile (OJF) dhe subjekteve mediatike;
- ✓ webinar-i IV u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësues përfaqësuesve të institucioneve publike dhe subjektet private që e ushtrojnë veprimtarinë në sektorin shëndetësor;
- ✓ webinar-i V u zhvillua me përfaqësues nga Prokuroria, Policia e Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
- ✓ webinar-i VI u zhvillua me përfaqësues të institucioneve publike dhe subjekteve private që e ushtrojnë aktivitetin në sektorin bankar/financiar dhe të telekomunikacionit;
- ✓ webinar-i VII u zhvillua me përfaqësues të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), publike edhe private;
- ✓ webinar-i VIII u zhvillua në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës me pjesmarrjen e përfaqësuesve dhe institucioneve të sistemit të drejtësisë;
- ✓ wbinar-i IX u zhvillua me ushtrues të profesioneve të lira (avokatë, ndërmjetës, noterë);
- ✓ webinar-i X kishte temë "Sigurinë e të dhënave personale dhe cenimin e tyre në sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit(TIK)", u zhvillua me përfaqësues nga institucione të pavarura/shtetërore që ofrojnë shërbime nëpërmjet sistemeve TIK dhe nga parti politike që përpunojnë të dhëna personale në kuadër të veprimtarisë së tyre.
- ✓ webinar-i XI u zhvillua me grupe nxënës të shkollave 9-vjeçare të Tiranës "Servete Maçi" dhe "Kosova" për njohjen me parimet/konceptet dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e të dhënave personale të kësaj grup-moshe në mjedisin digjital.

Në të gjitha këto aktivitete, morën pjesë më shumë se 550 persona. Qëllimi i tyre ishte njohja me kuadrin e ri rregullator të fushës të paafruar me GDPR dhe Direktivën e Policisë (disseminations events). Lektorë në këto trajnime ishin ekspertë nga partnerët ndërkombëtarë që mbështesin zbatimin e Projektit të Binjakëzimit, nga Autoriteti Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Garante per Protezione dei Dati Personali), CSI-Piemonte, Itali, instituti austriak "Për të drejtat e njeriut Ludwig Boltzmann" (BIM) dhe nga Zyra e Komisionerit.

- ❖ **Avokati i Popullit (AP)**

AP/MKPT në bashkëpunim me UNHCR ka përfunduar dhe dërguar në pikat e kalimit të kufirit Kapshticë dhe Kakavijë, botimin e fletëpalosjeve të para informuese mbi veprimtarinë e Avokatit të Popullit, si dhe të drejtat ndërkombëtare të migrantëve. Njëkohësisht, do vijojë shpërndarja edhe për pikat e tjera të kalimit të kufirit.Gjithashtu me buxhetin e institucionit janë prodhuar materiale promovuese në total 1538 fletëpalosje, të ndara sipas fushave më poshtë:
100 copë – Ndihma juridike e garantuar nga shteti

100 copë – Informimi për të drejtat e të burgosurve

116 copë – Të drejtat e grave janë të drejtat e njeriut

116 copë – E drejta për kujdes shëndetësor
116 copë – Të drejtat e PAK
116 copë – Të drejtat e minoriteteve kombëtare (Pakicave kombëtare në Shqipëri)

174 copë – Të drejtat e të burgosurve të huaj në Shqipëri. Në kuadër të projektit të ndihmës së huaj financiare nga BE.

Për realizimin e këtij aktiviteti AP ka prodhuar materiale promovuese në total 700 copë, me titull “AP në shërbim të interesit më të lartë të fëmijëve”. Këto materiale promovuese janë shpërndarë përgjatë veprimtarive promovuese të zhvilluara nga institucioni në shkolla të ndryshme të vendit dhe tryeza e konferenca

Në kuadër të aktivitetit të “Ditë të hapura” insitucioni i Avokati i Popullit ka kryer aktivitetet sa më poshtë:

- ✓ Veprimtari “Ditë të hapur”, në datë 18.5.2021, në mjediset e institucionit të Avokatit të Popullit, me përfaqësues, fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjiptian, me karakter informues dhe ndërgjegjësues që synoi, që të drejtat e fëmijëve të respektohen dhe të trajtohen me të gjithë kujdesin e duhur dhe të nevojshëm për moshën e tyre, në interesin më të lartë për ta.
- ✓ Takime informuese/ ndërgjegjësuese në datë 6.5.2021 i organizuar nga Seksioni i Administratës pranë Bashkisë Durrës.
- ✓ Takime informuese/ ndërgjegjësuese në datat 19, 23, 24 Mars 2021 i organizuar nga Seksioni i Administratës pranë Bashkisë Vlorë dhe Orikum.

Në kuadër të marrëveshjes, ndërmjet institucionit të Avokatit të Popullit dhe zyrës së UNICEF Shqipëri, për monitorimin e veprimtarisë administrative të institucioneve përgjegjëse shtetërore, pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në zbatim të ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
Seksioni i Përgjithshëm ka vijuar punën për edukimin e publikut lidhur me barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje si dhe të drejtat e komunitetit LGBTI, PAK, Romët, Egjiptianët dhe të moshuarit, përmes publikimit në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit te Popullit, apo nëpërmjet mediave sociale (facebook), të deklaratave dhe qëndrimeve të institucionit për respektimin e të drejtave të grupeve të ndryshme, kundër përdorimit të gjuhës së urrejtjes, të informacioneve të nevojshme për garantimin e të drejtave dhe të sigurimit të mbështetjes për këto grupe vulnerabël të shoqërisë apo përmes qëndrimeve të institucionit në aktivitetet e zhvilluara nga shoqëria civile për këto grupe.Me synim informimin e shtetasve, në web zyrtat të MEPJ dhe Misioneve Diplomatike e Posteve Konsullore të RSh-së, publikohet informacion mbi lëvizjen e lirë të shtetasve shqiptarë, afatet e qëndrimit pa vizë, motivet e qëndrimit, dokumentacioni i nevojshëm etj. Çdo përditësim informacioni pasqyrohet në web-in zyrtar, nga ku mund të aksesohet prej të gjithë shtetasit shqiptarë të interesuar.

- ❖ **Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)**

Projekti i edukimit kundër krimit të rëndë dhe të organizuar, bashkëpunim i MAS me Ambasadën Angleze, shtrihet në shkollat nëntëvjeçare dhe të mesme të qytetit të Kukësit, Peshkopisë, Shkodrës dhe të Kamzës.
Në 6 mujorin e parë të vitit 2021, është hartuar drafti i parë i manualit të edukimit kundër krimit të organizuar dhe ka filluar procesi i pilotimit.

Ky trajnim përfshin çështje të kuptimit të ligjit dhe të pedagogjisë së edukimit ligjor, të cilat do të trajtohen gjerësisht në fazën e dytë të projektit, i cili parashikon pasurimin e manualit me synimin që ai të përmbushë jo vetëm qëllimin e edukimit kundër krimit të organizuar, por ky edukim, të bëhet pjesë e një edukimi të gjerë ligjor të mësuesve.

Në muajin shtator në IAP, është realizuar trajnimi me mësues "Njohja Institucionale me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe njohjen e detyrimeve Institucionale" nga punonjësit e SHPS, nëpërmjet të cilit është bërë e mundur njohja e mësuesve me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe detyrimet institucionale. ASCAP synon edukimin ligjor të rrjeteve të trajnerëve të lëndëve shoqërore dhe më gjerë trajnimin e mësuesve të kësaj lënde.

Gjithashtu, në periudhën tetor-nëntor 2021, është bërë ngritja e grupit koordinator në çdo shkollë, si dhe personi përgjegjës për planifikimin dhe realizimin e veprimtarive si shkollë dhe në rang ZVAP-je, hartimi i planeve për vitin shkollor 2021-2022, për zbatimin e strategjisë për edukimin ligjor të publikut, SELP, në nivel ZVAP-je dhe miratimi nga DRAP-et, duke përcaktuar dhe planin e aktiviteteve në rang shkolle dhe ZVAP.

Gjatë periudhës shtator-tetor 2021, është vijuar me trajnimin e mësuesve që japin lëndën e Qytetarisë të cilët kanë një qasje më të afërt me problematikat në shkolla dhe trajtojnë në lëndën e tyre tema të dedikuara për çështjet sociale. Shkollat i kanë kushtuar rëndësi aktiviteteve festive të Ditës së Fëmijëve, ku një rëndësi e vecantë i është kushtuar promovimit të të drejtave të tyre në forma rekreative dhe artistike.

Bazuar në dinamikat e jetës së përditshme ekonomike e politike në vend ka filluar puna nga personat përgjegjës për këtë kurrikul në ASCAP për të identifikuar çështjet ligjore që kanë fituar përparësi në trajtesat e sotme dhe për t'i bërë ato pjesë të procesit të të mësuarit në shkollë.
Kjo punë paraprake synon të formulojë edhe draft idetë që do të paraprijnë ndërhyrje të mirë menduara në kurrikulën ekzistuese të lëndës së qytetarisë në arsimin para universitar.
Janë realizuar gjatë periudhës tetor 2021, takime të organizuara nga psikologu/punonjësi social i shkollës, ku është ftuar punonjësja e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve për respektimin e të drejtave të fëmijëve nga pakicat kombëtare dhe kulturore, edukimin ndaj barazisë dhe të drejtave të njeriut, reduktimit të diskriminimit racor dhe gjinor, si dhe për ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me raportimin e dhunës tek ata dhe bashkëmoshatarët e tyre. Mbi bazën e këtyre takimeve është bërë i mundur identifikimi i nxënësve të komunitetit egjiptian, nga mësuesit e trajnuar kundër diskriminimit. Janë realizuar takime konsultuese me nxënës, prindër e mësues mbi menaxhimin efektiv të konflikteve shkollore dhe orientimin e prindërve që kanë adoleshent në konflikt me ligjin, ndjekur nga punonjësi social/psikologu i shkollës. Koordinimi i mësuesve në hartimin dhe prezantimin e projekteve të përbashkëta me bazë SELP. (projekte, ese, konkurse).

Në gjashtëmujorin e parë të këtij vitit 2021, janë zhvilluar takime me mësues të lëndëve të ndryshme të arsimit 9- vjeçar (10 mësues) dhe të mesëm (10 mësues) për edukimin për median dhe informimin për mundësinë e përshtatjes së këtij edukimi, si pjesë e edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut në arsimin para universitar, fillimisht përmes përshtatjes së kurrikulës për trajnimin e mësuesve dhe të moduleve përkatëse për këtë trajnim.
Kjo kurrikul dhe këto module të plota për edukimin për median, kanë si bosht kryesor zbatimin e të drejtave të njeriut (kryesisht e drejta për informim, e drejta për arsimim, detyrimi për të garantuar sigurimin e këtyre të drejtave etj.)

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021, në vijim të punës për trajnimin e mësuesve të mësipërm nga 20 shkolla nga Rajone të ndryshme të vendit, janë zhvilluar veprimtaritë e mëposhtme:
Janë trajnuar 120 mësues të 10 shkollave pilot të të gjitha lëndëve që mësohen në shkollë, në fushën e përdorimit të edukimit për median dhe informimin, të vlerësuar në kuadrin përmbushjes së objektivave kombëtarë që burojnë nga miratimi i Kartës së Edukimit për Qytetari Demokratike dhe të Edukimit për të Drejtat e Njeriut, e Këshillit të Evropës, e në mënyrë të veçantë, e të drejtës së fëmijës për edukim dhe informim dhe për të përmbushur interesin e tij më të mire.

Janë realizuar aktivitete të përbashkëta me organizatën e shoqërisë civile ENGIM dhe LIBERA në projektin "Rise-Alb" për nxitjen e kulturës së ligjshmërisë tek nxënësit e arsimit të mesëm të lartë (Tetor, nëntor 2021, vazhdon deri në maj 2022). ZVAP-të, kanë realizuar koordinimim e veprimtarive edukuese ligjore të IAP-ve me institucionet e tjera në nivel vendor si Bashkia, NJMF, Komisariatin e Policisë, Bordet e prindërve, me individë vullnetarë të fushës së edukimit ligjor (jurist, avokat) dhe prefekturë/nënprefekturën. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, janë zhvilluar vizita të nxënësve në objekte të sekuestruara ku demonstrohet zbatimi i ligjit kundër krimit të organizuar, takime me nxënësit për tema të sociologjisë e të edukimit ligjor.
Shërbimi psiko-social me mësuesit e lëndës Qytetari ka realizuar në klasat AMU informim mbi aktet ligjore që mbrojnë fëmijët nga dhuna, diskriminimi dhe keqtrajtimi, neglizhimi, shfrytëzimi seksual, trafikimi, "Karta Universale e të Drejtave të Njeriut". Nxënësve ju bë e njohur se mund të ndiqen penalisht nëse janë mbi moshën 14 vjec, në rast se kryejnë veprime të jashtëligjshme. Janë realizuar aktivitete informuese dhe sensibilizuese në bashkëpunim me oficeret e policisë te komuniteti në klasat AML për njohjen me aktet ligjore ndaj dhunuesve, abuzuesve, trafikanteve etj. Janë realizuar aktivitete informuese dhe sensibilizuese me oficerët e policisë.

- **Ministria e Drejtësisë (MD)**

Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen e UNICEF, ka vënë në funksionim Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili për herë të parë do të sigurojë unifikimin dhe kompjuterizimin e të dhënave për rastet e drejtësisë penale për të mitur në kohë reale, me qëllim krijimin e një baze statistikore, që ndihmon analizën dhe orientimin e përmirësimit të politikave shtetërore për fëmijët. Miratimi i Ligjit "Për të Drejtat dhe Mbrotjen e Fëmijës" dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, si edhe i një sërë aktesh nënligjore, do të bëjë të mundur që mbrojtja e të drejtave procedurale të fëmijëve të jenë "praktike dhe efektive" dhe jo thjesht "teorike dhe iluzive". Ministria e Drejtësisë ka nisur zbatimin e legjislacionit të miratuar, i cili udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijëve dhe është pararojë e gjithë procesit të zbatimit të tij. Mungesa e të dhënave për të miturit në nivele të ndryshme të drejtësisë penale, nxiti Ministrinë e Drejtësisë me mbështetje të UNICEF të inicionte përpjekjet për krijimin e Sistemit të Integruar te të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe hartimin e dispozitave ligjore për ruajtjen, gjurmimin dhe përpunimin e të dhënave të çështjeve penale që përfshijnë të mitur në konflikt me ligjin.
MD ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi në datën 15.06.2021 me Ministrinë e Arsimit, dhe Rinisë dhe Ambasadën e Italisë në Shqipëri e shoqatën "Avviso Publico". Me këtë Marrëveshje palët përcaktojnë një marrëdhënie bashkëpunimi me qëllim promovimin e përbashkët të një projekti pilot didaktik në 4 shkolla të arsimit të mesëm të lartë, në Tiranë.
Në 23 nëntor 2021 është kryer aktiviteti lançues i projektit në prani të Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ambasadorit të Italisë në Shqipëri, i aksesueshëm në linkunhttps://www.facebook.com/photo.php?fbid=284733073663098&set=a.245995267536879&type=3

DRAFT

Kohëzgjtja e marrëveshjes është viti shkollor 2021-2022.
Aktivitetet e parashikuara për vitin 2021 janë zbatuar, në përputhje me kalendarin e aktiviteteve, përcaktuar nga palët pjesëmarrëse. Më shumë info gjenden në linkun: https://www.drej tesia.gov.al/fjala -e-mbajtur-eministres-gjonajne-takimin-pernenshkrimin-emarreveshjesmidis-ministrisese-drejtesiseministrise-searsimit-sportitdhe-rinise-dheambasades- 202 italiane -per -pilotimin - e -nje – projek

**Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur**

Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen e UNICEF, ka vënë në funksionim Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili për herë të parë do të sigurojë unifikimin dhe kompjuterizimin e të dhënave për rastet e drejtësisë penale për të mitur në kohë reale, me qëllim krijimin e një baze statistikore, që ndihmon analizën dhe orientimin e përmirësimit të politikave shtetërore për fëmijët.
Krijimi i Sistemit të Integruar ishte një detyrim ligjor që rrjedh nga neni 136 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ku përcaktohet se: "*Për mbajtjen e të dhënave të çështjeve penale që përfshijnë të miturit në konflikt me ligjin penal, të miturit viktima dhe dëshmitarë të veprave penale, krijohet "Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur*". Kodi, si edhe VKM nr.149, datë 20.03.2019, ngarkojnë Ministrinë e Drejtësisë për administrimin e të dhënave të këtij Sistemi.
Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur ka si qëllim mbledhjen e të dhënave dhe harmonizimin e statistikave të drejtësisë penale për të mitur, nëpërmjet gjurmimit të të dhënave të ndjekjes penale e procedurave gjyqësore, si dhe përmirësimin e cilësisë së statistikave të harmonizuara, të gjeneruara nga institucionet e parashikuara në këtë vendim.
Sistemi përmban të dhëna elektronike të përditësuara mbi çdo fazë të procedimit penal, përfshirë edhe ekzekutimin e vendimit penal për të miturit, subjekte të këtij Kodi, të dhëna të cilat mbahen në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Sic u përforcua edhe në dispozitat e Kodit, konkretisht në nenin 136, Sistemi i mundëson Ministrisë së Drejtësisë dhe organeve të tjera publike të mbledhin të dhëna dhe të gjurmojnë rastet e të miturve në konflikt me ligjin si dhe të atyre që janë viktima apo dëshmitare të krimit, që nga casti kur hyjnë në zinxhirin e zbatimit te ligjit dhe drejtesise e deri kur dalin prej tij.
UNICEF-i dhe Qendra CEMT kanë realizuar takime të përbashkëta pune, worshope me të gjitha organet kompetente që do të jenë përdoruese të Sistemit si: Gjykata/Prokurori/Polici/Sherbim Prove/Burgje.
Vënia në funksion për herë të parë e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur https://www.drejtesipertemitur.org, i cili do të sigurojë unifikimin dhe kompjuterizimin e të dhënave për çdo fazë të procedimit penal si dhe orientimin e përmirësimit të politikave shtetërore për fëmijët.

**Qendra e Parandalimit të Krimeve për të Miturit dhe të Rinjtë**

Krijimi i institucioneve të reja në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, si kusht për plotësimin e infrastrukturës së nevojshme për të vënë në zbatim aktet nënligjore, masat alternative të dënimit si dhe riintegrimin e të miturve në shoqëri, është një nga hallkat më të rëndësishme për t'u realizuar. Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë është angazhuar në ngritjen e institucioneve të reja si:
Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, institucion ky i konceptuar si një mekanizëm në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, që do të hartojë programe parandaluese dhe do të mbikëqyrë për një periudhë 6-mujore të miturit pas përfundimit të dënimit. Ky institucion është planifikuar me një kapacitet fillestar prej 16 punonjësish. Është përgatitur dhe mbyllur paketa e dokumenteve administrative, përshkrimet e punës, rregullorja e brendshme dhe funksionimi i saj,

plani 1 vjeçar i punës, modelet ririntegruese dhe rehabilituese, si dhe aktet brendshme administrative.

Ngritja e Qendrës për parandalimin e të miturve, ka për qëllim mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të miturit/të rinjve pas kryerjes së dënimit, si dhe do të hartojë programe parandaluese dhe rehabilituese për ta. Aktualisht MD ka përfunduar dokumentacionin i cili normon funksionimin e brendshëm të këtij institucioni si dhe ka vijuar procedurat e rekrutimit të stafit të tij.

Është ngritur rrjeti i përfaqësuesve të institucioneve në nivel qëndror, me rreth 35 përfaqësues në zbatim të proceseve dhe masave të normuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Janë dhënë rekomandime të posaçme nga Ministri i Drejtësisë për Prokurorin e Përgjithshëm mbi zbatimin me efektivitet të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Në kuadër të garantimit të procesit të rregullt ligjor për të miturit, MD ka nxitur krijimin e seksioneve për të mitur pranë organeve ligjzbatuese (POLICI – PROKURORI – GJYKATA). Konkretisht, me mbështetjen e UNICEF u përshtatën në **7 drejtori** rajonale të policisë (nga 12) ambiente miqësore për të mitur, me mbështetjen e projektit suedez u ngritën 3 ambiente miqësore për intervistimin e të miturve në strukturat policore, si dhe me mbështetjen e Ëorld Vision u ngritën dy ambiente miqësore. Janë krijuar ambiente miqësore për të miturit në tre gjykata si Gj**.** Ap. Shkodër, Gj. Rr. Gj. Elbasan dhe Gj. Rr. Gj. Shkodër, si dhe rezulton se janë përshtatur ambientet pothuajse në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë.
Nënshkrimi i 35 marrëveshjeve të bashkëpunimit me pushtetin vendor për trajtimin dhe rehabilitimin e të miturve me masë shmangie pranë qendrave multidisiplinare.
Ka përfunduar projekti teknik dhe projekti i zbatimit i Institutit Multidisiplinar të të Miturve, si një mekanizëm pranë të cilit do të zbatohen programe edukuese, rehabilituese dhe rriintegruese për të miturit e dënuar nga gjykata.
Projekti ka kaluar fazën e oponencës, në fazën në vijim pritet të përgatiten dokumentat e tenderimit për fillimin e projektit.

Aktualisht në cdo organikë prokurorie është përcaktuar pozicioni i koordinatorit. Është miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 5, datë 26.10.2018 "Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale", i cili parashikon udhëzime që duhet të ndiqen nga prokurorët, punonjësit e policisë gjyqësore dhe punonjës të tjerë të prokuroisë gjatë ndëveprimit të tyre me viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale, përfshirë këtu edhe të miturit.

**Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit**, është një objektiv tjetër i Strategjisë për të Mitur, që parashikon masat që do të ndërmerren për krijimin e sesioneve të veçanta për të miturit në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë nëpërmjet miratimit të hartës së re gjyqësor; trajnimin dhe specializimin e profesionistëve të drejtësisë për të mitur; si dhe në krijimin e sistemit elektronik të të dhënave të drejtësisë për të mitur për gjurmimin e rasteve me të mitur.
Lidhur me krijimin e seksioneve Ministria e Drejtësisë ka nxitur procesin e krijimit të hartës gjyqësore nga KLGJ.
Ligji nr.111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti", në referim të nenit 11 të tij, tashmë i ka cilësuar të miturit si *subjekte të posaçëm* të cilët pavarësisht nga të ardhurat e tyre janë përfitues të drejtëpërdrejtë të ndihmës juridike parësore dhe dytësore dhe konkretisht:

- Të miturit viktima të dhunës në familje;
- Të miturit viktima të abuzimit seksual dhe të miturit viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;

- Viktimat e mitur dhe të miturit në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- Fëmijët të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- Fëmijët nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor.

Në kuadër të zbatimit të objektivave të Strategjisë për të Mitur, Ministria e Drejtësisë ka nxitur procesin për krijimin e ambienteve miqësore për të miturit pranë institucioneve ligjzbatuese (POLICI – PROKURORI – GJYKATA).
Krijimi i mjedisive miqësore për të miturit në 7 drejtori rajonale të policisë (nga 12)
*Këshilli i Lartë Gjyqësor*

Lidhur me krijimin e kushteve infrastrukturore të përshtatshme me nevojat e të miturve, KLGJ–ja përzgjodhi katër gjykata, të cilat u vlerësuan se kishin mundësinë praktike për përmbushjen e këtij objektivi, pasi godinat e tyre disponontin ambientet e nevojshme për përshtatje.

Gjykatat e përzgjedhura në këtë mënyrë janë:

Gjykata e Apelit Shkodër;
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër;
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan;

*Këshilli i Lartë i Prokurorisë*

Janë përshtatur ambientet pothuajse në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë. Në këto institucione shfrytëzohen ambientet e krijuara posaçërisht në komisariatet e policisë.

*Prokuroria e Përgjithshme*

Në prokuroritë e shkallës së parë janë marrë masa për përshtatjen e mjediseve/zyrave për ti bërë miqësore për të miturit, duke shfrytëzuar maksimalisht mjediset në dispozicion.

*Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit*

U mundësua ngritja e katër ambienteve miqësore për intervistimin e të miturve, në strukturat policore të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër.

- ✓ Forcimi i bashkëpunimit me pushtetin lokal për trajtimin dhe rehabilitimin e të miturve me masa shmangie nga ndjekia penale (Marrëveshje Bashkëpunimi).
- ✓ Aktualisht, Ministria e Drejtësisë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 33 bashki, bashkëpunim i cili po vijon edhe me bashkitë e tjera.
- ✓ Hartimi i projektit të detajuar të Institutit Multidisiplinar të të Miturve. Është mbyllur procedura e tenderimit dhe është lidhur kontrata.

***Informim dhe Ndërgjegjësim:***

Veprimtari më intensive nga të gjithë aktorët për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për vlerat e DR-së dhe ndërmjetësimit përmes ndërmarrjes së fushatave të gjera sensibilizuese.
Përfshirja e medias në fushata informuese dhe sensibilizuese lidhur me vlerat e aplikimit të drejtësisë restauruese në zgjidhjen e konflikteve dhe mundësinë e ofrimit të këtyre praktikave.
Aktivitete ndërgjegjësuese për edukimin ligjor të fëmijëve; Zhvillimi i aktiviteteve sensibilizuese.

- **Qendra Europiane**

Hartimi dhe krijimi i një aplikacioni për sistemin iOS & Android "Të drejtat e mia", me informacione mbi legjislacionin dhe politikat mbi barazinë gjinore, mbrojtjen nga diskriminimi, fuqizimin e grave dhe vajzave në tregun e punës. CFLI – Canada Fund for Local Initiatives.
Hartimi dhe regjistrimi me zë/figurë/titra i një dokumentari mbi të drejtat e fëmijëve, me fokus mbi të drejtën për arsim të prekur nga pandemia Covid-19.
World Vision Albania
Krijimi dhe regjistrimi me zë/figurë dhe titra i një moduli trajnimi mbi Mbrojtjen ndërkombëtare dhe institucione si GJEDNJ, GJED, GJDBE, hedhur në platformen www.bcompetent.eu. Përgatitja e 10 kurseve të trajnimit online me titra në gjuhët: shqip, anglisht, frëngjisht, greqisht, serbisht dhe spanjisht, për drejtuesit e burgjeve, stafin e burgjeve, stafin civil të burgjeve, mësuesit, psikologët, punonjësit sociale, përkthyesit e burgjeve. Hartimi i nje videoje të animuar. Justice Programe – Bashkimi Evropian.

- **Qendra ALTRI**

Në kuadër të mbështetjes së GIZ, Qendra ALTRI ka zhvilliar aktivitetet e mëposhtme:
- ✓ Hartimi i situatës aktuale mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe ndikimi i Pandemisë.
- ✓ Publikimi i broshurës (200) dhe shpërndarja nëpër strehëza 3. Hartimi i fletëpalosjes mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe impakti i COVID -19(2000);
- ✓ Përgatitja e videove ndërgjegjësues (2) mbi trafikimin e qenieve njerëzore si dhe mbi konkluzionet dhe rekomandimet e raportit;
- ✓ Realizimi i intervistave televizive në median lokale dhe kombëtare mbi konkluzionet dhe rekomandimet e raportit të hartuar.
- ✓ Hartimi i materialeve informuese mbi trafikimin online tek të rinjtë dhe masat parandaluese;
- ✓ Zhvillimi i aktiviteteve informuese me të rinjtë në Tiranë, Elbasan dhe Vlorë;
- ✓ Realizimi i 2 videove informuese mbi shërbimet publike që ofrohen për viktimat e trafikimit. Qendra ALTRI ne kuader te projektit "Trafikimi i qenieve njerëzore në epokën digjitale.

Qendra ALTRI me mbështetjen e GIZ Albania/PACT ka zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:
- ✓ Zhvillimi i fushatës ndërgjegjësuese dhe informuese në rrjetet sociale gjatë muajit Tetor si muaji antitrafik;
- ✓ Hartimi i materialeve informuese si fletëpalosje dhe poster mbi trafikimin online
- ✓ Fletëpalosje mbi trafikimin e qenieve njerëzorë në internet (3000).

- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ)**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Përfaqësitë pasqyrojnë në faqet zyrtare informacion lidhur me kushtet dhe rregullat e udhëtimit pa vizë në BE pë shtetasit shqiptarë. Ky informacion është I aksesueshëm nga të gjithë shtetasit shqiptarë të interesuar. Njëkohësisht përveç informacionit në web zyrtar, shtetasit e interesuar mund të përcjellin kërkesat për informacion dhe asistohen nga stafi konsullor.

❖ **Drejtoria e Antitrafikut dhe Migracionit**

***Masa: 4.2.1.e.*** *Fushata ndërgjegjësimi, për të informuar shtetasit shqiptarë për rregullat dhe kushtet e udhëtimit pa vizë në BE, mundësitë e migracionit të rregullt dhe pasojat e migracionit të parregullt (si edhe aplikimeve të pabazuara për azil).*

Lidhur me zbatimin e kësaj mase, në kuadër të projektit "Ndërgjegjësim dhe Informacion për Sigurinë dhe Fuqizimin për Të Gjithë – Shqipëri", Ministria e Brendshme në bashkëpunim me MASR, MSHMS, MFE dhe IOM, po organizon në 12 qarqet e vendit fushatën ndërgjegjësuese me temë "Shqipëria je ti".

Fushata i përgjigjet prioriteteve të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2019-2022 lidhur me sigurimin e një përgjigjeje efektive ndaj menaxhimit të migracionit nga Shqipëria drejt Shteteve Anëtare të BE-së, përmes një kontrolli më të mirë të kufijve dhe respektimit të regjimit të liberalizimit të vizave, midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian (Zona Shengen), duke siguruar respektimin e plotë të të drejtave të migrantëve.

Ajo synon të ndërgjegjësojë qytetarët shqiptarë, të cilët dëshirojnë të migrojnë në mënyrë të parregullt në Evropë, mbi rreziqet e migracionit të parregullt dhe t'i informojë mbi mundësitë ekzistuese ekonomike dhe arsimore në Shqipëri dhe kanalet e rregullta të migracionit në Evropë.

Në zbatim të kësaj fushate po zhvillohen 12 seminare lokale me përfaqësues të strukturave shtetërore në nivel qendror dhe vendor në secilën prefekturë, për të rritur njohuritë dhe aftësitë e tyre mbi ofrimin e shërbimeve dhe informacionin mbi migracionin e rregullt, arsimin, trajnimin, biznesin, vetëpunësimin dhe mundësitë për punësim për të kthyerit dhe migrantët e mundshëm.

Gjatë aktiviteteve të fushatës, pjesëmarrësit janë informuar për rregullat dhe rregulloret e lëvizjes së lirë në bazë të Marrëveshjes së Liberalizimit të Vizave në zonën Shengen. Po kështu, ata janë informuar për pasojat e migracionit të parregullt, përfshirë ndalimin e hyrjes, kontrabandimin, shfrytëzimin, trafikimin dhe përfshirjen e mundshme në aktivitete kriminale.

Në muajin dhjetor 2021 u zhvilluan 3 takime informuese në Tiranë, Elbasan dhe Korçë dhe në fillim të vitit 2022 do të vijojnë të zhvillohen takime në 9 qarqet e mbetura.

***Masa 4.2.1.ë:*** *"Fushatë ndërgjegjësuese dhe informuese e komunitetit, të rinjve, nxënësve e mësuesve në shkolla (përfshirë Muajin Antitrafik) lidhur me: legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, kuadrin institucional antitrafikim, format, metodat dhe fenomenin e trafikimit të personave dhe njohja me të drejtat e viktimës"*

Në zbatim të kësaj mase, në kuadër të Ditës Evropiane kundër trafikimit të personave, në muajin tetor, i nominuar *"Muaji i Luftës kundër Trafikimit të Personave",* në bashkëpunim me strukturat shtetërore dhe joshtetërore u zhvilluan aktivitete sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese për parandalimin e trafikimit të personave në 12 qarqet e vendit.

Aktivitetet patën për qëllim që të sjellin në vëmendje të të gjitha strukturave shtetërore, por jo vetëm, rëndësinë e ndërmarrjes së një angazhimi të përbashkët në luftën kundër trafikimit të personave, si dhe të përcjellin mesazhe të forta sensibilizuese për rreziqet që sjell trafikimi, rrugët dhe format për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, në veçanti të grupeve vulnerabël.

Veprimtaritë përgjatë këtij muaji u fokusuan kryesisht, në:

- ✓ forume e grupe diskutimi me profesionistë, studentë dhe përfaqësues nga komuniteti;
- ✓ aktivitete ndërgjegjësuese/sesione informuese me nxënës të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare, studentë, përfaqësues nga komuniteti, nga strukturat shtetërore dhe joshtetërore, psikologë, punonjës socialë;
- ✓ ekspozita rajonale me punime të nxënësve të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare;
- ✓ takime ndërgjegjësuese për parandalimin e trafikimit të personave dhe migracionit të parregullt me punonjës të policisë, shërbimit social shtetëror, punonjës të shërbimeve sociale në bashki, punonjës të sistemit arsimor, shëndetësor, psikologë, punonjës socialë, përfaqësues nga komunitetit rom dhe egjiptian, përfaqësues nga biznesi, etj.;
- ✓ marshime sensibilizuese në qarqe;
- ✓ shpërndarje materialesh informuese dhe ndërgjegjësuese lidhur me fenomenin e trafikimit.

Fushatat ndërgjegjësuese për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave do të vijojnë të zhvillohen në vazhdimësi, pasi edhe në Planin e ri të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023, miratuar me VKM Nr. 670, datë 10.11.2021, është parashikuar masa 3.1.1 "*Organizimi dhe ndërmarrja e fushatave masive ndërgjegjësuese në nivel kombëtar dhe lokal për informimin lidhur me format e trafikimit të qenieve njerëzore dhe efektin e tij në jetën e individit dhe shoqërisë, përfshirë ndërgjegjësimin për të drejtat e VT/VMT (veçanërisht gjatë muajve Tetor, si muaj dedikuar çështjeve të antitrafikut), nëpërmjet platformave të komunikimit*:-*Spote ndërgjegjegjësuese mbi fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore në radio & televizion lokale dhe kombëtare; -Fushatë ndërgjegjësimi në terren dhe online nëpërmjet faqes zyrtare të MB dhe mediave sociale në lidhje me mënyrat e shfrytëzimit dhe format e shfaqjes së trafikimit, përfshirë format e trafikimit online; - Materiale ndërgjegjësuese të printuara që synojnë grupet vulnerabël, djemtë, vajzat e gratë, fëmijët, komunitetin rom dhe egjiptian, në zonat urbane dhe rurale*".

## Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.4

| **Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.4** | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit Strategjik.4** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 2 | 16.7% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 5 | 41.6% |
| Të pazbatuara | 0 | 0% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 2 | 16.7% |
| Të paraportuara | 3 | 25% |
| **Totali** | **12** | **100%** |

DRAFT







***Rezulton se nga 12 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 4, 2 masa janë të zbatuara, 5 janë pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi, 2 masa janë jashtë periudhës së raportimit (në vitet në vijim), si dhe 5 masa të pa raportuara nga institucionet përgjegjëse.***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 16.7% të zbatuara, 41.6% pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi, 16.7% jashtë periudhës së raportimit (në vitet në vijim), si dhe 25% të pa raportuara nga institucionet përgjegjëse.

## 2.4 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

***Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP), për arritjen e Objektivave Strategjikë, duhet të përmbushë edhe 16 objektivat specifikë si tregues të arritjeve.***

## Statusi aktual i Objektivave Specifikë

| Statusi aktual i 16 Objektivave Specifikë | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të Objektivave Specifikë** | **Numri i Objektivave Specifikë** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivave Specifikë** |
| Të zbatuara | 2 | 12.5% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 8 | 50% |
| Të pazbatuara | 3 | 18% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 1 | 7% |
| Të paraportuara | 2 | 12.5% |
| **Totali** | **16** | **100%** |






***Rezulton se nga 16 objektiva specifikë të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë, 2 objektiva specifikë janë zbatuar, 8 janë pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi, 3 objektiva specifikë janë të, 1 objektiv specifik është jashtë periudhës së raportimit (në vitet në vijim), si dhe 2 objektiva specifikë rezultojnë të pa raportuara nga institucionet përgjegjëse.***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për objektivat specifikë, është në nivelin 12.5% të zbatuara, 50% pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi, 18% të pa zbatuara, 7% jashtë periudhës së raportimit (në vitet në vijim), si dhe 12.5% të pa raportuara nga institucionet përgjegjëse.

Më poshtë paraqitet një informacion mbi procet e Edukimit Ligjor nga institucinet e pavarura të Sistemit të Drejtësisë.

*(KLP)Këshilli i Lartë i Prokurorisë*

Në kuadër të së drejtës së informimit, KLP ka përgatitur dhe publikuar në faqen e web-it, një seri dokumentacioni që lidhet me organizimin e brendshëm të institucionit, ku përfshihen: përbërja e këshillit, organigrama, vendimet me karakter administrativ të Këshillit, aktet nënligjore të miratuara, struktura e pagave, detajimi i buxhetit, Projekt-Buxheti Afat-Mesëm (2020-2022), Raporti Vjetor për Kuvendin (në shqip dhe anglisht), përmbledhja e paketës ligjore të Reformës në Drejtësi, në të cilën janë përfshirë të gjithë aktet ligjore, etj.

Gjithashtu KLP, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, ka caktuar një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Në këtë kontekst, KLP i është përgjigjur kërkesave për informim në mënyrë sistematike, brenda afateve ligjore, personave fizikë dhe juridikë (organizata jofitimprurëse, organe mediatike etj.).

Sa i përket përmbajtjes së vendimmarrjeve të KLP në mbledhje plenare, në kuadër të transparencës kundrejt publikut, vendimet e Këshillit janë publikuar në faqen zyrtare të web-it, ndërsa regjistrimi audio i mbledhjes plenare është bërë publik në faqen zyrtare brenda 24 orëve nga dita e mbledhjes, në zbatim të Ligjit për qeverisjen, neni 167, pika 2.

Në faqen zyrtare të Këshillit është publikuar axhenda e çdo mbledhjeje, vendimet e marra, si dhe regjistrimi audio, sipas procedurës së sipërcituar.

Njoftimet për mediat, konferencat për shtyp, intervistat dhe aktivitetet të tjera të KLP (ceremonia e betimit të prokurorëve të rinj, takime me përfaqësues të prokurorive të rretheve gjyqësore, takime me përfaqësues diplomatik, pjesëmarrje në trajnime, seminare, takime bilaterale etj.) janë pasqyruar në faqen zyrtare të Këshillit. Për ta bërë komunikimin me publikun sa më të frytshëm, pavarësisht se KLP nuk ka detyrime konkrete për edukimin ligjor të publikut sipas Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP), KLP ka prezantuar Strategjinë e Komunikimit të KLP. Ky dokument u hartua posaçërisht për zhvillimin dhe përmirësimin e komunikimit me publikut dhe atë institucional dhe ndërinstitucional. Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të Këshillit të Europës për komunikimin me median dhe publikun për gjykatat dhe prokuroritë, hartimi i strategjisë së komunikimit synon rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

*(PP) Prokuroria e Përgjithshme*

Lidhur me objektivat strategjikë të Edukimit Ligjor për Publikun, miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 47, datë 18.04.2019, në përmbushje të detyrimit ligjor parashikuar në nenin 61 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

dhe në kuadër të organizimit institucional, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm është caktuar prokurori për marrëdhëniet me publikun.

Në plotësim të kuadit normativ, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar Udhëzimin e Përgjithshëm nr.5, datë 30.07.2019 "Marrëdhëniet me Publikun në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm", me synim unifikimin e marrëdhënieve me publikun dhe median në veprimtarinë e prokurorive dhe rritjen e transparencës, si një mundësi që publiku të njohë punën e prokurorisë në mbrojtje të të drejtave të tij, për rritjen e besimit të publikut në sistemin e prokurorisë dhe inkurajimin për pjesëmarrjen e tij në parandalimin dhe denoncimin e krimit si dhe në procesin e reformave në të cilat prokuroria është e përfshirë, duke ruajtur integritetin, pavarësinë e paanësinë, sekretin hetimor, parimin e rëndësishëm të prezumimit të pafajësisë, mbrojtjen e të drejtave të të miturve si dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Nga ana tjetër, çdo akt normativ i Prokurorit të Përgjithshëm publikohet në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

*KLGJ (Këshilli i Lartë Gjyqësor)*

Duke vlerësuar shumë faktin se njohuritë mbi ligjin dhe edukimi ligjor i qytetarëve ka një rol të rëndësishëm në demokratizimin e shoqërisë, ku qytetarët të kuptojnë më së miri të drejtat e tyre ashtu dhe rregullat e përcaktuara, dhe prej nga ku të nisin të kërkojnë lidhur mbi këto drejta apo dhe t'i respektojnë ato, edhe KLGJ i ka dhënë një rëndësi të veçantë aksesit të publikut në njohuritë mbi ligjin, si një premisë për një sistem drejtësie efektive.

Ndaj dhe KLGJ në ushtrimin e veprimtarisë së tij, mban në konsideratë që qytetarët por dhe subjektet e vendimmarrjes së tij të kuptojnë rolin, kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij institucioni të ri të krijuar nga ndryshimet kushtetuese miratuar në gusht të vitit 2016. Angazhim i thellë i KLGJ dhe i stafit administrative të tij ka qenë në të gjithë komunikimet, trajtimet e kërkesë/ankesave të ardhura nga publiku apo dhe institucione të ndryshme, ku janë informuar dhe janë orientuar lidhur me mënyrën e trajtimit të kërkesave/ankesave të tyre, rolin dhe e secilit prej institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë të krijuar në kuadër të Reformës në Drejtësi.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i angazhuar për rikthimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor, si një ndër objektivat e tij kryesorë. Këshilli i Lartë Gjyqësor synon përmirësimin e marrëdhënieve të gjyqësorit me median dhe publikun, lehtësimin e të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat, të veprimtarisë dhe shërbimeve që ofrohen nga gjykatat, të mënyrës së marrjes së vendimeve dhe kufizimet në punën e gjyqtarëve. Transparenca, ndershmëria, llogaridhënia dhe besueshmëria janë parimet udhëheqëse të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe komunikimi do të kryhet në mënyrë profesionale, në çdo kohë. Përtej vlerave thelbësore të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykatave, vendimmarrja e përditshme e gjyqësorit është e drejtuar nga këto parime të rëndësishme, si dhe: Aksesi, Efektiviteti, Efikasiteti, Barazia, Dinjiteti, Drejtësia, Besueshmëria, Respekti dhe Transparenca.
Ligji Nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë" parashikon krijimin e pozicioneve të reja në gjykata, duke përfshirë disa pozicione kryesore për komunikimin me median dhe publikun.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, përmes Anëtarit të tij të caktuar për kryerjen e detyrave në lidhje me Marrëdhëniet me Publikun, Gjyqtarëve të Medias dhe Nëpunësve për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun (NMMP) në gjykata, kanë për detyrë të sigurojnë që informacioni që i ofrohet publikut të jetë i saktë dhe në kohë, duke përdorur një sërë mjetesh, përfshirë edhe faqet e internetit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë dhe për zbatim të nenit 91 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", me vendimin nr. 68 datë 24.04.2019 ka caktuar anëtarin për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun, si dhe me vendimin nr. 280 datë 10.12.2019, ka caktuar gjyqtarët për median për çdo juridiksion apeli.

Me qëllim garantimin e parimeve udhëheqëse të komunikimit të sistemit gjyqësor, aksesi, komunikimi profesional, besueshmëria, përgjegjësia, transparenca, ndershmëria, llogaridhënia si dhe angazhimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për rikthimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor, është **hartuar "Plani strategjik i komunikimit për sistemin gjyqësor"[21],** në të cilin pasqyrohet vizioni dhe misioni; vlerat thelbësore të gjyqësorit; qëllimet e komunikimit, parimet kryesore të komunikimit të gjyqësorit; roli i Këshillit të Lartë Gjyqësor, i gjyqtarit të medias, i nëpunësit të marrëdhënieve me median dhe publikun (NMMP), i bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës, i faqeve të internetit të gjykatave, i mediave sociale në zbatimin e parimeve të komunikimit si dhe sfidat e mundësitë.

Këshilli, për të garantuar përmirësimin e aksesit, të kuptuarit dhe besimit në gjykatat e Shqipërisë, ka hartuar këtë "Plan Strategjik të Komunikimit" për Informimin e Medias[22] dhe Publikut, dokument i cili do të orientojë veprimtarinë e gjyqësorit shqiptar. Ky plan komunikimi, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe kombëtare, miratohet pas konsultimit me gjykatat, për vetë rëndësinë e tij.

Ekziston një angazhim i qartë për Gjyqtarët e Medias dhe NMMP për të përballuar sfidën e marrëdhënieve me publikun dhe mediat që mbulojnë gjykatat në Shqipëri. Tashmë ka nisur një qasje e re, me njerëzit e përkushtuar për të siguruar informacion të saktë për median dhe publikun, në funksion të përmirësimit të transparencës së veprimtarisë së gjyqësorit.

KLGJ dhe gjykatat janë të përkushtuar të punësojnë profesionistë me kualifikim të lartë për të shërbyer si NMMP dhe të garantojnë që ata janë të trajnuar dhe vënë në zbatim praktikat më të mira për dhënien e informacionit dhe bashkëveprimin me median dhe publikun në mënyrë sa më efikase. NMMP do të punojnë me Gjyqtarët e Medias për të siguruar që veprimet e gjykatave dhe procedurat e shërbimet gjyqësore janë të kuptueshme dhe lehtësisht të disponueshme.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i gatshëm të bëjë gjithçka që mundet, për të siguruar që gjyqësori shqiptar të funksionojë me transparencë të plotë dhe është i përkushtuar për arritjen e standardeve më të larta të përgjegjshmërisë publike në komunikimin me median dhe publikun.

Plan Strategjik për Sistemin Gjyqësor i miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ka një nga objektivat e tij thelbësore, forcimin e marrëdhënieve midis gjyqësorit dhe publikut, ofrimin dhe zbatimin e mënyrave novatore dhe të përshtatshme për palët e interesit, në veçanti përmes sistemeve online, për rritjen e bashkëpunimit me to të KLGJ, personelit administrativ dhe gjykatave; marrjen e një roli aktiv për të ndikuar në politikat publike dhe për të nxitur ndryshimet e duhura specifike, lidhur me mënyrën se si pushtetet e tjera ndër veprojnë me KLGJ, për planifikimin në sistemin gjyqësor; vendosjen e një strategjie komunikimi për të siguruar marrëdhënie transparente, proaktive dhe informuese të medias dhe publikut; publikimin në kohë i vendimeve gjyqësore në portal/faqen e internetit të KLGJ.

---

[21] Miratuar me vendimin nr. 590, datë 26.11.2020 "Për miratimin e "Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor".

[22] Vendim nr. 592, datë 26.11.2020 "Për miratimin e rregullores "Për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median".

## 3.1 Histori suksesi (përmes masave prioritare)

Ministria e Drejtësisë/ Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit organizon çdo vit “Javën e Integritetit”, një fushatë e rëndësishme dhe e sukseshme për promovimin e integritetit, që është vlera dhe rezistenca më e mirë kundër korrupsionit. Gjithashtu përmes kësaj fushate synohet rritja e ndërgjegjësimit si dhe promovimi i sjelljes etike, transparencës, llogaridhënies, përgjegjshmërinë si dhe përpjekjet e ndërmarra prej aktorëve të ndryshëm në luftën kundër korrupsionit.
Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin nr.47, datë 18.4.2019, ka miratuar Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, pjesë e paketës së Reformës në Drejtësi.
Strategjia për edukimin ligjor të publikut synon rritjen e ndërgjegjësimit ligjor publik në Shqipëri, me qëllim që qytetarët të jenë në gjendje të marrin pjesë aktivisht dhe efektivisht në një mjedis social dhe ekonomik të rregulluar ligjërisht.

Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen e Kuvendit është një kompleksitet aktivitetesh, funksioni primar i të cilave është rritja e ndërgjegjësimit për parlamentin si institucion, lehtësimi i shpërndarjes dhe shkëmbimit të informacionit, ideve dhe pikëpamjeve mes qytetarëve dhe organeve të Kuvendit.
Rezultati i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen e Kuvendit janë politika dhe legjislacion më i përgjegjshëm në përputhje me nevojat e qytetarëve. Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm në këtë pjesëmarrje, pasi ato shërbejnë si një urë lidhëse mes Kuvendit dhe qytetarëve. Pjesëmarrja e publikut është veçanërisht e rëndësishme kur flitet për grupet vulnerabël, zëri i të cilëve shpesh neglizhohet të dëgjohet nga vendimmarrësit.
Pjesëmarrja e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit është një element i rëndësishëm i asaj që sot ka filluar të quhet “demokracia pjesëmarrëse”. Kjo formë demokracie nuk zëvendëson demokracinë përfaqësuese, por e plotëson atë dhe e bën funksionale. Në këtë kuptim, pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes së Kuvendit krijon kushtet e nevojshme për qytetarët që të marrin pjesë aktive në jetën politike gjatë gjithë legjislaturës dhe jo vetëm në momentin kur i kërkohet të zgjedhin atë; i krijon mundësinë qytetarëve që të avokojnë për interesat e tyre të ligjshme dhe kështu të kontribuojnë për krijimin e një demokracie të qëndrueshme; detyron institucionin të jetë më transparent dhe afron deputetët më shumë me zgjedhësit; kontribuon në përmirësimin e legjislacionit dhe lehtëson implementimin e tij.

Ligji nr.111/2017, “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, ka si qëllim të sigurojë akses të barabartë në drejtësi përmes garantimit dhe funksionimit të sistemit të ndihmës juridike falas. Këto detyra të Drejtorisë, tregojnë qartë se fushatat e ndërgjegjësimit, informimi i publikut mbi sistemin e ndihmës juridike, kushtet për përfitimin e saj si dhe bashkëpunimi me aktorët kryesorë të përcaktuar në ligj për ofrimin e ndihmës juridike (OJF, klinikat e ligjit), janë jo vetëm detyra funksionale të përcaktuara me ligj por edhe pjesë përbërëse e misionit të drejtorisë në funksion të mirëadministrimit/mirëfunksionimit të sistemit të ndihmës juridike falas. Thënë këtë, fushëveprimtaria e DNJF-së është ngushtësisht e lidhur me informimin dhe edukimin ligjor të publikut e rrjedhimisht lidhet dhe me Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-23.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është garantimi i zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Në përmbushje të tij, Zyra funksionon si mekanizëm për vendosjen e ekuilibrit mes këtyre dy të drejtave kushtetuese. Parimet dhe tiparet thelbësore të saj janë pavarësia, paanësia, besueshmëria dhe transparenca ndaj publikut.
Ushtrimi i të drejtës për informim në mënyrë proaktive nxit transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve publike, si një nga shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës.

DRAFT

Në kuadrin e bashkëpunimit që institucioni i Avokatit të Popullit ka me institucionet, organizatat ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile në fushën e mbrojtjes, promovimit dhe garantimit të të drejtave të njeriut, gjatë kësaj periudhe mund të përmendim marrëveshjet e bashkëpunimit me zyrën UNICEF Shqipëri, marrëveshjen e mirëkuptimit me zyrën e Save the Children, Shqipëri për zbatimin e projektit "Children Stand Up", marrëveshjen e bashkëpunimit me zyrën e Komisionerit të lartë të Kombeve të Bashkuara (UNHCR) në kuadër të projektit "Refugjatët dhe Azilkërkuesit në vendet e Evropës Juglindore", marrëveshja B-ComPetent "Rritja e Kompetencave në Stafin e Burgjeve në Evropë"etj.

Shkolla e Magjistraturës ndikon në edukimin ligjor të publikut nëpërmjet trajnimit të profesioneve të caktuara, të cilat, gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre funksionale, ndikojnë në edukimin e publikut mbi ligjin.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i angazhuar për rikthimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor, si një ndër objektivat e tij kryesorë. Këshilli i Lartë Gjyqësor synon përmirësimin e marrëdhënieve të gjyqësorit me median dhe publikun, lehtësimin e të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat, të veprimtarisë dhe shërbimeve që ofrohen nga gjykatat, të mënyrës së marrjes së vendimeve dhe kufizimet në punën e gjyqtarëve. Transparenca, ndershmëria, llogaridhënia dhe besueshmëria janë parimet udhëheqëse të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe komunikimi do të kryhet në mënyrë profesionale, në çdo kohë. Përtej vlerave thelbësore të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykatave, vendimmarrja e përditshme e gjyqësorit është e drejtuar nga këto parime të rëndësishme, si dhe: Aksesi, Efektiviteti, Efikasiteti, Barazia, Dinjiteti, Drejtësia, Besueshmëria, Respekti dhe Transparenca.

## 3.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën *1 janar – 30 dhjetor 2021*, rezulton se fushat që kanë treguar performancë jo rezultative të shoqëruar nga problematika për këtë periudhë raportimi, janë aktivitet e pa realizuara/zbatuara.
Në adresimin e performancës nga institucionet, rezulton se mungesa e burimeve njerëzore specifike (kapacitete institucionale); mungesa e buxheteve specifike për kryerjen e disa veprimtarive të parashikuara; vonesa në kryerjen e procedurave/fazave të kryerjes së aktiviteteve specifike, janë arsye dhe shkaqe që kanë çuar në mosrealizim të objektivave të parashikuar për periudhën e raportimit.
Çështjet që lidhen me komunikimin, informimin, proceset operacionale dhe sistemet e komunikimit brenda vetë institucioneve raportuese, çështje të tjera që lidhen me mjedisin rregullativ të brendshëm që ndikojnë direkt zbatueshmërinë e masave dhe aktiviteteve të planifikuara për zbatim, janë sfida, mangësi dhe shkaktarë të joefikasitetit në disa objektiva për këtë periudhë zbatimi (viti 2021).

Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional në shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit, do të shërbejnë në përmirësimin e nivelit të realizueshmërisë së objektivave vjetorë si dhe masave dhe aktiviteteve që paraqet Plani i Veprimit 2020 - 2023.

Me qëllim përmirësimin e zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2020-2023, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të zbatimit dhe të monitorimit janë:

- Njohja dhe aplikimi i metodologjisë së re të monitorimit dhe raportimit të planit të veprimit në përputhje e agjendën e mirëqeverisjes dhe formatin IPSIS të dokumenteve strategjike.

Informacioni i raportuar duhet të përpunohet dhe dërgohet në përputhje me kategorinë e informacionit, të jetë faktik, të ketë evidenca të qarta dhe të dhëna analitike. Çdo qëllim politikash duhet të ndërlidhet me nivelin e zbatueshmërisë së masave/aktiviteteve dhe buxhetin e planifikuar dhe të buxhetit faktik të përdorur.

- Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit lidhur me rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV, si dhe mbi rëndësinë e procesit të raportimit.
- Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse edhe nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstitucional.
- Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit tek Drejtoritë e Financës, përpara momentit të raportimit.
- Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të raportimit të parashikuara në Strategji.
- Plotësimi i hendekut të evidentuar midis Pasapotës së Indikatorëve dhe Planit të Veprimit, pasi ka institucione/subjekte që nuk janë përgjegjës në Plan Veprimi, por rezultojnë përgjegjës në Pasaportën e indikatorëve.

### *3.3 Konkluzione dhe rekomandime*

Raporti i monitorimit *janar - dhjetor 2021*, në zbatim të Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, është dokument monitorues që hartohet në përputhje me këtë plan veprimi dhe me një metodologji të re hartimi. Ky dokument është në përputhje me strukturën e dokumenteve strategjikë sektoriale dhe ndërsektorialë për agjendën e mirëqeverisjes, dhe në kuadër të programimit IPSIS.
Raporti vjetor jep një informacion mbi zbatueshmërinë e qëllimeve të politikës/objektivave strategjikë, objektivave specifikë të strategjisë, të masave të parashikuara për arritjen e këtyre objektivave, të aktiviteteve konkrete të parashikuara. Raporti jep një informacion specifik mbi realizueshmërinë e masave prioritare të planit të veprimit, problematika të hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve si dhe identifikim të masave të nevojshme korrigjuese për periudhat në vijim.
Për këtë periudhë zbatimi të Planit të Veprimit, janë parashikuar në total **26** masa e **75** aktivitete.
Nga këto: **9** masa janë të zbatuara plotësisht; **10** masa janë ende në proces zbatimi, **3** masa janë të pa zbatuara, si dhe **4** masa të paraportuara nga institucionet përgjegjëse.
Nga këto: **39** aktivitete janë të zbatuara plotësisht; **4** aktivitete janë zbatuar pjesërisht/në proces zbatimi, **6** aktivitete janë të pazbatuara, si dhe **26** aktivitete janë të paraportuara nga institucionet përgjegjëse.

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet janë:

- të përmirësohet performanca e aktivitetit të institucioneve që raportojnë masa/aktivitete në proces zbatimi;
- të ulet numri i masave/aktiviteteve që rezultojnë të pazbatuara;
- të brendësohet metodologjia IPSIS e raportimit të zbatimit të masave dhe aktiviteteve për periudhën në zbatim.

## IV. RISQET/RISKU DHE HAPAT PËR TU ADRESUAR

### 4.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit

Në raportet e ardhshme të monitorimit, do të vijojë analiza e treguesve për çdo objektiv për të parë ecurinë e tyre dhe progresin e qëllimeve të politikës sipas të katër Objektivave Strategjikë të SELP.

1. Duhet kushtuar vëmendje realizimit të masave dhe aktiviteteve të lidhura me objektivat respektive specifikë dhe atyre startegjikë.
2. Kuvendi i Shqipërisë dhe Ministria e Drejtësisë, do t'i kushtojë një vëmendje të shtuar për të monitoruar dhe mbështetur kryerjen e aktiviteteve dhe realizimin e masave.
3. Tejkalimi i afateve të raportimit nga institucionet përgjegjëse është problematikë e cila ndikojnë drejtëpërsëdrejti në hartimin e Raporteve të Monitorimit.
4. Problematikë e rëndësishme është cilësia e kontributeve, ku shpesh janë ri-kthyer për t`u plotësuar sipas kërkesave dhe në përputhje me formatin e Planit të Veprimit.
5. Metodologjia e monitorimit sipas IPSIS, kërkon përmirësimin e kapaciteteve në institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin.
6. Gjatë fazës së monitorimit është vënë re një numër i madh pikash kontakti, të cilat kanë raportuar për aktivitete të veçanta të Planit të Veprimit, duke mos u koordinuar brenda institucionit raportues në mënyrë që të dërgohej pranë MD-së një raportim i plotë mbi të gjitha aktivitetet respektive të institucionit përgjegjës.

### *4.2 Hapat e radhës*

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *janar - dhjetor 2021*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, kërkohet që:

- Të vijojë zbatimi i masave në statusin "zbatuar pjesërisht/në proces" sipas afateve të parashikuara;
- Të nisë zbatimi në kohë i masave/aktiviteteve të parashikuara për periudhën në vijim;
- Të tregohet kujdes për organizimin e punës dhe proceseve përkatëse për ecurinë e masave e aktiviteteve;
- Të sigurohet operativiteti i burimeve dhe kapaciteteve njerëzore dhe ekspertizës së nevojshme për kryerjen e tyre;
- Të garantohen burimet financiare të munguara që ndikojnë në zbatueshmërinë e masave e aktiviteteve;
- Të sigurohet bashkëpunimi institucional i nevojshëm për masa e aktivitete të përbashkëta;
- Të garantohet koordinimi i mjaftueshëm për të shkëmbyer në mënyrë të efektshme informacionin dhe zgjidhur problemet penguese që mund të zgjidhen nga institucionet (përgjegjëse dhe bashkëpunëtore).

DRAFT

## V. Aneksi I: Raporti vjetor i monitorimit për Planin e Veprimit 2020-2023

| Kodi | Objektivat Strategjikë dhe Institucionet Përgjegjëse Respektive | Periudha e zbatimit të Planit të Veprimit | | | Kosto indikative PV | Buxheti i planifikuar për vitin raportues | | Buxheti i përdorur | Progresi deri më tani | | Problematikat | Hapa të tjera | Afati i përfundimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Fundi i vitit | Vlera e Targeti | /OOO total | Totali në % | /OOO total | Totali në % | Buxheti i përdorur deri më tani krahasuar me buxhetin indikativ ( në %) | Jep me % zbatimin për çdo Qëllim Politike dhe Objektiv Specifik | I zbatuar<br>Zbatuar pjesërisht/në proces<br>I pazbatuar | text | text | text |
| **1** | **Buxheti total për strategjinë** | | | **Totali 1+2+3** | **100** | | | | | | | | |
| | **I. QËLLIMI STRATEGJIK:** Investimi në kapitalin njerëzor dhe kohezionin social | | | | | **3,077,742,389.33 Lekë** | **30.4%** | **28.2%** | **43.4%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | |
| 1 | **Objektivi Strategjik 1: Përmirësimi i organizimit dhe funksionimit institucional në ofrimin e ELP-së** | | | Totali 1 | | **514,800 Lekë** | **33.3%** | **33.3%** | **40%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | |
| 1.1 | **Objektivi specifik 1.1: Përmirësimi i legjislacionit me qëllim parashikimin e parimeve e formave të ELP-së dhe** | | | | | **514,800 Lekë** | **100%** | **100%** | **70%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **përfshirjen e ELP-së në përgjegjësitë e institucioneve.** | | | | | | | | | | |
| 1.1.1 | **Raporti i vlerësimit të nevojave për përmirësime të kuadrit ligjor dhe institucional të ELP-së i hartuar** | | 515 | **514,800 Lekë** | **100%** | **100%** | **70%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | |
| 1.1.1.a | Ngritja e Grupit Institucional të Punës për kryerjen e studimit mbi nevojat për përmirësime të kuadrit ligjor dhe institucional (I) Hartimi i raportit paraprak mbi nevojat (II) Konsultimi i raportit paraprak me anëtarët e Rrjetit (III) Hartimi dhe publikimi i raportit përfundimtar mbi nevojat për përmirësime të kuadrit ligjor dhe institucional të ELP (IV) | | 515 | 514,800 lekë | 100% | 100% | **70%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT (MD)**<br>Bazuar në urdhërin e Ministrit të Drejtësisë, Nr. 315, datë 14.06.2021, "Për ngritjen e grupit të punës, për kryerjen e studimit mbi nevojat për përmirësim të kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e drejtësisë" në bashkëpunim dhe me asistencën e huaj (OSBE), sektori i Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë së bashku dhe me drejtoritë e tjera të përfshira në këtë proces filloj nga puna për hartimin e raportit.<br>Raporti është hartuar mbi bazën e analizës së kontributeve të dërguara nga anëtarët e grupit të punës të aparatit qendror, të cilat kanë në fokus kuadrin e përgjithshëm ligjor dhe institucional të Ministrisë së Drejtësisë, i cili shërben për të evidentuar nëse në të përcaktohen qartë e në mënyrë të plotë përgjegjësitë e institucionit për të ofruar edukimin ligjor të publikut në përputhje me parimet e ofrimit të tij, duke marrë parasysh edhe mënyrën e ofrimit të këtij edukimi ligjor. Raporti përfundimtar ka si qëllim të kryejë një vlerësim të legjislacionit dhe kuadrit institucional të edukimit ligjor të publikut si dhe si dhe nxjerrjen e rekomandimeve për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional në fushën edukimit ligjor të publikut.<br>**Aktualisht, raporti i vlerësimit paraprak të kuadrit ligjor dhe institucional të Ministrisë së Drejtësisë, në përmbushje të kompetencave të saj për një edukim ligjor më të mirë të publikut është i konluduar dhe është dërguar për miratim tek eprorët.** | | | **6M I 2021** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | **100%** | **I ZBATUAR (MTM)**<br>MTM me Urdher nr.19 datë 20.01.2021 ngriti grupin institucional te punes për përmirësime ligjore.<br>MTM ka legjislacion te dedikuar per edukimin dhe trajnimin si dhe terheqjen e publikut ne vendimmarrje, vecanwrish nw fushwn e mjedisit. Ndaj grupi i punes do jete permanent per te pasur ne vemendje vijimin e edukimit ligjor te\publikut ne aktet e reja. | | | |
| | Ministria e Drejtësisë/Ministritë (anëtarë të Rrjetit) | | | | | | | | | | |
| | 91401AA | | | | | | | | | | |
| 1.1.2 | **Akte ligjore dhe nënligjore të hartuara dhe të miratuara, në përputhje me rekomandimet e raportit përfundimtar të vlerësimit të ELP-së** | | **1,193** | **0** | **0%** | **0%** | **0%** | **I PAZBATUAR** | | | **2021-2023** |
| 1.1.2.a | Numri i akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara dhe të miratuara | | 1,193 (MD)<br>Ministritë e tjera kosto administrat ive | | | | **0%** | **I PAZBATUAR** | | | **6M II 2021** |
| | Ministria e Drejtësisë/Ministritë (anëtarë të Rrjetit) | | | | | | | | | | |
| | 91401AA (MD) 91101AD (MASR) | | | | | | | | | | |
| 1.1.2.b | Numri i akteve nënligjore për NJQV-të: (Rregullorja për konsultimin publik/ Rregullorja për të Drejtën e Peticionit, Ankesave dhe iniciativën | | 4,116 | | | | **0%** | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **6M II 2021** |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | qytetare/Rregullorja e Këshillit Bashkiak/Mbështetje për ndërgjegjësimin e bashkive në lidhje me detyrimet mbi ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" /Përmirësimi i akteve ligjore/nënligjore për Prefektin e qarkut<br>*Aktet që do të/mund të ndryshohen do të parashikohen saktësisht në varësi të kërkesave të institucioneve propozuese. | | | | | | | | | | |
| | Ministria e Brendshme/Shoqata e Bashkive | | | | | | | | | | |
| | 91602AC | | | | | | | | | | |
| 2 | **Objektivi Specifik 1.2: Rritja e vazhdueshme e burimeve financiare nga buxheti i shtetit dhe donatorët për ofrimin e ELP-së** | | | **0** | **0%** | **0%** | **0%** | **I PAZBATUAR** | | | |
| 1.2.1 | **Aktivitete ndërgjegjësuese dhe advokuese për rritjen e nivelit të financimit të aktiviteteve të parashikuara në PV të SELP nga donatorët, të realizuara** | | 515 | **0** | **0%** | **0%** | **0%** | **I PAZBATUAR** | | | **2021-2023** |
| 1.2.1.a | Krijimi i databazës së donatorëve që mbështesin aktivitete të ELP-së | | 515 | | | | **0%** | **I PAZBATUAR (MD)** | | | **6M II 2021** |
| | MD/Ministritë(anëtarëtëRrjetit) OSHC-të | | | | | | | | | | |
| | 91401AA MD | | | | | | | | | | |
| 1.2.1.b | Zhvillimi i një konference kombëtare për të rritur ndërgjegjësimin e përdorimit të ELP-së | | Kosto administ rative. | | | | **0%** | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **6M I 2021** |



DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kuvendi/Ministritë (AnëtarëtëRrjetit) OSHC | | | | | | | | | | |
| | 90202AA Kuvendi | | | | | | | | | | |
| 1.2.2 | **Përmirësimi i planifikimit buxhetor të institucioneve publike dhe përfshirja në prioritetet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) të ELP-së** | | **40,400** | **110,100** | **50%** | **0%** | **0%** | **I PAZBATUAR** | | | **2020-2023** |
| 1.2.2.a | Integrimi në prioritetet e AMSHC-së (thirrje për projekte) në fushën e edukimit ligjor të publikut | | 40,400 | 10,100 AMShC<br><br>100,000 ALL (Q.ALTRI) | 0%<br><br>100% | 0% | **0%**<br><br>**100%** | **I PAZBATUAR (AMShC)**<br>AMShC publikoi si prioritet të saj fokusin për SELP mirëpo, nga subjektet aplikant pretendentë për financim, nuk pati interesim apo projekte në fushën e SELP.<br>**I ZBATUAR (Q. ALTRI)**<br>Qendra ALTRI në kuadër të projektit Shërbime sociale të përmirësuara – komunitete të qendrueshme.<br>-Forume online mbi ofrimin e ndihmës juridike parësore;<br>-postera informues me informacion të përgjithshme për shërbimet që përfitojnë qytetarët;<br>-1video ndërgjegjësuese. | Për vitin raportues, aplikantet nga shoqëria civile, me gjithë ftesën e AMShC-së për këtë prioritet dhe ofrimin e asistencës financiare për këtë fushë strategjike, nuk shprehën interes duke rezultuar me zero përqind financimi I këtij prioriteti. Në mbi 70 projekte të shpallura fituese | AMShC garanton se publikimi I këtij prioriteti dhe fokusi rreth tij, do të jenë permanente në publikimet e Thirrjeve të saj duke nxitur dhe stimuluar ojf- të të aplikojnë në këtë prioritet. | **Në vazhdim** |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | nga mbi 160 aplikime, asnjë focus me SELP | | |
| | AMShC | | | | | | | | | | |
| | 98801 AA | | | | | | | | | | |
| 1.3 | **Objektivi Specifik 1.3: Sigurimi i burimeve njerëzore të nevojshme për të mundësuar ndërhyrjen me efektivitet në ofrimin e ELP-së** | | | **0** | **0%** | **0%** | **50%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | |
| 1.3.1 | **Identifikimi e vlerësimi i nevojave për burime njerëzore në nivel qendror dhe vendor** | | **317** | **Paraportuar** | **Paraportuar** | **Paraportuar** | **50%** | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **2020** |
| 1.3.1.a | Përcaktimi i një koordinatori që ofron edukimin/orientimin ligjor të publikut, në institucionet qendrore dhe vendore | | 317 | | | | **0%** | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **6M I 2021** |
| | Ministritë (anëtare tëRrjetit) /NJQV | | | | | | | | | | |
| | 91401AA | | | | | | | | | | |
| 1.3.1.b | ELP i të papunëve, kryesisht i grupeve në nevoje mbi legjislacionin në fushën e punësimit, migracionit për motive punësimi dhe arsimit e formimit profesional | | Kosto administrative. | | | | **100%** | **I ZBATUAR (MFE)** Portali AKPA www. puna.gov.al Brandimet, Infot. Punësimi i denjë, protokolli, udhezuesi. Politikat dhe legjislacioni për vullnetarizmin. Politikat dhe legjislacioni për programet e nxitjes së punësimit ne portalin e AKPA dhe ne broshura. Politikat dhe legjislacioni për Marrëdhëniet e Punës. Fushate ndergjegjesimi nepermjet broshurave dhe fletepalosjeve per | | | **6M I 2021** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | migracionin. Fushate ndergjegjesimi nepermjet broshurave dhe fletepalosjeve per migracionin e rregullt ne Gjermani. | | | |
| | MFE/ Institucionet e varësisë (Zyrat rajonale dhe vendore të punësimit) | | | | | | | | | | |
| | Kodi MFE 10 | | | | | | | | | | |
| | **QËLLIMI STRATEGJIK 2: Garantimi dhe forcimi i bashkëpunimit efektiv ndërinstitucional në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për realizimin e ELP-së** | | | **30,900 Lekë** | **40%** | **38.4%** | **74.9%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | |
| **2.1** | **Objektivi Specifik 2.1: Institucionalizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim koordinimin dhe bashkërendimin e iniciativave të ELP-së** | | | **30,900 Lekë** | **100%** | **20%** | **83.4%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | |
| 2.1.1 | **Krijimi i strukturës (Rrjeti) ndërinstitucionale përgjegjëse për edukimin ligjor të publikut dhe përcaktimi i kuadrit rregullator të veprimtarisë së tij** | | **Kosto administrative** | | | | **100%** | **Përfunduar 2020** | | | **Përfundua r 2020** |
| 2.1.1.a | Rregullore e Rrjetit e hartuar dhe e miratuar (I); publikim/njoftim i ngritjes së Rrjetit (II) faqja web e Rrjetit e ngritur dhe funksionale; nr. i publikimeve të kryera në web) | | **Kosto administrative** | | | | **100%** | **I ZBATUAR (Kuvendi)**<br>**Përfunduar 2020**<br>Në faqen zyrtare të Kuvendit, është bërë funksional linku i Strategjisë, në të cilin janë publikuar gjithë aktet e miratuara deri tani nga Kuvendi, Rrjeti dhe Komisioni Drejtues, konkretisht:<br>1.Vendimi i Kuvendit për miratimin e SELP | | | **Përfundua r 2020** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | 2.VKM nr.878, datë 11.11.202 “Miratimin e planit të veprimit 2020–2023, në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019–2023”<br>3.Rregullorja e Rrjetit<br><br>4.Vendimet e Komisionit Drejtues<br><br>5 Procesverbalet e mbledhjeve të Rrjetit dhe të Komisionit Drejtues. | | | |
| | Kuvendi | | | | | | | | | | |
| | 90202AA | | | | | | | | | | |
| 2.1.2 | **Transparencë e shtuar e veprimtarisë dhe aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të ELP-së** | | **Kosto administrative** | **30,900 Lekë** | **100%** | **20%** | **66.7%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | **2020-2023** |
| 2.1.2.a | Përditësimi i faqes *web* të krijuar (I) Hedhja e të dhënave mbi aktivitete që ndërmerren për ELP-në në fushën e legjislacionit sipas fushës së përgjegjësisë së çdo ministrie (anëtarë të Rrjetit) dhe të autoriteteve tjera publike | | Kosto administrative | | | Kosto administrative | **100%** | **I ZBATUAR (Kuvendi)**<br>Për vitin 2021 Kuvendi ka zhvilluar 1 takim të Rrjetit, 1 mbledhje të Komisionit Drejtues dhe një mbledhje të Bordit Këshillimor | Anëtarët e Rrjetit duhet të dërgojnë të dhëna mbi aktivitete që ndërmerren për ELP-në, sipas fushës së përgjegjësisë me qëllim pasqyrimin e tyre në faqen web të Strategjisë | | **Në vazhdim** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kuvendi/ Autoritete Publike (anëtare të Rrjetit) | | | | | | | | | | |
| | 90202AA (Kuvendi) | | | | | | | | | | |
| 2.1.2.b | Aktivitete ndërgjegjësuese e advokuese ndaj institucioneve përgjegjëse për ofrimin e ELP-së me qëllim edukimin ligjor për PAK | | Kosto administ rative | 3000$<br>30,900 ALL<br>Q.tlas | 100% | 20% | **0%**<br>**100%** | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR (MSHMS)**<br>**I ZBATUAR (Q. tlas)**<br>Me sherbimin social, NJMF, gjendjen civile ne 4 qarqe: Tirane, Diber, Lezhe dhe Korce. Vazhdon ne 4 qarqe te tjera: Fier, Elbasan, Durres dhe Shkoder. | | | |
| | MSHMS/ OSHC | | | | | | | | | | |
| | 96601AA (MSHMS) | | | | | | | | | | |
| 2.1.3 | **Krijimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i mekanizmave të bashkëpunimit dhe komunikimit të Rrjetit me publikun dhe median** | | **Kosto administra tive** | | | | **100%** | **I ZBATUAR** | | | **2020-2023** |
| 2.1.3.a | Caktimi i personit përgjegjës për komunikimin e Rrjetit me median dhe publikun (I) Komunikim\i dhe ndërveprimi midis institucioneve publike dhe qytetarëve dhe medias në kuadër të ELP-së, i përmirësuar dhe i lehtësuar (II) | | Kosto administ rative | | | Kosto administrative | **100%** | **I ZBATUAR (Kuvendi)**<br>Kuvendi ka caktuar një person përgjegjës, nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, për komunikimin e Rrjetit me median dhe publikun. | | | **Në vazhd im** |
| | Kuvendi | | | | | | | | | | |
| 2.2 | **Objektivi Specifik 2.2: Zhvillimi i mekanizmave të bashkëpunimit e komunikimit me publikun e median** | | | **0** | **0%** | **0%** | **50%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | |
| 2.2.1 | **Plani i Komunikimit të Rrjetit me publikun dhe median ("Plani i Komunikimit") i hartuar** | | **Kosto administra tive** | | | | **50%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | **2020-2023** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.2.1.a | Hartimi, konsultimi dhe miratimi i Planit të Komunikimit të Rrjetit (I) Plani i Komunikimit të Rrjetit i rishikuar (në vijimësi për çdo vit zbatimit të PV) | | **Kosto administrative** | | | Kosto administrative | **100%** | **I ZBATUAR (Kuvendi)** Për vitin 2021 Kuvendi ka zhvilluar 1 takim të Rrjetit, 1 mbledhje të Komisionit Drejtues dhe një mbledhje të Bordit Këshillimor | | | **Në vazhdim** |
| | Kuvendi/ Autoritete Publike (anëtare të Rrjetit) | | | | | | | | | | |
| | 90202AA | | | | | | | | | | |
| 2.2.1.b | Marrëveshje bashkëpunimi me NJQV-të për të vendosur standardin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit reciprok në planifikimin e aktiviteteve | | **Kosto administrative** | | | | **0%** | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **Në vazhdim** |
| | MB/AMVV (NJQV) | | | | | | | | | | |
| | 91602AC | | | | | | | | | | |
| 2.3 | **Objektivi Specifik 2.3: Konkretizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional nëpërmjet realizimit të iniciativave të përbashkëta të ELP-së** | | | **3,225, 180 Lekë** | **53.3%** | **45.3%** | **91.2%** | **I ZBATUAR** | | | |
| 2.3.1 | **Iniciativat e përbashkëta ndërinstitucionale të ELP-së të zhvilluara dhe përditësuara (të paktën 3 iniciativa/vit)** | | **7,055 Financ. Huaj** | **495,680 Lekë** | **85%** | **61%** | **73.6%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT /Në process** | | | **2020-2023** |
| | | | | | | | | Ndihmës Juridike në Durrës dhe organizatën jofitimprurëse të autorizuar “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare” dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Mars 2021;<br><br>7.Takimi i rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Shkodër me temë “Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve” me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në Shkodër; dorganizatën jofitimprurëse të autorizuar “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare” dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Mars 2021. -Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese/ edukimit ligjor të publikut<br><br>1.Realizuar intervista televizive nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastër në televizionin lokal Televizioni RTSH Gjirokastër, Janar 2021;<br><br>2.Bashkëpunimi me organizatën jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, QSHPLI MKEZH përmes zhvillimit të një aktiviteti ndërgjegjësues pranë Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër me përfaqësues nga grupe vulnerabël, persona të cilët i përkisnin kategorive të veçanta, përfaqësues nga Bashkia Gjirokastër dhe përfaqësues nga Shtëpia e të Moshuarve, Janar 2021;<br><br>3.Realizuar spoti informues në bashkëpunim me UNDP me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në të cilat jepet informacion mbi sistemin e ri të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, kushtet e përfitimit, ofruesit e shërbimit dhe informacione të tjera të nevojshme për informimin ligjor të publikut, Shkurt 2021;<br><br>4.Afishimi i posterave dhe shpërndarja e fletëpalosjeve/manualeve të dedikuara për qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore Gjirokastër, me qëllim informimin e qytetarëve dhe orientimin e | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | tyre për përfitimin e shërbimeve pranë kësaj qendre, Janar-Mars 2021;<br><br>5.Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Lezhës, Vlorës, Fierit dhe Dibrës, Mars 2021;<br><br>6.(Gjatë muajit mars 2021, ekipi i DNJF organizoi disa fushata ndërgjegjësimi gjatë të cilave u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike).<br><br>-Fushata ndërgjegjësimi në qytetet e Lushnjes, Tiranës, Durrësit, Fierit, Vlorës, Shkodrës, Lezhës, Dibrës, Pogradecit, Elbasanit.<br><br>Promovimi i shërbimit ligjor për qytetarët në qytete të ndryshme te vendit përmes fushatave të ndërgjegjësimit, shpërndarjes së fletëpalosjeve në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi shërbimin juridik falas.<br><br>-Aktivitet me fokus kategoritë Rome dhe Egjiptiane<br><br>Më datë 21 Maj, në Ditën Ndërkombëtare të Diversitetit Kulturor u zhvillua aktiviteti në të cilin morën pjesë aktorë të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti si dhe organizata të shoqërisë civile. Fokusi kryesor i këtij aktiviteti ishte diskutimi mbi respektimin e të drejtave të njeriut, promovimi i dialogut ndërkulturor, lufta kundër racizmit dhe veprimtaria në mbrojtje të pakicave kombëtare. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në cilësinë e institucionit publik që bën të mundur ofrimin dhe garantimin e shërbimeve ligjore falas kundrejt të gjithë qytetarëve në nevojë dhe kategorive të veçanta, i ka kushtuar një vëmendje të shtuar ofrimit të shërbimit ligjor falas për kategoritë më vulnerabël të shoqërisë siç janë komunitetet Rome dhe Egjiptiane.<br><br>-Marrëveshje Bashkëpunimi “Për sigurimin e aksesit në drejtësi përmes ndihmës juridike të garantuar nga shteti” me Shoqatën “Unë Gruaja”. | | | |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Më datë 02.06.2021 Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas zhvilloi një takim të përbashkët me Shoqatën “Unë Gruaja” me fokus kryesor vendosjen e urave të bashkëpunimit me këtë shoqatë e cila ka vite që operon në qytetin e Pogradecit dhe ka shërbyer si qendër këshillimi për gra dhe vajza të abuzuara. Ky takim u konkretizua dhe me nëshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi “Për sigurimin e aksesit në drejtësi përmes ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.<br><br>-Marrëveshje Bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër<br><br>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, më datë 27.05.2021, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër, dhe Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër zhvilloi një takim të përbashkët me fokus mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave me aftësi të kufizuar dhe viktimave të dhunës në familje, takim i cili u konkretizua dhe me nëshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi “Për sigurimin e aksesit në drejtësi përmes ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.<br><br>Gjatë këtij takimi, me pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm organizatash jofitimprurëse që oprerojnë në qarkun e Shkodrës (Shtëpinë e të Moshuarve, Shoqatën “Madonnina del Grappa”, Shoqatën “Projekti Shpresa”, organizatën jofitimprurëse “The Door Albania” dhe organizatën jofitimprurëse “Misionarët e Dashurisë, vëllezërit e Nënë Terezës”) , u bë i mundur shkëmbimi i kontakteve me qëllim referimin e rasteve që kanë nevojë për ndihmë juridike pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër.<br><br>**I ZBATUAR (RTSH)**<br><br>Në kanalin RTSH 1, në emisione të ndryshme si “Mirëmëngjes Shqipëri”, “Kohë moderne” “Target”, “Autor” etj, trajtohen edhe çeshtje me tematika të ndryshme ligjore me specialist të fushës. | | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | **95%** | Në emisionin "Auditor Arsim" trajtohen problematikat ligjore që lidhen me ligjin për arsimin me ekspert të fushës.<br><br>Në kanalin RTSH 2 realizohen dhe transmetohen emisione që prekin legjislacionin në fuqi si:<br><br>Emisioni i mëngjesit "**Ora 7**", trajtohen edhe çështje ligjore të ndryshme me ekspert të fushës të ftuar në studio.<br><br>"**Perspektivë**" (60 min), të rinjtë diskutojnë me ekspertë të fushave të caktuara mbi ndërtimin dhe funksionimin e institucioneve dhe praktikave në fushën e legjislacionit.<br><br>"**Ne"** (60 min) emision i cili i dedikohet çështjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me ekspert të fushës të ftuar në studio.<br><br>3."**Individi dhe shoqëria**" (60 min) Emision i cili i dedikohet edhe përmbushjes se objektivave sociale të Kushtetutës.<br><br>4."**Fletore Zyrtare**" (60 min) Emision i dedikuar njohjes së publikut me legjislacionin, aktet nënligjore dhe proçeduarat teknike për të drejtat e tyre në fushën e sigurimit social (marrëdhëniet e punës, sigurimi shoqëror, shëndetësor, social shtetëror).<br><br>Në Radio Tirana realizohen dhe transmetohen këto programe:<br><br>**"Këshillime juridike"** në Radio Tirana 1- emision i përjavshëm, çdo të hënë ora 10.05, ofron këshillimin e ekspertit për shqetësimet e qytetarëve.<br>**"Fletorja zyrtare në Radio Tirana"** Talk show- çdo të enjte, ora 12.05. Një studio e hapur për telefonuesit që me ekspertin e sigurimeve shoqërore në studio i jepen përgjigje pikëpyetjeve rreth problematikave duke orientuar dëgjuesit për përdorimin e Sistemit Digjital të qasjes së qytetarit drejt Administratës Publike.<br>**"Unë dhe e drejta ligjore"** nga e hëna-të premte, ora 17.30, sjell në studio përballë qytetarit ekspertin ligjor që trajton jo | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | vetëm problematikat rreth çështjeve të pronësisë, por edhe të çdo fushe tjetër ligjore.<br>**“Të rinjtë dhe e drejta ligjore”** trajtohen çështje mbi këshillimin dhe informimin, mbrojtje nga diskriminimi për shkak të ngjyrës, moshës, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, statusit social – ekonomik, mbrojtje dhe këshillim ligjor falas. | | | |
| | DNJF/RTSH/OSHC | | | | | | | | | | |
| | kodi i produktit DNJF 91406AA;18AR501 | | | | | | | | | | |
| 4.2 | **Objektivi specifik 4.2: Informimi dhe ndërgjegjësimi i gjerë i publikut nëpërmjet fushatave mediatike në një fushë ligjore të caktuar apo në trajtimin ligjor të një fenomeni specifik** | | | **641,033 Lekë** | **50%** | **50%** | **38.9%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | |
| 4.2.1 | **Mekanizma dhe instrumente të lidhura me informimin dhe ndërgjegjësimin publik, të përmirësuara** | | **1,745,804**<br>**1,378,637 B.Sht.**<br>**367,167**<br>**F. Huaj** | **641,033 Lekë** | **50%** | **50%** | **38.9%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | **2020-2023** |
| 4.2.1.a | Informim i anëtarëve të Kuvendit dhe publikut për çështjet parlamentare (seminare ndërgjegjësuese për deputetët/ seminare mbi procesin legjislativ)<br>*Aktiviteti fillon në 6M II 2020 dhe zbatohet përgjatë të dy 6M në vitet e tjerë të PV | | Kosto administrat ive | | | Kosto administrative | **100%** | **I ZBATUAR (Kuvendi)**<br>Në fillim të Legjislaturës së re, janë zhvilluar sesione trajnimi lidhur me informimin e tyre për procesin legjislativ. | | | **Në vazhd im** |
| | Kuvendi/OSHC | | | | | | | | | | |
| | 90202AA | | | | | | | | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.2.1.b | Nxitja e qytetarëve për të qenë pjesëmarrës aktiv në proceset legjislative si Parlament, Qeveri dhe në Njësitë e Qeverisjes vendore Lobimi dhe përfaqësimi i interesave të qytetarëve dhe kategorive në nevojë në çdo iniciativë ligjore në të gjitha nivelet (thirrje për komente/mendime dhe opinione) | | Kosto administrat ive | | | Kosto administrative | **100%** | **I ZBATUAR (Kuvendi)**<br>Në faqen zyrtare të Kuvendit është aktivizuar platforma "*Konsultimi i Projektligjeve*" që ofron mundësinë e konsultimit online të projektligjeve.Komisionet parlamentare gjatë shqyrtimit të projektligjeve ftojnë grupet e interesit për të sjellë opinionet dhe rekomadimet e tyre. | | | **Në vazhd im** |
| | Kuvendi/ Ministritë (anëtare të Rrjetit) | | | | | | | | | | |
| | 90202AA-Kuvendi , 91401AA-MD | | | | | | | | | | |
| 4.2.1.c | Fushata ndërgjegjësuese dhe informuese për ligjin nr.111/2017; broshura dhe fletëpalosje specifike në qytete Tiranë,Durrës,Elbasan,etj) .*Aktivitete që kryhen në vijimësi gjatë viteve të zbatimit të PV | | 857 | 857 | 100% | 100% | **83%** | **I ZBATUAR (DNJF)**<br>DNJF është një nga institucionet e parashikuara si përgjegjës për zbatimin e kësaj mase. Duke marrë në konsideratë faktin se kemi bashkëpunim me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë në të cilat janë të angazhuar studentë (Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve, ligji nr.111/2017, i parashikon si ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore), në këtë kuadër, janë zhvilluar disa aktivitete qe synojnë ofrimin e shërbimit ligjor ndaj qytetarëve duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në edukimin ligjor të tyre. Theksojmë së një formë e ofrimit të shërbimit parësor të ndihmës juridike është: "dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor".<br>Në këtë mënyrë, duke ofruar shërbim ligjor falas është ofruar njëkohësisht edhe edukim ligjor / ndërgjegjësim për të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve kundrejt sistemit ligjor të Republikës së Shqipërisë.<br>Disa nga aktivitetet e zhvilluara në bashkëpunim me Klinikat e Ligjit janë: | | | **Në vazhd im** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | -Aktiviteti “Garantimi i ndihmës juridike parësore nëpërmjet ofrimit të këtij shërbimi nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve”, me pjesëmarrjen e Ministrit të Drejtësisë; studentëve dhe përfaqësuesve të Klinikave të Ligjit. (Janar 2021)<br><br>Më datë 26.01.2021, u zhvillua takimi i përbashkët me të gjithë përfaqësuesit e Klinikave të Ligjit dhe studentët e angazhuar pranë këtyre Klinikave.<br><br>Ky takim u hap me fjalën e Ministrit të Drejtësisë e cila u shpreh mbi rëndësinë e Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve si ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore, të cilat shërbejnë për informimin e qytetarëve për legjislacionin shqiptar, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar, por edhe çështje të cilat lidhen me ndërmjetësimin, këshillimin, përpilimin e akteve, përfaqësimin pranë organeve të administratës shtetërore si dhe shërbime të tjera. Takimi vijoi me ndërveprimin ndëraktiv të përfaqësuesve të Klinikave të Ligjit si dhe studentët të cilët shfaqën një interes të lartë sa i përket zhvillimit të trajnimeve dhe angazhimit në praktikat e punës me qëllim përfitimin e njohurive më praktike mbi sistemin e ndihmës juridike parësore.<br><br>-Vizitë pranë Klinikës së Ligjit në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës me pjesëmarrjen e Zv. Ministrit të Drejtësisë, Z. Karameta. (Shkurt 2021)<br><br>Zv. Ministri i Drejtësisë Z. Klajd Karameta dhe ekipi i Drejtorisë së Përgjithshme të Ndihmës Juridike inspektuan Klinikën e Ligjit pranë këtij Universiteti për të parë nga afër veprimtarinë këtij institucioni që është krijuar si risi. Në këtë vizitë, u zhvillua dhe një takim edhe me Dekanin e këtij Universiteti, takim në të cilin u prezantuan arritjet e deritanishme të kësaj Klinike si dhe bashkëpunimin më tej me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.<br><br>-Trajnim i studentëve të angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve (Shkurt 2021) | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas zhvilloi trajnimin me temë “Aksesi në drejtësi dhe risitë e ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, mbajtur me studentët e angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve me të cilat Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur marrevëshje bashkëpunimi.<br><br>Në këtë takim online u trajtuan temat: “Instrumentët ndërkombëtarë që garantojnë aksesin në drejtësi të qytetarëve ndërmjet ofrimit të ndihmës juridike falas; Sistemi i ndihmës juridike parësore; Sistemi i ndihmës juridike dytësore; Arritjet e sistemit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe sfidat për të ardhmes si dhe parashtrimi i rasteve praktike nga punonjësit i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë”.<br><br>Në fund të këtij aktiviteti sudentët u pajisën me një vërtetim pjesëmarrjeje si dhe ju bë me dije mundësia për aplikim në kuadër të praktikave 3 mujore të punës (Prill-Qershor 2021) pranë DNJF si dhe qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore.<br><br>-Hapja e thirrjes për zhvillimin e praktikave të punës pranë DNJF dhe qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (Mars 2021)<br><br>Ne permbushje te detyrave funksionale te percaktuara ne ligjin nr. 111/2017, dhe konkretisht ne nenin 16 ku percaktohet se: “Drejtoria e Ndihmes Juriidke Falas, bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore” nga ana e DNJF jane ndërmarrë masat për angazhimin e studenteve në praktika pune pranë Drejtorisë sonë si dhe Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, për një periudhë 3 mujore (Prill-Qershor | | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | 2021).Nga aplikimet kanë shfaqur interesin mbi 30 studentë nga qytete të ndryshme të RSH. | | | |
| | DNJF/OSHC | | | | | | | | | | |
| | Kodi i produktit DNJF 91406AA;18AR501 | | | | | | | | | | |
| 4.2.1.ç | Forume të hapura me pjesëmarrje të gjerë qytetare me qëllim marrjen e njohurive ligjore mbi ligjin nr.111/2017, sistemin e ndihmës juridike falas, kushtet/kriteret e përfitimit/subjektet përfitues/shërbimet që ofrohen etj. *Aktivitete që kryhen në vijimësi gjatë viteve të zbatimit të PV". | | 178 | 176 | 100% | 100% | **100%** | **I ZBATUAR (DNJF)**<br>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka zhvilluar rreth 125 takime dhe fushata ndërgjegjësuese duke informuar qytetarët dhe shpërndarë fletëpalosje dhe postera për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. | | | **Në vazhd im** |
| | DNJF/OSHC | | | | | | | | | | |
| | 91406AA | | | | | | | | | | |
| 4.2.1.d | Fushata ndërgjegjësuese me institucionet publike/ pushtetin vendor/ dhe komunitetin për pasojat ligjore që kanë personat apo grupe personash që merren me kultivimin e bimëve narkotike, (programi: fushatë ndërgjegjësuese për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike - Kanabissativa) | | 243,942<br>F. Huaj | | | | | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **Në vazhd im** |
| | MB/ DPPSH | | | | | | | | | | |
| 4.2.1.d h | Fushata ndërgjegjësuese me institucionet publike/ pushtetin vendor/ dhe komunitetin për pasojat ligjore që kanë personat apo grupe personash që merren me kultivimin e bimëve narkotike, (programi: Zbatimi i Programit ndërgjegjësues në shkolla, "Jo alkoolit, duhani, marijuanës") | | Kosto administrat ive | | | | | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **Në vazhd im** |
| | MB/ DPPSH | | | | | | | | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.2.1.e | Fushata ndërgjegjësimi, për të informuar shtetasit shqiptarë për rregullat dhe kushtet e udhëtimit pa vizë në BE, mundësitë e migracionit të rregullt dhe pasojat e migracionit të parregullt (si edhe aplikimeve të pabazuara për azil) | | 24,000 | Paraport uar | Paraport uar | Paraportuar | **100%** | **I ZBATUAR (MEPJ)**<br>MEPJ dhe Përfaqësitë pasqyrojnë në faqet zyrtare informacion lidhur me kushtet dhe rregullat e udhëtimit pa vizë në BE pë shtetasit shqiptarë. Ky informacion është I aksesueshëm nga të gjithë shtetasit shqiptarë të interesuar. Njëkohësisht përveç informacionit në web zyrtar, shtetasit e interesuar mund të përcjellin kërkesat për informacion dhe asistohen nga stafi konsullor. | | | **Në vazhd im** |
| | MB/ DKM; SHKP; MEPJ; MFE; MSHD | | | | | | | | | | |
| | 91601AB (Akte ligjore, Auditime të kryera) | | | | | | | | | | |
| 4.2.1.ë | Fushatë ndërgjegjësuese dhe informuese e komunitetit, të rinjve, nxënësve e mësuesve në shkolla (përfshirë Muajin Antitrafik) lidhur me: legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, kuadrin institucional antitrafikim, format, metodat dhe fenomenin e trafikimit të personave dhe njohja me të drejtat e viktimës | | 3, 225<br>F. Huaj | | | | | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **Përfu ndua r 2020** |
| | MB/ MSHMS, KKSAT | | | | | | | | | | |
| | 91601AB (Akte ligjore, Auditime të kryera) | | | | | | | | | | |
| 4.2.1.f | Fushata ndërgjegjësuese kombëtare: 12 Prill (dita e FSRR), 12 Qershor (dita kundër punës së fëmijëve) 20 nëntor (dita e të drejtave të fëmijëve) (I) Publikim i shtuar i ngjarjeve informuese me fokus të drejtat dhe mekanizmat institucionalë të mbrojtjes për fëmijët/të miturit (II) | | 50,000<br>F. Huaj | | | | | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **Në vazhd im** |
| | MB/ DPPSH | | | | | | | | | | |
| | 91604AR (Raporte financiare për menaxhimin e burimeve financiare dhe njerëzore) | | | | | | | | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.2.1.g | Transparencë e shtuar/materiale informuese dhe ndërgjegjësuese me fokus të drejtat dhe mekanizmat e mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje/ takime informuese me grupe të caktuara (vulnerabël) me fokus prezantimin e mekanizmave dhe garancive ligjore që ata gëzojnë në kuadër të mbrojtjes nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore | | 70,000<br>F. Huaj | | | | | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **Në vazhdim** |
| | MB/ DPPSH | | | | | | | | | | |
| | 91604AR (Raporte financiare për menaxhimin e burimeve financiare dhe njerëzore) | | | | | | | | | | |
| 4.2.1.gj | Garantimi i të drejtës për informim mbi fazat e procesit të përzgjedhjes dhe të drejtat e migrantëve, me anë të materialeve të printuara, aplikacioneve në internet dhe shërbimeve të përkthimit, sipas nevojës, në kufi dhe në territor | | 800,000 | | | | | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **Në vazhdim** |
| | MB | | | | | | | | | | |
| | 91604AK (Persona të procesuar në PKK, Kategoria I,II dhe III ajror, tokësor, detar) | | | | | | | | | | |
| 4.2.1.h | Informacion i shtuar në pikat e kalimit kufitar për shkaqet e përfundimit të statusit ligjor, masat kundër qëndrimit të paautorizuar dhe të drejtat procedurale të subjekteve të hetimit | | 552,000 | | | | | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **Në vazhdim** |
| | MB/ DPPSH | | | | | | | | | | |
| | 91604AK (Persona të procesuar në PKK, Kategoria I,II dhe III ajror, tokësor, detar) | | | | | | | | | | |
| 4.2.1.i | Informimi i komunitetit, të rinjve, të miturve (kryesisht nxënës të shkollave të mesme) mbi përgjegjësinë penale, për veprat penale (krime/kundërvajtje) kundër jetës, shëndetit dhe integritetit të personit (*gender*). | | Kosto administrative | | | | | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **Në vazhdim** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | MB/ DPPSH | | | | | | | | | | |
| | 91604AR (Raporte financiare për menaxhimin e burimeve financiare dhe njerëzore) | | | | | | | | | | |
| 4.2.1.j | Dizenjimi i një fushate sensibilizimi për njohjen e publikut të gjerë me kuadrin ligjor për transmetimet TV (Kodi i transmetimit dhe përmbajtjes audiovizive); Aktivitete për njohjen e publikut me pjesë të veçanta të ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar/ Kodi i Transmetimit | | 682 | | | | | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **Në vazhdim** |
| | AMA | | | | | | | | | | |
| | Zëri i shpenzimeve - 6029 | | | | | | | | | | |
| 4.2.1.k | Zhvillimi i trajnimeve me autoritetet publike dhe/ose kontrollues/përpunues në kuadër të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale | | 1, 920 | 640.000 | 100% | 68% | **100%** | **I ZBATUAR**<br><br>Zyra e Komisionerit në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën einformimit", me Urdhrat nr. 187 dhe nr. 188, datë 18.12.2020, miratoi modelet e reja të Programit të Transparencës dhe Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Mbi zbatueshmërinë e këtyre urdhrave, Zyra e Komisionerit gjatë muajit Prill 2021, ka organizuar takime me koordinatorë për të drejtën e informimit të institucioneve qendrore e të varësisë dhe atyre të pavarura, për t'i asistuar për publikimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve sipas formës dhe përmbajtjes së modeleve të rishikuara.<br><br>Gjithashtu, në gjysmën e dytë të 2021, Zyra e Komisionerit ka vijuar me zhvillimin e takimeve ndërgjegjësuese me kryetarë të bashkive, sekretarët e përgjithshëm të ministrive, si edhe me institucione të tjera lidhur me vënien në zbatim të Programit të Transparencës së Rishikuar, si dhe regjistrit të kërkesave dhepërgjigjeve të rishikuar, sipas modelit të miratuar nga Zyra e Komisionerit. | | Vijimi i zhvillimit të trajnimeve me autoritetet publike dhe/ose kontrollues/ në kuadër të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen | **Përfundua r 2020** |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Gjatë periudhës Janar – Qershor 2021, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) zhvilluan një cikël prej 9 trajnimesh online me temë “Balanca midis të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtës për informim”. Pjesë e takimeve ishin më shumë se 180 nëpunës civilë të kategorive të ndryshme, me fokus pjesëmarrjen e koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe personat e ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave personale nga Autoritete Publike qendrore e të varësisë, atyre të pavarura dhe njësive të vetëqeverisjes vendore. Organizimi i ciklit të trajnimeve u inicua duke marrë shkas nga raste praktike dhe vështirësitë që shfaqnin institucionet publike në trajtimin në balancë këtyre dy të drejtave kushtetuese. Në to u referuan parashikimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe atij për të drejtën e informimit, si mund të bëhet balanca në rastin e trajtimit të kërkesave për informacion nga Autoritetet Publike. Po ashtu, u diskutua si bëhet dallimi mes informacionit publik që duhet të vendoset në dispozicion dhe cilat janë të dhënat personale, publikimi i të cilave do të cenonte jetën private të individëve. Trajnimet orientuan përfaqësuesit e Autoriteteve Publike mbi mënyrën e administrimit të të dhënave personale të funksionarëve publike dhe për kategoritë e tyre që mund të publikohen apo transparencën për procedurat e partneritetit publik privat. Në këto trajtime u sollën shembuj nga vendimmarrja e autoritetit dhe ajo ndërkombëtare në këtë drejtim. Zyra e Komisionerit gjatë periudhës prill – maj 2021, në bashkëpunim me Qendrën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) organizuan 2 trajnime me tematikë “E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale në raport me çështjet e P/CVE – standardi bazë ligjor dhe rastet e kufizimeve të tyre”. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm stafi i Qendrës dhe pjesëtarë të rrjetit të bashkëpunëtorëve të saj nga ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes | | | |

DRAFT

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Sociale dhe ajo e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucione zbatuese të Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Në takim u trajtua ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ai nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, roli dhe funksionet monitoruese e mbikëqyrëse të Zyrës së Komisionerit, balanca mes këtyre dy të drejtave apo kur ato kufizohen në raport me objektin e veprimtarisë së CVE, si dhe për raste praktike nga të dy këto fusha. Njohja me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut janë në fokus edhe të trajnimeve të ardhshme të Zyrës së Komisionerit dhe CVE për rrjetin e bashkëpunëtorëve të saj. Në Maj të vitit 2021, Zyra e Komisionerit, ishte pjesë e trajnimit për Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH). Aktiviteti u organizua nga Zyra në Shqipëri e Programit të Asistencës Ndërkombëtare për Trajnimin në Hetimin Penal (International Criminal Investigative Training Assistance Program – ICITAP), në bashkëpunim dhe koordinim me Prezencën e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Pjesëmarrësit u njohën me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale në vendin tonë. Gjithashtu u diskutua edhe për funksionet dhe rolin monitorues e mbikëqyrës të Zyrës së Komisionerit, si dhe për raste nga praktika ku ndërthuret kuadri rregullator i kësaj fushe me atë që normon objektin e veprimtarisë së BKH. Njëkohësisht, të pranishmit u trajnuan edhe për çështje që kanë të bëjnë me korrupsionin, integrimin gjinor dhe me përvojën e punës së prokurorive speciale publike nga rajoni i Ballkanit Perëndimor. Me rastin e 28 Shtatorit, Ditës së të Drejtës për Informim, Zyra e Komisionerit zhvilloi një aktivitet online hibrid me përfaqësues të sektorit të shëndetësisë, institucione të cilat kanë përballuar peshën kryesore në këtë periudhë të pazakontë, me të cilat është bashkëpunuar ngushtësisht për të garantuar transparencën e veprimtarisë së tyre dhe zbatimin e të drejtës për informim. Në këtë takim u trajtuan | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | zbatimi i legjislacionit për të drejtën e informimit gjatë periudhës së pandemisë nga Autoritetet Publike në sektorin e shëndetësisë. Rëndësi ju kushtua transparencës proaktive nga këto autoritete nëpërmjet Programeve të Transparencës si instrumenti më i rëndësishëm për transmetimin e informacionit në publik në grupet e interesit, si edhe trajtimi i kërkesave për informacion në afat dhe në përmbajtje, si dhe fuqizimi i rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit. Në takim morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Shëndetit Publik, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore dhe përfaqësues e koordinatorë të së drejtës për informim nga institucione të këtij sistemi nga i gjithë vendi.<br><br>Referuar nenit 14/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Zyra e Komisionerit kandërmarrë iniciativën dhe ka vijuar bashkëpunimin me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për të mundësuar krijimin dhe vënien në funksion të sistemit lidhur me aplikimin e kërkesave për informacion dhe ankesave nëpërmjet portalit e-Albania. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me AKSHI-n kanë zhvilluar disa trajnime me institucione qendrore dhe ato të vetëqeverisjes vendore për njohjen e koordinatorëve, si persona kontakti për të drejtën e informimit, me modalitetet e përdorimit të sistemit të ri AMS, i cili do t’u garantojë qytetarëve një mjet alternativ për të ushtruar të drejtën e tyre për akses në informacion. Aktualisht janë krijuar 40 llogari përdoruesish të cilat janë aktive. Është parashikuar që ky sistem të jetë funksional për 100 autoritete publike deri në fund të 2021, ndërsa funksionimi i tij do të vijojë të shtrihet në më shumë institucione publike gjatë 2022.<br><br>Zyra e Komisionerit në zbatim të komponentit 3 të Projektit të Binjakëzimit | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me acquis e BE” ka zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:<br><br>-webinar-i I dhe II u zhvillua në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare tëAdministratës Publike (ASPA) me mbi 60 përfaqësues të institucioneve qendrore dhe të pavarura;<br><br>-webinar-i III u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesëve të organizatave të ndryshme të shoqërisë civile (OJF) dhe subjekteve mediatike;<br><br>-webinar-i IV u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësues përfaqësuesve të institucioneve publike dhe subjektet private që e ushtrojnë veprimtarinë në sektorin shëndetësor;<br><br>-webinar-i V u zhvillua me përfaqësues nga Prokuroria, Policia e Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;<br><br>-webinar-i VI u zhvillua me përfaqësues të institucioneve publike dhe subjekteve private që e ushtrojnë aktivitetin në sektorin bankar/financiar dhe të telekomunikacionit;<br><br>-webinar-i VII u zhvillua me përfaqësues të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), publike edhe private;<br><br>-webinar-i VIII u zhvillua në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës me pjesmarrjen e përfaqësuesve dhe institucioneve të sistemit të drejtësisë;<br><br>-wbinar-i IX u zhvillua me ushtrues të profesioneve të lira (avokatë, ndërmjetës, noterë);<br><br>-webinar-i X kishte temë “Sigurinë e të dhënave personale dhe cenimin e tyre në sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit(TIK)”, u zhvillua me përfaqësues nga institucione të pavarura/shtetërore që ofrojnë shërbime nëpërmjet sistemeve TIK dhe nga parti politike që përpunojnë të dhëna personale në kuadër të veprimtarisë së tyre. | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | -webinar-i XI u zhvillua me grupe nxënës të shkollave 9-vjeçare të Tiranës “Servete Maçi” dhe “Kosova” për njohjen me parimet/konceptet dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e të dhënave personale të kësaj grup-moshe në mjedisin digjital.<br>Në të gjitha këto aktivitete, morën pjesë më shumë se 550 persona. Qëllimi i tyre ishte njohja me kuadrin e ri rregullator të fushës të paafruar me GDPR dhe Direktivën e Policisë (disseminations events). Lektorë në këto trajnime ishin ekspertë nga partnerët ndërkombëtarë që mbështesin zbatimin e Projektit të Binjakëzimit, nga Autoriteti Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Garante per Protezione dei Dati Personali), CSI-Piemonte, Itali, instituti austriak “Për të drejtat e njeriut Ludwig Boltzmann” (BIM) dhe nga Zyra e Komisionerit. | | | |
| | KDIMDP/ MASR; IAL | | | | | | | | | | |
| | 98901AA | | | | | | | | | | |
| 4.3 | **Objektivi specifik 4.3: Rritja e kapaciteteve të individëve në ushtrimin e të drejtave të tyre, në aftësinë për të kuptuar dhe marrë vendimet e duhura** | | | **0** | **0%** | **0%** | **0%** | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | |
| 4.3.1 | **Raport vlerësimi mbi nevojat e qytetarëve për modele të gatshme vetëpërfaqësimi** | | **1,069** | **0** | **0%** | **0%** | **0%** | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **2020-2023** |
| 4.3.1.a | Raport vlerësimi mbi situatën aktuale dhe statistikat mbi vetëpërfaqësimin ligjor dhe modelet aktuale që përdoren, i hartuar | | 1,069 | 0 | 0% | 0% | 0% | **I PAZBATUAR (MD)** | | | **6M II 2021** |
| | MD/ Ministritë (anëtarë të Rrjetit); OSHC | | | | | | | | | | |
| | 91401AA | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.3.2 | **Modelet e gatshme për vetëpërfaqësim në institucione të hartuara dhe publikuara** | | **600** | **0** | **0%** | **0%** | **0%** | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **2020-2023** |
| 4.3.2.a | Hartimi dhe përditësimi i modeleve të vetëpërfaqësimit për qytetarët nga institucionet përkatëse, (përgjatë viteve 2021/2022/2023) | | 600 | | | | | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **6M II 2021** |
| | Ministritë (anëtarë të Rrjetit)/ OSHC | | | | | | | | | | |
| | 91401AA | | | | | | | | | | |
| 4.4 | **Objektivi specifik 4.4: Garantimi i informacionit ligjor në kohë reale dhe sa më pranë komunitetit** | | | | | | | | | | |
| 4.4.1 | **Krijimi i kanaleve të komunikimit dhe informimit ligjor të qytetarëve për ELP-të** | | **21,268**<br>**10,068 B.Sht.**<br>**11,200 Hendek** | | | | | | | | **2020-2023** |
| 4.4.1.a | Linjat telefonike "*help linë*" që ofrojnë informacione rreth aspekteve të ligjit të krijuara në 12 NJQV (I) Hartimi dhe miratimi i rregullores tip për funksionimin e linjave telefonike "*help linë*" (II) Përcaktimi dhe/ose përfshirja në strukturën e bashkive të punonjësve që do të ofrojnë shërbimet "*help linë*" (III | | 11,200<br>Hendek | | | | | **FILLON NË VITIN 2022** | | | |
| | NJQV<br>(Berat Dibër Durrës Elbasan Fier Gjirokastër Tiranë Korçë Kukës Lezhë Shkodër Vlorë)/ OSHC | | | | | | | | | | |
| | 91602AC (Aktivitet për bashkërendim procesesh mes bashkive) | | | | | | | | | | |
| 4.4.1.b | Ngritja dhe funksionimi i linjave "*help linë*": linja e këshillimit për gra dhe vajza 116 117, linja | | 10, 068 | | | | | **PËRFUNDUAR 2020** | | | **Përfundua** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | e këshillimit për fëmijët ALO 116 111, si dhe strehëza LGBTI | | | | | | | | | | **r 2020** |
| | MSHMS/ OSHC | | | | | | | | | | |
| | 91307 AH | | | | | | | | | | |
| 4.4.1.c | Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të institucioneve të linjës për edukimin ligjor të aksesueshëm për të gjitha kategoritë PAK | | Kosto administrat ive | | | | | **PËRFUNDUAR 2020** | | | **Përfu ndua r 2020** |
| | MSHMS/ OSHC | | | | | | | | | | |
| | 96601AA | | | | | | | | | | |
| 4.5 | **Objektivi specifik 4.5: Nxitja e aktivizimit të publikut përmes informimit mbi përgjegjësitë e institucioneve dhe mënyrat e pjesëmarrjes në vendimmarrje** | | | **1,238, 461 Lekë** | **55%** | **54.3%** | **54.3%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | |
| 4.5.1 | **Ditët e Hapura pranë Bashkive/forume me qytetarë** | | **26,962**<br>**20,125 B.Sht.**<br>**2,896 Hendek** | **1,238, 461 Lekë** | **55%** | **54.3%** | **54.3%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | **2020-2023** |
| 4.5.1.a | Hartimi i kalendarit të ditëve të hapura për çdo Bashki dhe Njësi Administrative (I) Përgatitja e materialeve të nevojshme për Ditën e Hapur (II) Zhvillimi i Ditëve të Hapura (disa ditë të hapura/vit) - (III) | | 959 | 361 | 37.65 % | 71.35% | 71.35% | **I ZBATUAR (AP)**<br>Në kuadër të aktivitetit të "Ditë të hapura" insitucioni i Avokati i Popullit ka kryer aktivitetet sa më poshtë:<br>Veprimtari "Ditë të hapur", në datë 18.5.2021, në mjediset e institucionit të Avokatit të Popullit, me përfaqësues, fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjiptian, me karakter informues dhe ndërgjegjësues që synoi, që të drejtat e fëmijëve të respektohen dhe të trajtohen me të gjithë kujdesin e duhur dhe të nevojshëm për moshën e tyre, në interesin më të lartë për ta. | | | **Në vazhd im** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Takime informuese/ ndërgjegjësuese në datë 6.5.2021 i organizuar nga Seksioni i Administratës pranë Bashkisë Durrës.<br>Takime informuese/ ndërgjegjësuese në datat 19, 23, 24 Mars 2021 i organizuar nga Seksioni i Administratës pranë Bashkisë Vlorë dhe Orikum.<br>Në kuadër të marrëveshjes, ndërmjet institucionit të Avokatit të Popullit dhe zyrës së UNICEF Shqipëri, për monitorimin e veprimtarisë administrative të institucioneve përgjegjëse shtetërore, pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në zbatim të ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, SMPDF ka realizuar takimet si vijon:<br><br>Vizitë/takim, në datë 15.1.2021, në Bashkinë Durrës;<br>Vizitë/takim, në datë 11.3.2021 në Bashkinë Sarandë;<br>Vizitë/takim, në datë 24.3.2021, në Bashkinë Përmet;<br>Vizitë/takim në datë 29.3.2021, në Bashkinë Lezhë;<br>Dy vizita/takime në datë 4.5.2021, në Bashkinë Cërrik dhe Bashkinë Gramsh;<br>Vizitë/takim në datë 6.5.2021, në Bashkinë Librazhd;<br>Workshop, datë 6.5.2021, me përfaqësues të autoriteteve publike në nivelin vendor, përgjegjëse për mbrojtjen sociale të fëmijëve në Bashkinë e Prrenjasit;<br>Vizitë/takim në datë 21.5.2021, në Bashkinë Pogradec.<br>Vizitë/takim në datë 1.6.2021, në Bashkinë Gjirokastër me kryetarin e bashkisë z. Flamur Golemi.<br>Vizitë/takim në datë 1.6.2021, në Bashkinë Dropull me kryetarin e bashkisë z. Dhimitraq Toli.<br>Vizitë/takim në datë 11.11.2021, në Bashkinë Elbasan me kryetarin e bashkisë z. Gledian Llatja.<br>Seksioni i Përgjithshëm ka vijuar punën për edukimin e publikut lidhur me barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje si dhe të drejtat e komunitetit LGBTI, PAK, Romët, Egjiptianët dhe të moshuarit, përmes publikimit në faqen zyrtare të institucionit | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | të Avokatit te Popullit, apo nëpërmjet mediave sociale (facebook), të deklaratave dhe qëndrimeve të institucionit për respektimin e të drejtave të grupeve të ndryshme, kundër përdorimit të gjuhës së urrejtjes, të informacioneve të nevojshme për garantimin e të drejtave dhe të sigurimit të mbështetjes për këto grupe vulnerabël të shoqërisë apo përmes qëndrimeve të institucionit në aktivitetet e zhvilluara nga shoqëria civile për këto grupe.<br>Aktivitet me rastin e 1 Tetorit, takim me të moshuarit, të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, për rolin dhe punën e institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të moshuarve.<br>Takim më datë 23.11 2021 me të rinj nga shoqata të ndryshme në mbrojtje të të drejtave të aftësisë së kufizuar, organizatat e pakicave Rome e Egjiptiane etj, në mjediset e institucionit të Avokatit të Popullit, mbi rolin e institucionit tonë, si një institucion i pavarur për të drejtat e njeriut në një sistem demokratik, funksionin dhe mënyrat e qasjes së qytetarëve në institucion.<br>Janë zhvilluar takime midis MKPT-së, Departamentit të Kufirit dhe Migracionit pranë DPP, UNHCR dhe CARITAS me qëllim rritjen e përgjegjësisë, etikës dhe profesionalizmit të punonjësve të policisë që shërbejnë në pikat e kalimit të kufirit, për trajtimin sa më dinjitoz të emigrantëve, kryesisht të grupeve vunerabël si gratë, fëmijët e pashoqëruar etj.<br>Takime të Komisionerit të MKPT-së me përfaqësues të UNHCR dhe CARITAS, që kryejnë aktivitetin pranë zonave kufitare, me qëllim mbështetjen me ushqime, materiale për fjetje dhe veshmbathje të migrantëve.<br>Takime pune midis oficerëve të kontaktit,drejtuesve vendor të kufirit dhe migracionit në Gjirokastër dhe Korçë dhe përfaqësues të CARITAS, për trajtimin dhe informimin e migrantëve, si dhe garantimin e të drejtave ndërkombëtare të | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | migrantëve, në momentin e kalimit të kufirit në territorin shqiptar. | | | |
| | AP/ NJQV; OSHC | | | | | | | | | | |
| | 96601AA | | | | | | | | | | |
| 4.5.1.b | Veprimtari promovuese për të drejtat e njeriut (përfshirë çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve/ mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna/ aktivitete me fëmijë dhe familje nga komunitete të ndryshme<br>(aktivitetet e parashikuara nga AP fillojnë zbatimin nga 6M II 2020) | | 1,002<br>502 B.Sht.<br>500<br>UNICEF | 1,237, 915 ALL total projekt i<br>**185 (AP)** | 100%<br>**36.8% (AP)** | 1,237,915 ALL total projekti<br>ose 100%<br>**470.5 (AP)** | **100%**<br>**100% (AP)** | **I ZBATUAR (Q. Europiane)**<br>Hartimi i nje broshure mbi te drejten per te mos u diskriminuar, me fokus tek gjuha e urrejtjes dhe bullizmi (ngacmimi) ne shkolla. Broshura eshte shperndare gjate trajnimeve me psikologe/punonjes sociale dhe nxenes ne shkolla te qytetit te Pogradecit dhe Lushnjes.<br>Keshilli i Evropes dhe BE.<br>**I ZBATUAR (AP)**<br>Në kuadër të aktivitetit të "Ditë të hapura" Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve pranë insitucionit të Avokatit të Popullit ka kryer aktivitetet sa më poshtë:<br>Organizimi i veprimtarive "Ditë të hapura" në bahkëpunim me UNICEF, në datat 28-29.1.2021, me nxënës dhe mësues të shkollës 9 vjeçare "Migjeni" në qytetin e Pukës.<br>Organizimi i veprimtarive "Ditë të hapura" në bahkëpunim me UNICEF, në datat 25.3.2021, me nxënës dhe mësues të shkollës 9 vjeçare "Nonda Bulka" në qytetin e Përmetit.<br>Organizimi i veprimtarisë "Ditë të hapura" në bahkëpunim me UNICEF, më datë 29.3.2021, me nxënës dhe mësues të shkollës 9 vjeçare "Besëlidhja" në qytetin e Lezhës.<br>Organizimi i veprimtarisë "Ditë të hapura" në bahkëpunim me UNICEF, më datë 20.5.2021, me nxënës dhe mësues të shkollës 9 vjeçare "Shefki Muçllari" në qytetin e Pogradecit. | | | **Në vazhd im** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Organizimi i veprimtarisë "Ditë të hapura" në bashkëpunim me UNICEF, më datë 1.6.2021, me nxënës dhe mësues dhe prindër të shkollës 9 vjeçare "Urani Rumbo" në qytetin e Gjirokastrës.<br><br>Vizitë e KMPDF-së, SMPDF-së dhe ekspertëve të UNICEF, në datë 11.5.2021, në Institutin e të Miturve Kavajë, me qëllim vlerësimin e ndikimit (Impact Assessment-CRIA), që situata e shkaktuar nga COVID-19, ka patur tek të drejtat e fëmijëve të privuar nga liria.<br><br>Ne bashkepunim me UNICEF, u realizua tryeza në datë 28.7.2021, me qëllim paraqitjen e gjetjeve dhe rekomandimeve "Për garantimin e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin viktima apo dëshmitarë, gjatë periudhës së pandemisë në institucionet e privimit të lirisë."<br><br>Ndërkohë që Seksioni i Veçantë pranë Avokatit të Popullit, në datat 4 dhe 21 mars 2021, Komiteti Shqiptar i Helsinkit së bashku me përfaqësues të Avokatit të Popullit ka organizuar në qytetet e Kukësit dhe të Himarës takime, në kuadër të projektit të UNDP "Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri", në zbatim të nismës "Njohja e të drejtave përmes ndihmës juridike falas", grant i cili është mundësuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim UNDP Albania, në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (Austrian Development Agency). | | | |
| | AP; KMD/ NJQV; OSHC | | | | | | | | | | |
| | 96601AA (kodi i produktit AP) | | | | | | | | | | |
| 4.5.1.c | Zhvillimi i Ditëve të Hapura për të drejtën e informimit | | 5, 376<br><br>2,480 B.Sht. | 0 | 100% | 36% | **100%** | **I REALIZUAR ( KDIMDP)**<br><br>Në Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u zhvillua takimi me një grup | | Do të vijojë bashkëp unimi | **Përfu ndua** |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2, 896<br>Hendek | | | | | nxënësish të gjimnazeve të Tiranës, në kuadër të projektit "Act on Hate" (Vepro kundër urrejtjes) që zbatohet nga Qendra "Act for Society" (Vepro për shoqërinë). Të rinjtë shfaqën interes për veprimtarinë e institucionit, ata u njohën me historikun e autoritetit, legjislacionin, rolin dhe funksionet e tij, si dhe me një panoramë të aktiviteteve të zhvilluara ndër vite në të gjithë vendin, kryesisht, me nxënës e mësues të arsimit para universitar. | | me Autoritet Publike me qëllim realizimin e ditëve të hapua edhe | **r 2020**<br>**Në vazhdim** |
| | KDIMDP / NJQV; OSHC; org ndërkombëtare | | | | | | | | | | |
| | 98901AA | | | | | | | | | | |
| 4.5.1.ç | Ditët e Hapura (disa ditë/vit) pranë Bashkive/forume me qytetarë për t'u njohur me punën e institucioneve dhe shërbimet që ofrohen në nivel lokal të zhvilluara (çështje të dhunës/mbrojtjes së fëmijëve) | | Kosto administrative | | | | **0%** | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **Përfunduar 2020** |
| | MB/AMVV; OSHC | | | | | | | | | | |
| | 91602AC (Aktivitet për bashkërendim procesesh mes bashkive) | | | | | | | | | | |
| 4.5.1.d | Ndërtimi i faqeve të internetit për 48 bashki dhe formatimi i tyre në një format lehtësisht të aksesueshëm për qytetarin duke ndikuar edhe në edukimin ligjor të tyre | | 3, 625<br>STAR 2 | | | | **0%** | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **Në vazhdim** |
| | MB/AMVV; NJQV | | | | | | | | | | |
| | 91602AC (Aktivitet për bashkërendim procesesh mes bashkive) | | | | | | | | | | |
| 4.5.1.dh | Qytetarë të informuar mbi bashkitë, mbi akte dhe dokumente informative dhe pjesëmarrje aktive në vendimmarrje (dokument miqësor "Plan dhe raport performance për aprovimin dhe monitorimin e parave lidhur me rezultatet" | | 16, 000<br>Bashkitë e Forta Helvetas | | | | **0%** | **I PAZBATUAR/PARAPORTUAR** | | | **Në vazhdim** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | MB/AMVV; NJQV | | | | | | | | | | |
| | 91602AC (Aktivitet për bashkërendim procesesh mes bashkive) | | | | | | | | | | |
| 4.6 | **Objektivi specifik 4.6: Rritja e pjesëmarrjes dhe rolit të studentëve të drejtësisë dhe profesionistëve të së drejtës në ELP** | | | **181,200 Lekë** | **100%** | **36.8%** | **100%** | **I ZBATUAR** | | | |
| 4.6.1 | **Qytetarët të informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore, nëpërmjet aktiviteteve me studentë të ligjit dhe avokatë të specializuar** | | **7,513** | **181,200 Lekë** | **100%** | **36.8%** | **100%** | **I ZBATUAR** | | | **2020-2023** |
| 4.6.1.a | Aktivitete të zhvilluara me studentë të shkencave të komunikimit për të ofruar ELP pranë komuniteteve | | 713 | **178,200 lekë**<br>Paraportuar | 100%<br>Paraportuar | 100%<br>Paraportuar | **100%**<br>**100%** | **I ZBATUAR (MD)**<br>**Pa përshkrim të zhvillimit të aktivitetit.**<br>**I ZBATUAR (DNJF)**<br>Stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas zhvilloi trajnimin me temë "Aksesi në drejtësi dhe risitë e ligjit nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", mbajtur me studentët e angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve me të cilat Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur marrevëshje bashkëpunimi.<br>Në këtë takim online u trajtuan temat: "Instrumentët ndërkombëtarë që garantojnë aksesin në drejtësi të qytetarëve ndërmjet ofrimit të ndihmës juridike falas; Sistemi i ndihmës juridike parësore; Sistemi i ndihmës juridike dytësore; Arritjet e sistemit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe sfidat për të ardhmes si dhe parashtrimi i rasteve praktike nga punonjësit i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë".<br>Në fund të këtij aktiviteti sudentët u pajisën me një vërtetim pjesëmarrjeje. | | | **Në vazhdim** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | MD; DNJF; MASR/OSHC; IAL | | | | | | | | | | |
| | 91401AA (MD); 91105AA(MASR) | | | | | | | | | | |
| 4.6.1.b | Organizimi i Shkollës Verore "Informim dhe Privatësi" me Universitete në rrethe të ndryshme të vendit<br><br>*Aktivitet i organizuar 6M I/çdo vit | | 3, 200 | 3,200 | 100% | 36.8% | **100%** | **I ZBATUAR (KDIMDP)**<br><br>Gjatë muajit dhjetor 2021, Zyra e Komisionerit zhvilloi dy aktivitete online me Universitetet "Fan Noli" të Korçës dhe "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës,. Në trajnimet "E drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale" morën pjesë më shumë se 100 studentë, staf akademik/administrativ nga këto Institucione të Arsimit të Lartë (IAL), të cilët u njohën me legjislacionin e të dy fushave, rolin dhe funksionet e institucionit dhe me raste praktike. | | Do të vijojë zbatimi i objektivit sipas afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit të SELP | **Në vazhdim** |
| | KDIMDP/ IAL | | | | | | | | | | |
| | 98901AA | | | | | | | | | | |
| 4.7 | **Objektivi specifik 4.7: Përmirësimi i programit të edukimit ligjor në lëndët bazë të arsimit parauniversitar dhe pasurimi i kurrikulave e aktiviteteve ekstrakurrikulare me elemente të edukimit ligjor** | | | **1,733, 372 Lekë** | **60.1%** | **66.7%** | **97.3%** | **I ZBATUAR** | | | |
| 4.7.1 | **Rishikimi i programeve të trajnimit të mësuesve duke integruar specifikisht elemente të edukimit ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve** | | **520**<br>**F. Huaj** | **0** | **0%** | **0%** | **92%** | **I ZBATUAR** | | | **2020-2023** |
| 4.7.1.a | Ngritja e grupit të punës me ekspertë të arsimit dhe të fushës ligjore për rishikimin e programeve të trajnimit të mësuesve | | 320 UNICEF | Paraportuar | Paraportuar | Paraportuar | **75%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT (MAS)**<br><br>Projekti i edukimit kundër krimit të rëndë dhe të organizuar, bashkëpunim i MAS me Ambasadën Angleze, shtrihet në shkollat nëntëvjeçare dhe të mesme të qytetit të Kukësit, Peshkopisë, Shkodrës dhe të Kamzës. | | Rishikuar mundësia e trajnimit të mësuesve, specifiki | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Në 6 mujorin e parë të vitit 2021, është hartuar drafti i parë i manualit të edukimit kundër krimit të organizuar dhe ka filluar procesi i pilotimit.<br><br>Ky trajnim përfshin çështje të kuptimit të ligjit dhe të pedagogjisë së edukimit ligjor, të cilat do të trajtohen gjerësisht në fazën e dytë të projektit, i cili parashikon pasurimin e manualit me synimin që ai të përmbushë jo vetëm qëllimin e edukimit kundër krimit të organizuar, por ky edukim, të bëhet pjesë e një edukimi të gjerë ligjor të mësuesve.<br><br>Në muajin shtator në IAP, është realizuar trajnimi me mësues “Njohja Institucionale me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe njohjen e detyrimeve Institucionale” nga punonjësit e SHPS, nëpërmjet të cilit është bërë e mundur njohja e mësuesve me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe detyrimet institucionale. ASCAP synon edukimin ligjor të rrjeteve të trajnerëve të lëndëve shoqërore dhe më gjerë trajnimin e mësuesve të kësaj lënde.<br><br>Gjithashtu, në periudhën tetor-nëntor 2021, është bërë ngritja e grupit koordinator në çdo shkollë, si dhe personi përgjegjës për planifikimin dhe realizimin e veprimtarive si shkollë dhe në rang ZVAP-je, hartimi i planeve për vitin shkollor 2021-2022, për zbatimin e strategjisë për edukimin ligjor të publikut, SELP, në nivel ZVAP-je dhe miratimi nga DRAP-et, duke përcaktuar dhe planin e aktiviteteve në rang shkolle dhe ZVAP.<br><br>Gjatë periudhës shtator-tetor 2021, është vijuar me trajnimin e mësuesve që japin lëndën e Qytetarisë të cilët kanë një qasje më të afërt me problematikat në shkolla dhe trajtojnë në lëndën e tyre tema të dedikuara për çështjet sociale. Shkollat i kanë kushtuar rëndësi aktiviteteve festive të Ditës së Fëmijëve, ku një rëndësi e vecantë i është kushtuar promovimit të të drejtave të tyre në forma rekreative dhe artistike. | | sht atyre të lëndës së Qytetarisë, me qëllim përmirësimin e aftësive profesionale në kudër të ELP | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | MASR; ASCAP/OSHC | | | | | | | | | | |
| | 911003AF | | | | | | | | | | |
| 4.7.1.b | Identifikimi i elementeve të edukimit ligjor që do të përshtaten dhe përfshihen në programet e trajnimit të mësuesve | | Kosto administrat ive | | | | **100%** | **I ZBATUAR (MAS)**<br><br>Bazuar në dinamikat e jetës së përditshme ekonomike e politike në vend ka filluar puna nga personat përgjegjës për këtë kurrikul në ASCAP për të identifikuar çështjet ligjore që kanë fituar përparësi në trajtesat e sotme dhe për t'i bërë ato pjesë të procesit të të mësuarit në shkollë (nën objektivi 4.7.1.a dhe b))<br><br>Kjo punë paraprake synon të formulojë edhe draft idetë që do të paraprijnë ndërhyrje të mirë menduara në kurrikulën ekzistuese të lëndës së qytetarisë në arsimin para universitar.<br><br>Janë realizuar gjatë periudhës tetor 2021, takime të organizuara nga psikologu/punonjësi social i shkollës, ku është ftuar punonjësja e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve për respektimin e të drejtave të fëmijëve nga pakicat kombëtare dhe kulturore, edukimin ndaj barazisë dhe të drejtave të njeriut, reduktimit të diskriminimit racor dhe gjinor, si dhe për ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me raportimin e dhunës tek ata dhe bashkëmoshatarët e tyre. Mbi bazën e këtyre takimeve është bërë i mundur identifikimi i nxënësve të komunitetit egjiptian, nga mësuesit e trajnuar kundër diskriminimit. Janë realizuar takime konsultuese me nxënës, prindër e mësues mbi menaxhimin efektiv të konflikteve shkollore dhe orientimin e prindërve që kanë adoleshent në konflikt me ligjin, ndjekur nga punonjësi social/psikologu i shkollës. Koordinimi i mësuesve në hartimin dhe prezantimin e projekteve të përbashkëta me bazë SELP. (projekte, ese, konkurse).<br><br>Gjithashtu, janë realizuar projekte të përbashkëta me bazë SELP (projekte, ese, konkurse). Edukimit ligjor i të rinjve është parë ngushtë me një çështje shumë të | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | rëndësishme si me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin tek të rinjtë. Me rastet e konstatuara është punuar në veçanti duke bashkëpunuar me prindërit me përfaqësues të pushtetit vendor. Është bërë i mundur identifikimi i të rinjve me prirje ekstreme, në orët e kujdestarisë dhe realizimi i veprimtarive sensibilizuese brenda shkollës, duke shpërndarë fletë-palosje. | | | |
| | MASR | | | | | | | | | | |
| | 911003AF | | | | | | | | | | |
| 4.7.1.c | Përditësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i moduleve të trajnimit të mësuesve që ofrohen nga organizata të interesuara në fushën e edukimit ligjor | | 200 UNICEF | | | | **100%** | **I ZBATUAR (MAS)**<br><br>Në gjashtëmujorin e parë të këtij vitit 2021, janë zhvilluar takime me mësues të lëndëve të ndryshme të arsimit 9- vjeçar (10 mësues) dhe të mesëm (10 mësues) për edukimin për median dhe informimin për mundësinë e përshtatjes së këtij edukimi, si pjesë e edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut në arsimin para universitar, fillimisht përmes përshtatjes së kurrikulës për trajnimin e mësuesve dhe të moduleve përkatëse për këtë trajnim.<br><br>Kjo kurrikul dhe këto module të plota për edukimin për median, kanë si bosht kryesor zbatimin e të drejtave të njeriut (kryesisht e drejta për informim, e drejta për arsimim, detyrimi për të garantuar sigurimin e këtyre të drejtave etj.)<br>**Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021**, në vijim të punës për trajnimin e mësuesve të mësipërm nga 20 shkolla nga Rajone të ndryshme të vendit, janë zhvilluar veprimtaritë e mëposhtme:<br>Janë trajnuar 120 mësues të 10 shkollave pilot të të gjitha lëndëve që mësohen në shkollë, në fushën e përdorimit të edukimit për median dhe informimin, të vlerësuar në kuadrin përmbushjes së objektivave kombëtarë që burojnë nga miratimi i Kartës së Edukimit për Qytetari | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Demokratike dhe të Edukimit për të Drejtat e Njeriut, e Këshillit të Evropës, e në mënyrë të veçantë, e të drejtës së fëmijës për edukim dhe informim dhe për të përmbushur interesin e tij më të mirë.<br>Në periudhën Tetor 2021-Dhjetor 2021, në shkollat e përzgjedhura, janë zhvilluar veprimtaritë mësimore me nxënësit që synonin përdorimin e medias dhe të informimit:<br>Për pasurimin e informacionit kurrikular përmes përdprimit të burimeve të ndryshme të medisa.<br>Për zhvillimin e aftësive të larta mendore përmes trajtimit të çështjeve të shumta globale që prekin dhe interesojnë jetën e çdo individi, të cilat ofrohen nga media dhe ofruesit e tjerë të informacionit, si janë Të drejtat e njeriut, zbatimi i ligjit, trajtimi i barabartë përpara ligjit, korrupsioni, papunësia, mjedisi, klima, etj. etj.<br>Për shprehjen e qëndrimeve individuale ose të grupit në lidhje me çështjet globale të përmendura më sipër duke përdorur në mënyrë krijuese median dhe format e larmishme të saj.<br>Në këtë periudhë, veprimtaritë e zhvilluara nga mësuesit janë mbikëqyrur nga specialistët e kurrikulës së ASCAP, të cilët përveç këtij funksioni kanë luajtur edhe të këshilluesit për zhvillimin me cilësi të veprimtarive, por edhe të vlerësuesit të cilësisë së tyre, për të përmirësuar punën e planifikuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 me 120 mësues të 10 shkollave të mesme e të nxënësev që janë përfituesit fundor të këtij trajnimi.<br>Këto veprimtari janë zhvilluar me mbështetjen financiare të UNESCO, përmes Institutit Shqiptar të Medias si partner në këtë proces.<br>Janë realizuar aktivitete të përbashkëta me organizatën e shoqërisë civile ENGIM dhe LIBERA në projektin "Rise-Alb" për nxitjen e kulturës së ligjshmërisë tek nxënësit e arsimit të mesëm të lartë (Tetor, nëntor 2021, vazhdon deri në maj 2022). | | | |
| | MASR; ASCAP; AShMDF /OSHC | | | | | | | | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 911003AF | | | | | | | | | | |
| 4.7.2 | **Kapacitete të përmirësuara të stafit arsimor për EL të fëmijëve dhe fuqizimi i tyre nëpërmjet informimit mbi të drejtat e tyre dhe strukturat mbrojtëse** | | **11,000** | **492,200 Lekë** | **100%** | **100%** | **100%** | **I ZBATUAR** | | | **Viti 2021** |
| 4.7.2.a | Ngritja dhe forcimi kapaciteteve për të zhvilluar te mësuesit, punonjësit psikosocial, oficerët e sigurisë kompetencën lidhur me edukimin për qytetari demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut | | 10,800 | 4000 Euro<br>TLAS/SAPI/EU | 100% | 100% | **100%**<br><br>**100%** | **I ZBATUAR (Q. TLAS)**<br>Me mesuesit, psikologet e 5 shkollave te arsimit parauniversitar ne Tirane.<br>**I ZBATUAR (MAS)**<br>Çështjet aktuale, me dimensione të qarta ligjore, po trajtohen në kuadrin e nevojës për rishikimin e programit të trajnimit të mësuesve të lëndëve shoqërore në përgjithësi dhe të qytetarisë në mënyrë të veçantë. (Objektivi specifik 4.7.1) Ky trajnim do të bëjë të mundur që çështjet ligjore që në të ardhmen do të trajtohen në kuadrin e kurrikulës zyrtare, do të bëhen më shpejt, përmes mësuesve të lëndës, pjesë e procesit mësimor, e zhvillimit të aftësive të nxënësve për të trajtuar në mënyrë kritike ligjin dhe dukuritë shoqërore, për të trajtuar çështjet kundërshtuese etj.<br>Janë realizuar aktivitete të përbashkëta me organizatën e shoqërisë civile ENGIM dhe LIBERA në projektin "Rise-Alb" për nxitjen e kulturës së ligjshmërisë tek nxënësit e arsimit të mesëm të lartë (Tetor, nëntor 2021, vazhdon deri në maj 2022). ZVAP-të, kanë realizuar koordinimim e veprimtarive edukuese ligjore të IAP-ve me institucionet e tjera në nivel vendor si Bashkia, NJMF, Komisariatin e Policisë, Bordet e prindërve, me individë vullnetarë të fushës së edukimit ligjor (jurist, avokat) dhe prefekturë/nënprefekturën. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, janë zhvilluar vizita të nxënësve në objekte të sekuestruara ku demonstrohet zbatimi i ligjit kundër krimit të organizuar, takime me nxënësit | | | **Viti 2021** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | për tema të sociologjisë e të edukimit ligjor.<br><br>Shërbimi psiko-social me mësuesit e lëndës Qytetari ka realizuar në klasat AMU informim mbi aktet ligjore që mbrojnë fëmijët nga dhuna, diskriminimi dhe keqtrajtimi, neglizhimi, shfrytëzimi seksual, trafikimi, “Karta Universale e të Drejtave të Njeriut”. Nxënësve ju bë e njohur se mund të ndiqen penalisht nëse janë mbi moshën 14 vjec, në rast se kryejnë veprime të jashtëligjshme. Janë realizuar aktivitete informuese dhe sensibilizuese në bashkëpunim me oficeret e policisë te komuniteti në klasat AML për njohjen me aktet ligjore ndaj dhunuesve, abuzuesve, trafikanteve etj. Janë realizuar aktivitete informuese dhe sensibilizuese me oficerët e policisë. | | | |
| | MASR; ASCAP; AShMDF /OSHC | | | | | | | | | | |
| | 91104AC | | | | | | | | | | |
| 4.7.2.b | Përmirësim të kapaciteteve të mësuesve të arsimit parauniversitar nga specialistë të fushës së edukimit ligjor dhe të drejtat e fëmijëve | | 200 | 200 | 100% | 100% | **100%** | **I ZBATUAR (MAS)**<br><br>Pilotim i veprimtarive të edukimit ligjor (moduli) me nxënës të arsimit nëntëvjeçar dhe të mesëm në 8 shkolla 9-vjeçare, aktiviteti do të vijojë me targetimin e një nr. të caktuar të shkollave pilot, duke synuar mbulimin e një nr. të konsiderueshëm shkollash në vend.<br><br>Për njohjen me ligjet që mbrojnë dhe orientojnë të rinjtë janë realizuar sesione informuese përgjatë periudhës nëntor-dhjetor 2021, në orën e Qytetarisë, duke i njohur drejtpërdrejt këto ligje, duke i interpretuar dhe duke analizuar pasojat, ku nuk zbatohen. Janë realizuar sesione informuese me nxënës me Komisionerin e Mbrojtjes nga Diskriminimi. Janë hapur brenda ambienteve të shkollës kënde të posaçme për prezantimin e ligjeve, rregullores së shkollës, plani i aktiviteteve mujore etj.<br><br>Në periudhën shtator-dhjetor 2021, Janë zhvilluar aktivite me mësues për njohjen e Avokatit të Popullit. Komisioneri dhe | | | **6M I 2021** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve në institucionin e Avokatit të Popullit ka realizuar veprimtari "Ditë të hapura", në disa shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në disa bashki të vendit. Më konkretisht, datë 30.9.2021, në shkollën 9 vjeçare "Nr. 3" në qytetin e Laçit, datë 6.10.2021, në shkollën 9 vjeçare "Mustafa Myrteza Kaçaçi" në qytetin e Krujës, datë 21.10.2021, në shkollën 9 vjeçare "Demir Godelli" në qytetin e Peqinit, datë 28.10.2021, në shkollën 9 vjeçare "Xhorxh Soros", në qytetin e Rrogozhinës, datë 8.11.2021, në shkollën e mesme "18 Tetori", në qytetin e Lushnjes, datë 11.11.2021, në shkollën e mesme "Kostandin Kristoforidhi" në qytetin e Elbasanit, datë 9.12.2021, në shkollën 9 vjeçare "Stavri Themeli" në qytetin e Korçës. Veprimtari në shkolla "Ditë të hapura" nga Komisioneri dhe Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve në institucionin e Avokatit të Popullit. Në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Edukimin Ligjor Publik (SELP) 2019-2023, në të gjitha institucionet arsimore në varësi të DRAP Korçë, Durrës, Lezhë dhe Fier janë zhvilluar veprimtari ndërgjegjësuese nga Njësia e Shërbimit Psiko-social (NjShP) në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave.<br><br>Në shkolla janë realizuar veprimtari informuese, ndërgjegjësuese dhe sensibilizuese sipas fushave të mëposhtme:<br><br>Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës<br><br>Për mbrojtjen nga diskriminimi<br><br>Për barazinë gjinore<br><br>Bashkëpunimi me aktorë të shoqërisë civile<br><br>Veprimtari të rrjeteve profesionale<br><br>Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës<br><br>•Në muajin Janar 2021 në IAP e DRAP-e është realizuar trajnimi me mësues "Njohja Institucionale me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe njohjen e | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | detyrimeve Institucionale” nga punonjësit e SHPS.<br>•Në shkolla janë zhvilluar takime të organizuara nga psikologu/punonjësi social i shkollës dhe ku është ftuar Punonjësja e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve për ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me raportimin e dhunës tek ata dhe bashkëmoshatarët e tyre.<br>Shkollat i kanë kushtuar rëndësi aktiviteteve festive të Ditës së Fëmijëve 1 Qershor ku një rëndësi e vecantë i është kushtuar promovimit të të drejtave të tyre në forma rekreative dhe artistike.<br>Në muajin Shtator 2021 është realizuar një trajnim me mësuesit e që japin lëndën e Qytetarisë të cilët kanë një qasje më të afërt me problematikat në shkolla dhe trajtojnë në lëndën e tyre tema të dedikuara për çështjet sociale.<br><br>Për mbrojtjen nga diskriminimi<br>Një nga aktivitetet e rëndësishme ka qenë ai për Antiekstremizmin dhe Antibullizmin. Çdo shkollë ka hartuar prej dy vitesh këto dokumenta të cilat çdo vit rishikohen nga Ekipet e Punës. Ky element është monitoruar nga psikologët/punonjësit social në shkolla.<br>Muaji Prill, data 8, si Dita Ndërkombëtare e Romëve i është dedikuar aktiviteteve ndërgjegjësueseme nxënës të cilët promovuan simbolet e këtij minoriteti dhe të kulturës Rome si një mënyrë për të respektuar të drejtat dhe për të minimizuar diskriminimin e tyre.<br>Në shkollat e mesme, në muajin Maj 2021, janë zhvilluar biseda për ndërgjegjësimin e nxënësve për të ruajtur infomacionin personal dhe për të treguar kujdes me marrëdhëniet online. Mësuesit e qytetarisë kanë dhënë informacion lidhur me Ligjin për Mbrojtjen e e të Dhënave Personale dhe për Institucionin e Komisionerit për mbrotjen nga Diskriminimin.<br>Muaji Nëntor i është kushtuar aktiviteteve në kuadër të Ditës Kombëtare kundër Bullizmit. Çdo shkollë ka organizuar aktivitete në formën e punimeve artistike, | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | të temave ndërgjegjësuese, fokus grupeve etj.<br><br>Për barazinë gjinore<br><br>•Në muajin shkurt është realizuar nga Shërbimi Psiko-Social në shkolla një fushatë ndërgjegjësimi me nxënës ku janë punuar materiale të përgatitura dhe ku nxënësit kanë punuar mbi Stereotipet dhe rolet gjinore. Fokusi ka qënë në shkollat e Mesme dhe në mënyrë specifike në punën me djemtë.<br><br>•Në muajin Mars 2021 nga mësuesit e Qytetarisë janë zhvilluar trajnime lidhur me stereotipet, diskriminimin dhe paragjykimin gjinor. Rritja e aftësive të mësuesve ka shumë rëndësi pasi ata duhet t'i trajtojnë me shumë kujdes dhe prioritet këto koncepte me nxënësit.<br><br>•Në prill 2021 psikologët/punonjësit social në shkolla kanë zhvilluar një fushatë takimesh me nxënësh ku I nëkanë njohur ata me Ligjin për Masat kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare. Njohja e nxënësve me këtë ligj u ka dhënë nxënësve mundësine e të kuptuarit të ligjit dhe të koncepteve që ai trajton.<br><br>•Nëntor-Dhjetor 2021 në kuadër të Fushatës Portokalli shkollat kanë zhvilluar aktivitete ku kanë promovuar të drejtat e grave dhe vajzave dhe të cilat janë publikuar në rrjetet sociale.<br>**Bashkëpunimi me aktorë të shoqërisë civile**<br><br>Në muajin shkurt 2021 është zhvilluar një takim online me aktoret lokalë për mbrojtjen e fëmijëve. Në fokus ka qënë ndikimi i situatës emergjente COVID19 në rrezikun për mbrotjen e fëmijëve. Pasojat e pandemisë kanë sjellë probleme të marrëdhënieve familjare dhe për pasojë edhe në përgjegjësitë prindërore të familjeve vulnerabël.<br>Gjatë këtij gjashtëmujori në IAP të ndryshme janë zhvilluar takime në shkolla me punonjës të sigurisë rrugore të cilët kanë zhvilluar biseda me nxënës për | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | cështje të rregullave rrugore dhe të sigurisë rrugore si shoferë dhe këmbësorë.<br>Në muajin Prill 2021 është planifikuar një aktivitet me mësues për njohjen e Avokatit të Popullit. Ky aktivitet nuk është realizuar në shkolla për shkak se takimet në shkolla në grupe të mëdha janë minimizuar për shkak të kushteve dhe masave të pandemisë. Ky aktivitet është përshtatur në biseda të psikologëve/punonjësve social për rolin dhe aktivitetin e Avokatit të Popullit.<br>**Veprimtari të rrjeteve profesionale**<br><br>Në janar 2021 rrjeti i SHPS ka realizuar temën e trajnimit mbi Aspekte Ligjore të Mbrojtjes së Fëmijëve<br>Në muajin Shtator 2021, Rrjeti I SHPS ka realizuar trajnimin mbi Teknika të punës me nxënës që promovojnë Shprehitë Pozitive dhe Reziliencën.<br><br>Edukimi për median dhe informimin në kukadrin e edukimit qytetar dhe i realizimit cilësor i të drejtës së fëmijës për informim dhe shkollim, do të vijojë në vitin 2022 në 10 shkolla të mesme nga 4 DAR<br><br>Në vitin 2022 filloi projekti për edukimin kundër korrupsionit, të drejtuar nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me MAS dhe Ambasadën e Italisë nëTiranë, që përfshin 4 shkolla të mesme dhe rreth 150 nxënës. Specialistët e fushës ligjore nga Ministria e Drejtësisë janë personat përgjegjës për edukimn e mësuesve dhe të nxënësve në fushën e luftës kundër korrupsionit. | | | |
| | MASR; DPAP/ OSHC | | | | | | | | | | |
| | 91104AC | | | | | | | | | | |
| 4.7.2.c | Ngritja e kapaciteteve të stafit arsimor (mësues/(edukatorë/ punonjës socialë/psikolog) mbi kompetencën mbi edukimin ligjor për fëmijët me AK | | Kosto administrative | | | | **100%** | **I ZBATUAR (MAS)**<br><br>Janë bërë trajnime online (për shkak të situates së krijuar nga pandemia Covid 19) me SHPS dhe mësuesit ndihmës në | | | **6M I 2021** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | rrjetin profesional për t'i ardhur në ndihmë fëmijëve me AK. | | | |
| | MASR/OSHC | | | | | | | | | | |
| | 91104 AC | | | | | | | | | | |
| 4.7.3 | **Aktivitetet informuese dhe edukuese në institucionet e arsimit parauniversitar të zhvilluara** | | **6,715**<br>**(3, 700 F.Huaj)** | **1,241, 172 Lekë** | **80.2%** | **141%** | **100%** | **I ZBATUAR** | | | **2020-2023** |
| 4.7.3.a | Hartimi i planit të aktiviteteve vjetore të ELP në institucionet e arsimit parauniversitar (I) Miratimi nga DAR i planeve të aktiviteteve vjetore për ELP në institucionet e arsimit parauniversitar- viti 2020 (II) Zhvillimi i aktiviteteve sipas planit të miratuar dhe Realizimi i orëve të hapura me klasat e arsimit parauniversitar; botimi i materialeve informuese, nga AP - viti 2021/2022 (III) Konferencë për të drejtat e fëmijëve nga AP - viti 2021<br>(aktivitetet e parashikuara nga AP fillojnë zbatimin nga 6M II 2020) | | 795 | 160<br>**395 (AP)**<br>795 (MAS) | 40.5% | 73.73(AP) | **100%** | **I ZBATUAR (AP)**<br>Në kuadër të këtij aktiviteti Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve pranë Avokatit të Popullit ka zhvilluar aktivitetet sa më poshtë:<br>-Organizimi i dy veprimtarive "Ditë të hapura", në datë 4.5.2021, me nxënës dhe mësues të shkollës 9-vjeçare "Aleks Buda" në qytetin e Cërrikut, si dhe shkollën 9-vjeçare "Asllan Shahini" në qytetin e Gramshit. Organizimi i dy veprimtarive "Ditë të hapura", në datë 6.5.2021, me nxënës dhe mësues të shkollës 9-vjeçare "Genc Leka" në qytetin e Librazhdit dhe shkollës 9-vjeçare "Qybra Sokoli" në qytetin e Prrenjasit.<br>-Veprimtari online "Ditë e hapur", datë 24.2.2021, me grupin e të rinjve "Zëri 16+", Save the Children, me fëmijë, përfaqësues të katër qyteteve të vendit, konkretisht: Elbasanit, Durrësit, Peshkopisë dhe Burrelit, veprimtari që vijnë edhe në zbatim të parimit, për garantimin e të drejtës së fëmijës për t'u shprehur dhe dëgjuar<br>-Veprimtari online "Ditë e hapur", datë 15.4.2021, me grupin e të rinjve të Klubeve IMPACT të organizatës World Vision, të rinj, përfaqësues të dy bashkive Kamzë dhe Kurbin, në zbatim të parimit, për garantimin e të drejtës së fëmijës për t'u shprehur dhe dëgjuar.<br>-Vizitë dhe takim me mësues dhe nxënës në Shkollën e Bashkuar Dervician, | | | **6M I 2021** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Bashkia Dropull, datë 1.6.2021, me rastin e festës së fëmijës.<br>- Veprimtari "Ditë të hapura", datë 30.9.2021, në shkollën 9 vjeçare nr. 3 në qytetin e Laçit;<br>- Veprimtari "Ditë të hapura", datë 6.10.2021, në shkollën 9 vjeçare "Mustafa Myrteza Kaçaçi" në qytetin e Krujës;<br>- Veprimtari "Ditë të hapura", datë 21.10.2021, në shkollën 9 vjeçare "Demir Godelli" në qytetin e Peqinit;<br>- Veprimtari<br>- "Ditë të hapura", datë 28.10.2021, në shkollën 9 vjeçare "Xhorxh Soros", në qytetin e Rrogozhinës; Veprimtari "Ditë të hapura", datë 8.11.2021, në shkollën e mesme "18 Tetori", në qytetin e Lushnjës;<br>- Veprimtari "Ditë të hapura", datë 11.11.2021, në shkollën e mesme "Kostandin Kristoforidhi" në qytetin e Elbasanit;<br>- Veprimtari "Ditë të hapura", datë 9.12.2021, në shkollën 9 vjeçare "Stavri Themeli" në qytetin e Korçës.<br><br>Realizimi i tryezës në datë 18.11.2021 nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, të cilët me mbështetjen e UNICEF-it në Shqipëri, organizuan një aktivitet promovues për lancimin e botimit miqësor "Fëmijët dhe të drejtat e tyre".<br><br>Me mbështetjen e UNICEF-it, SMPDF/AP monitoroi disa bashki të vendit lidhur me mbrojtjen sociale që i ofronin fëmijëve në nevojë dhe familjeve të tyre dhe me datën 24.11.2021 organizoi konferencën për prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve, sfidat dhe mundësitë e bashkive për të ofruar masat e mbrojtjes sociale.<br>Në kuadër të këtij aktiviteti u prodhuan: 300 copë – botimi "Doracak për edukimin për/rreth të drejtave të fëmijëve në programet mësimore. | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | **100% (MAS)** | - 500 copë – botim miqësor me titull "Fëmijët dhe të drejtat e tyre".<br><br>**I ZBATUAR (MAS)**<br><br>Në periudhën tetor-nëntor 2021, është bërë ngritja e grupit koordinator në çdo shkollë, si dhe personi përgjegjës për planifikimin dhe realizimin e veprimtarive si shkollë dhe në rang ZVAP-je, hartimi i planeve për vitin shkollor 2021-2022, për zbatimin e strategjisë për edukimin ligjor të publikut, SELP, në nivel ZVAP-je dhe miratimi nga DRAP-et, duke përcaktuar dhe planin e aktiviteteve në rang shkolle dhe ZVAP-je. Gjithashtu, në periudhën tetor-nëntor 2021, është bërë ngritja e grupit të punës në IA për realizimin e planeve të aktiviteteve dhe veprimtarive për Edukimin Ligjor dhe aktivitete sensibilizuese me përfshirjen e nxënësve të AML dhe AMU për luftën kundër trafikimit të personave. Nga ana e nxënësve janë realizuar ekspozita me punime artistike të nxënësve me temën e anti-trafikimit, mesazhe të nxënësve të publikuara.<br><br>Me rastin e 20 nëntorit, ditës së të drejtave të fëmijëve, në institucionet e arsimit parauniversitar është realizuar aktiviteti "Edhe unë gëzoj të drejtat dhe liritë e mia". Gjithashtu, në nëntor 2021, janë realizuar takime me përfaqësues të Policisë së Shtetit. | | | |
| | MASR/DRAP-ZVAP; AP/OSHC | | | | | | | | | | |
| | 911003AF 96601AA (kodi i produktit AP) | | | | | | | | | | |
| 4.7.3.b | Materiale informuese dhe ndërgjegjësim për çështje specifike (dhuna në familje/dhuna me bazë gjinore/etj), të përgatitura dhe të shpërndara në institucionet e arsimit parauniversitar, mësuesve dhe nxënësve | | 200 | 1,237,915 ALL total projekti | 100% | 1,237,915 ALL ose 100% | **100%** | **I ZBATUAR (Q. Europiane)**<br><br>Hartimi i nje broshure mbi te drejten per te mos u diskriminuar, me fokus tek gjuha e urrejtjes dhe bullizmi(ngacmimi) ne shkolla.<br><br>Keshilli i Evropes dhe BE. | | | **Në vazhdim** |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | ***Permendur me siper ne piken 4.5.1.b***<br><br>**I ZBATUAR (MAS)**<br><br>Janë shpërndarë botime të Zyrës së Komisionerit, si “Kuadri i aftësimit të mësuesve të shkollave 9-vjeçare mbi mbrojtjen e të dhënave personale të nxënësve” (https://ëëë.idp.al/ëp-content/uploads/2017/10/Kuadri_i_aftesimit_te_mesuesve.pdf) dhe seti i videove bazuar mbi këtë botim që është publikuar në kanalin zyrtar në YouTube të institucionit 9 https://ëëë.youtube.com/channel/UCVNTGFtxO0RAVzYSXjb5ëgA/videos), si dhe fletëpalosje të ndryshme.<br><br>Një nga aktivitetet e rëndësishme ka qenë ai për Antiekstremizmin dhe Antibullizmin. Çdo shkollë ka hartuar dokumenta, të cilat çdo vit rishikohen nga Ekipet e punës. Kjo gjë është monitoruar nga psikologët/punonjësit social në shkolla, nëpërmjet të cilave është bërë informimi për sjelljet ligjore si dhe raportimi për sjelljet dhe shërbimet e policisë.<br><br>Përgjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor janë realizuar aktivitete ndërgjegjësuese kundër dhunës me bazë gjinore. Produkt i këtyre veprimtarive ka qenë hapja e ekspozitave me piktura dhe me krijime kushtuar kësaj tematike, si edhe konkurse që përcjellin mesazhin më të spikatur STOP DHUNËS. Ndërgjegjësim dhe parandalim i bullizmit kibernetik. Janë zhvilluar “Ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore”, veprimtari në bashkëpunim me DVP Gjirokastër. Gjatë këtyre aktivitete janë realizuar biseda, video sensibilizuese për prindërit. Gjithashtu janë realizuar takime me juristë: “Si të përdorim parimet e qytetarisë aktive për qasje në drejtësi”, nëpërmjet të cilave është synuar edukimi ligjor i nxënësve të arsimit të mesëm të lartë. SHPS në bashkëpunim me mësuesit ka shpërndarë fletëpalosje tek prindërit (viktima të dhunës), përgjatë periudhës nëntor 2019, për të njohur aktet ligjore për reduktimin e dhunës në familje, si dhe | | | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | njohjen e prindërve me Ëeb-in ku mund të ofrohet Shërbim Ligjor falas. Prindërit e përfshirë janë njohur me masat ligjore ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, ndëshkimin e përndjekjes.<br><br>Në dhjetor 2021, është realizuar fushata e ndërgjegjësimit me nxënës mbi stereotipet dhe rolet gjinore. Fokusi ka qënë në shkollat e mesme dhe në mënyrë specifike në punën me djemtë. Në kuadër të Fushatës Portokalli shkollat kanë zhvilluar aktivitete ku kanë promovuar të drejtat e grave dhe vajzave dhe të cilat janë publikuar në rrjetet sociale. Gjatë këtij aktiviteti janë zhvilluar lexime, dramatizime, ndjekje të filmave apo videove. Janë zhvilluar aktivite me mësues dhe nxënës për njohjen e Avokatit të Popullit. Komisioneri dhe Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve në institucionin e Avokatit të Popullit ka realizuar veprimtari "Ditë të hapura", në disa shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në disa bashki të vendit. Më konkretisht, datë 30.9.2021, në shkollën 9 vjeçare Nr. 3 në qytetin e Laçit, datë 6.10.2021, në shkollën 9 vjeçare "Mustafa Myrteza Kaçaçi" në qytetin e Krujës, datë 21.10.2021, në shkollën 9 vjeçare "Demir Godelli" në qytetin e Peqinit, datë 28.10.2021, në shkollën 9 vjeçare "Xhorxh Soros", në qytetin e Rrogozhinës, datë 8.11.2021, në shkollën e mesme "18 Tetori", në qytetin e Lushnjes, datë 11.11.2021, në shkollën e mesme "Kostandin Kristoforidhi" në qytetin e Elbasanit, datë 9.12.2021, në shkollën 9 vjeçare "Stavri Themeli" në qytetin e Korçës. | | | |
| | MASR; DPAP/ OSHC | | | | | | | | | | | |
| | 91103AB | | | | | | | | | | | |
| 4.7.3.c | Fushata ndërgjegjësuese me lojën "Luaj dhe mëso – *Happy Onlife*" për nxënësit e shkollave 9-vjeçare<br>*Aktivitet i organizuar 6M I/çdo vit | | 5, 720<br>2, 020<br>B.Sht | 1.907<br>700<br>B.Sht | 100% | 100 %<br>50 % | **100%** | **I ZBATUAR (KDIMDP)**<br><br>Në kuadër të fushatës kombëtare "Edukimi digjital, luaj dhe mëso – Happy onlife", në gjatë muajve maj-qershor dhe tetor-dhjetor 2021, u zhvilluan 32 | | Do të vijojë zbatim i i | **6M I 2021** | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 3, 700<br>F.Huaj | 1.200<br>F.Huaj | | 100 % | | aktivitete ndërgjegjësuese në shkollat 9-vjeçare të qyteteve të Divjakës, Lushnjës, Kuçovës, Dimalit/Ura Vajgurore, Beratit, Poliçanit, Patosit, Ballshit, Maliqit, Bilishtit, Korçës, Ersekës, Pukës, Fushë-Arrëzit, Prrenjasit, Pogradecit, Memaliajt, Tepelenës, Gjirokastrës, Përmetit, Tiranës, Orikumit, Himarës, Sarandës, Delvinës, Fierit, Roskovecit, Vlorës dhe Selenicës. Nëpërmjet kësaj loje synohet aftësimi i grup moshës 12-15 vjeç për sjelljet që duhet të përshtatin në rrjetet sociale dhe në përgjithësi, në mjedisin digjital. Në to morën pjesë më shumë se 650 nxënës të klasave të 6/7/8-ta të arsimit të detyrueshëm.<br><br>Gjithashtu, në kuadër të po kësaj fushate, me rastin e 28 Janarit, u zhvillua aktiveti ndërgjegjësues në shkollën 9-vjeçare "Servete Maçi" në Tiranë.<br><br>**I ZBATUAR (MAS)**<br><br>Në kuadër të 28 janarit - Ditës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues me nxënës dhe mësues të shkollës "Servete Maçi" në Tiranë. Ky takim ishte pjesë e Fushatës Kombëtare "Edukimi digjital, luaj dhe mëso – Happy onlife", që po mbahet në institucione të arsimit 9-vjeçar në vend (https://ëëë.idp.al/2021/02/01/dita-e-mbrojtjes-se-te-dhenave-personale-aktivitet-ndergjegjesues-ne-shkollen-9-vjecare-servete-maci/<br><br>Faza e dytë e projektit u zhvillua në periudhën maj-qershor 2021, sërisht falë lehtësimit të masave për përballimin e pandemisë në shkollat "Koli Sako" në Divjakë, "4 Dëshmorët" në Lushnjë, "18 Tetori" në Kuçovë, shkollën e Poshnjës në Bashkinë Dimal/Ura Vajgurore, "1 Maji" në Berat, "70-vjetori" në Poliçan (ndërsa u dërguan kopje të lojës dhe materiale të tjera ndërgjëgjësuese edhe për shkollën "Kahreman Ylli" në Çorovodë), "Meleq Gosnishti" në Patos, "Besëlidhja" në Ballsh, shkolla e mesme e bashkuar | | objektivit sipas afatеve të përcaktuara në Planin e Veprimit të SELP 2020-2023. | |

DRAFT

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Rëmbec në Bashkinë Maliq, “Dritëro Agolli” në Bilisht, dhe u dërguan kopje të lojës dhe materiale të tjera ndërgjëgjësuese në shkollat “Mësonjëtorja e parë shqipe” në Korçë dhe “Papa Kristo Negovani” në Ersekë (për këto dy të fundit u gjet kjo zgjidhje, pasi përkoi data e aktivitetit me atë të mbajtjes së provimit të maturës shtetërore 03.06.2021). Në aktivitete morën pjesë nxënës të klasave të 6-ta, 7-ta dhe të 8-ta dhe mësues të lëndëve të gjuhës angleze, informatikës dhe/ose të qytetarisë. Përfaqësuesit e Zyrës e Komisionerit në bashkëbisedim me pjesëmarrësit ndanë informacione dhe këshilla praktike për mbrojtjen e privatësisë, sidomos në përdorimin e rrjeteve sociale. Loja “Happy Onlife” ka si qëllim që të nxisë të rinjtë që nga i menduari kritik të mësojnë për përdorimin e sigurt të të dhënave personale në mjedisin digjital. Njëkohësisht, synohet të rritet dhe ndërgjegjësimi i mësuesve e prindërve për të ndihmuar adoleshentët në parandalimin apo minimizimin e fenomeneve negative si bullizmi, përdorimi i identitetit të të tjerëve, si dhe kontaktet e padëshiruara.<br><br>Në këto takime u shpërndanë botime të Zyrës së Komisionerit, si “Kuadri i aftësimit të mësuesve të shkollave 9-vjeçare mbi mbrojtjen e të dhënave personale të nxënësve” (https://www.idp.al/ëp-content/uploads/2017/10/Kuadri_i_aftesimit_te_mesuesve.pdf) dhe seti i videove bazuar mbi këtë botim që është publikuar në kanalin zyrtar në YouTube të institucionit 9 https://www.youtube.com/channel/UCVNTGFtxO0RAVzYSXjb5ëgA/videos), si dhe fletëpalosje të ndryshme.<br><br>Loja “Happy Onlife” është përgatitur nga Qendra e Bashkuar Kërkimore e Bashkimit Evropian (Joint Research Centre), në vitin 2015. Projekti u përmbyll me takimet që u mbajtën në periudhën shtator-dhjetor 2021. | | | |
| | KDIMDP/ DRAP-ZVAP/ OSHC | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 98901AA | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.7.3.<br>c | Fushata ndërgjegjësuese me lojën “Luaj dhe mëso – *Happy Onlife*” për nxënësit e shkollave 9-vjeçare<br>*Aktivitet i organizuar 6M I/çdo vit | | 5, 720<br>2, 020<br>B.Sht<br>3, 700<br>F.Huaj | 5, 720<br>2, 020<br>B.Sht<br>3, 700<br>F.Huaj | 100<br>% | 29 % | **100%** | **I ZBATUAR (KDIMDP)**<br>Zyra e Komisionerit në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, kishin programuar nisjen e Fushatës Kombëtare “Luaj dhe mëso–Happy Onlife” në muajin mars 2020. Ky aktivitet, u ri programua për shkak të pandemisë dhe për këtë arsye u zhvillua që prej muajit tetor 2020 e në vijim. Përgjatë periudhës tetor-dhjetor 2020 u zhvilluan 22 takime në shkolla 9-vjeçare në 21 qytete të vendit. Pritet që faza e dytë e Fushatës të vijojë në 6-mujorin parë të vitit 2021, në funksion të masave shëndetësore për përballimin e pandemisë Covid-19. Fushata bazohet te loja Happy Onlife e ideuar dhe përgatitur nga Qendra Kërkimore Evropiane (JRC) e Komisionit Evropian. Kjo është një lojë interaktive, me karakter informativ dhe ndërgjegjësues për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale gjatë përdorimit të internetit dhe sidomos të rrjeteve sociale nga fëmijët dhe të rinjtë. | | | |
| | KDIMDP/ DRAP-ZVAP/ OSHC | | | | | | | | | | 2020 |
| | 98901AA | | | | | | | | | | |

DRAFT